Qershor 2015
Numri: 87
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



VETËDIJA NDAJ AMANETIT
OSMAN NURI TOPBASH

NUREDIN NAZARKO
TREGËTARIZMI

XHAFER DURMUSH
NDIKIMI I KAMATËS TE NJERIU

A. JASIN DEMIRXHI
PARAMENDO SIKUR JETA JOTE TË JETË NJË DITË

MUSTAFA ERISH
ERVA BINTI KUREJDH (R.A.)



DR. ADEM ERGYL
SËMUNDJA E VETËPËLQIMIT

Unë u mposhta, MË NDIHMO!

ISSN 2227-3611

PROGRESI BOTIME

Arsyeja dhe Filozofia

I RI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË RINJ

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

Në Kuran flitet për historitë e pejgamberëve. Në shumicën prej këtyre historive bëhet fjalë për misionin që mbart paralajmërimet hyjnore kundrejt një devijimi që ka fituar përhapje. Pejgamberët, nganjëherë vetëm dhe nganjëherë me grupin e vogël që u kishte besuar, janë përpjekur për ta ndaluar një devijim të përhapur dhe për ta mbartur njeriun përsëri në klimën e natyrshmërisë së tij të pastër.

Ata nuk e shenjtëruan devijimin e përhapur...

Përkundrazi, u përpoqën për të ruajtur veten e tyre.

U përpoqën për të mbrojtur njerëzit.

Ata asnjëherë nuk kanë pasur këtë qëndrim: "Kjo prirje është popullarizuar, prandaj le të veprojmë edhe ne sipas saj."

Janë bërë përpjekje të mëdha. Nganjëherë edhe më të afërmit janë zënë robër nga ajo prirje, por thirrja e Pejgamberit për të ruajtur natyrshmërinë e pastër do të vazhdojë deri në fund.

Ky devijim vlere është aq i përhapur dhe vendosmëria e Pejgamberit është aq e qartë saqë, siç ka ndodhur edhe në shembullin e Lutit (a.s.), të parët e shoqërisë thanë:

"...Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë." (A'raf, 82)

Pastërtia shndërrohet në një gjendje të veçantë, madje fillon të konceptohet si faj.

Sikur "jeta e ndyrë" dhe "mendimi i ndyrë" kanë pushtet.

Pejgamberët nganjëherë mund të mos shpëtojnë edhe zemrat e më të afërmve të tyre. Bashkëshortja e Lutit ngeli në botën e të devijuarve, ndërsa biri i Nuhut iu dorëzua tufanit.

Devijimi...

Te populli i Lutit ishte në formën e homoseksualizmit. Te një popull tjetër, shfaqet në formën e adhurimit të idhujve të bërë nga gurët apo nga drurët. Te një popull tjetër, lideri politik e përkufizon veten si "Zot" dhe kërkon nga njerëzit që ta adhurojnë. Padrejtësia është e përhapur. Nderi i njerëzve është marrë nëpër këmbë. Robëria ka ardhur në gjendjen e sistemit sundues.

Pejgamberët kanë paguar çmime të mëdha kur kanë rezistuar kundër devijimit epidemik. Aq sa Nuhu (a.s.), u detyrua të thoshte: ***"...Unë u mposhta*** (o Zot)***, andaj më ndihmo!"*** (Kamer, 10) Ibrahimi (a.s.), u hodh në zjarr. Muhamedi (a.s.), u detyrua të braktiste vendin e tij.

Por sikur t'i kishte pranuar prirjet që sundonin, atij do t'i jepej gjithçka.

Ngjarja që ka përjetuar Jusufi është shumë mësimdhënëse. Jusufi përjetoi sprovën e marrëdhënieve seksuale. Kur ta shikojmë këtë nga këndvështrimi i botës së pasioneve seksuale të sotme, Jusufi i vuri shkelmin shfrytëzimit të mundësisë së ardhur "duke u strehuar tek Allahu"...

Përse i tregon Kurani këto?

Njeriu e jeton jetën në një lavjerrës... Sepse ky është sprovimi i njeriut në sipërfaqen e tokës.

Ai mbart potencialin e vajtje-ardhjeve ndërmjet esfeli safilin dhe alaji il-lijjin.

Ndërmjet më të lartëve dhe më të poshtërve...

Njeriu mbart brenda vetes edhe potencialin e mëkatit, edhe atë të devotshmërisë...

Edhe të keqen, edhe virtytet që i jep të qenit afër me Allahun Teala...

Revista ETIKA

Qershor 2015
VITI: IX
NUMRI: 87

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
rev.etika@gmail. com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni : 900 Denar
Evropë : 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja

Të duash miqtë e Allahut dhe të qëndrosh bashkë me ta
Idris Arpat 26

Tregëtarizmi
Nuredin Nazarko 8

Vetëdija ndaj amanetit
Osman Nuri Topbash 34

10

13
Ndikimi i kamatës te njeriu
Xhafer Durmush

5 **Të kalosh pa u djegur**
Ahmet Tashgetiren
10 **Përgjegjësia e Ehli Kitabit për t'i besuar të Dërguarit të Allahut (a.s.)**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
16 **Dëshmorët nuk vdesin**
Osmar Ersan
18 **Ta bësh punën siç duhet**
M. Sami Ramazanollu
20 **Sëmundja e vetëpëlqimit**
Dr. Adem Ergyl
23 **Përgojimi**
Sadik Dana
24 **Sindromi X**
Dr. Ali Akben
28 **Administrimi i pasurisë së jetimëve, pasurive publike dhe vakëfeve**
Prof. dr. Hamdi Dëndyren



44

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32

"Es-selamu alejke ja Ibrahim, jam Xhibrili" 42
Imam Muhamed Sytari
Psikologjia e mëkatit dhe pendimit 44
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
7 njerëz të mirë 47
Murat Kaja
Pendimi 50
Jashar Kandemir
Parimet e jetës nga Aliu (r.a.) 52
Ali Byjykçapar
Tablotë Profetike 56
Xhemal Nar
Respektimi i prindërve është porosi hyjnore 58
Naim Drijaj

Paramendo sikur jeta jote të jetë një ditë
A. Jasin Demirxhi
39



Erva binti Kurejdh (r.a.)
Mustafa Erish 40

Të kalosh PA U DJEGUR

Ahmet Tashgetiren

Sipas prirjeve politike të përhapura, mendimeve ekonomike, vlerave kulturore, këndvështrimeve morale etj... ne duhet t'i rishikojmë edhe një herë sjelljet dhe të përshtatemi ndaj tyre...

A duhet t'i riformojë edhe myslimani vlerat e tij personale sipas kësaj? A është i detyruar t'i formojë?

Kapitalizmi, socializmi, liberalizmi, hedonizmi etj... A duhet të bëjë ndryshim në personalitet edhe myslimani sipas bazës që formojnë këta, nëse këta fitojnë përhapje dhe influencë në shkallë universale? A është i detyruar ta bëjë këtë ndryshim?

Në Kuran flitet për historitë e pejgamberëve. Në shumicën prej këtyre historive bëhet fjalë për misionin që mbart paralajmërimet hyjnore kundrejt një devijimi që ka fituar përhapje. Pejgamberët, nganjëherë vetëm dhe nganjëherë me grupin e vogël që u kishte besuar, janë përpjekur për ta ndaluar një devijim të përhapur dhe për ta mbartur njeriun përsëri në klimën e natyrshmërisë së tij të pastër.

Ata nuk e shenjtëruan devijimin e përhapur...

Përkundrazi, u përpoqën për të ruajtur veten e tyre.

U përpoqën për të mbrojtur njerëzit.

Ata asnjëherë nuk kanë pasur këtë qëndrim: "Kjo prirje është popullarizuar, prandaj le të veprojmë edhe

ne sipas saj."

Janë bërë përpjekje të mëdha. Nganjëherë edhe më të afërmit janë zënë robër nga ajo prirje, por thirrja e Pejgamberit për të ruajtur natyrshmërinë e pastër do të vazhdojë deri në fund.

Ky devijim vlere është aq i përhapur dhe vendosmëria e Pejgamberit është aq e qartë saqë, siç ka ndodhur edhe në shembullin e Lutit (a.s.), të parët e shoqërisë thanë:

"...Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë." (A'raf, 82)

Pastërtia shndërrohet në një gjendje të veçantë, madje fillon të konceptohet si faj.

Sikur "jeta e ndyrë" dhe "mendimi i ndyrë" kanë pushtet.

Pejgamberët nganjëherë mund të mos shpëtojnë edhe zemrat e më të afërmve të tyre. Bashkëshortja e Lutit ngeli në botën e të devijuarve, ndërsa biri i Nuhut iu dorëzua tufanit.

Devijimi...

Te populli i Lutit ishte në formën e homoseksualizmit. Te një popull tjetër, shfaqet në formën e adhurimit të idhujve të bërë nga gurët apo nga drurët. Te një popull tjetër, lideri politik e përkufizon veten si "Zot" dhe kërkon nga njerëzit që ta adhurojnë. Padrejtësia është e përhapur. Nderi i njerëzve është marrë nëpër këmbë. Robëria ka ardhur në gjendjen e sistemit sundues.

Pejgamberët kanë paguar çmime të mëdha kur kanë rezistuar kundër devijimit epidemik. Aq sa Nuhu (a.s.), u detyrua të thoshte: ***"...Unë u mposhta*** (o Zot)***, andaj më ndihmo!"*** (Kamer, 10) Ibrahimi (a.s.), u hodh në zjarr. Muhamedi (a.s.), u detyrua të braktiste vendin e tij.

Por sikur t'i kishte pranuar prirjet që sundonin, atij do t'i jepej gjithçka.

Ngjarja që ka përjetuar Jusufi është shumë mësimdhënëse. Jusufi përjetoi sprovën e marrëdhënieve seksuale. Kur ta shikojmë këtë nga këndvështrimi i botës së pasioneve seksuale të sotme, Jusufi i vuri shkelmin shfrytëzimit të mundësisë së ardhur "duke u strehuar tek Allahu"...

Përse i tregon Kurani këto?

Vallë, a thua edhe ne të veprojmë kështu? Vallë, nëse veprojmë kështu, a do të thotë se po ecim me hapin e kohës? Ose, nëse nuk bëjmë kështu, a ngelim prapa kohës? Nëse ngelim prapa kohës, a ka ndonjë çmim për t'u paguar?

Njeriu e jeton jetën në një lavjerrës... Sepse ky është sprovimi i njeriut në sipërfaqen e tokës.

Ai mbart potencialin e vajtje-ardhjeve ndërmjet esfeli safilin dhe alaji il-lijjin.

Ndërmjet më të lartëve dhe më të poshtërve...

Njeriu mbart brenda vetes edhe potencialin e mëkatit, edhe atë të devotshmërisë...

Edhe të keqen, edhe virtytet që i jep të qenit afër me Allahun Teala...

Pejgamberët vijnë pikërisht në kohën kur përhapet e keqja. Mjediset e tilla janë mjedise në të cilat përjetohen kalbjet shoqërore ose edhe më keq, në të cilat përjetohen kiametet. Të Dërguarit e Allahut u kujtojnë njerëzve misionin e krijimit të tyre, edhe pse nganjëherë e paguajnë këtë me çmim të rëndë, si për shembull, të ngelurit vetëm.

Misioni i krijimit të njeriut nuk vjetërohet asnjëherë.

Ai është një e vërtetë e përhershme dhe e palëkundur. Sado që të përhapen devijimet, nuk e vjetërsojnë gjallërinë dhe vërtetësinë e këtij misioni.

Edhe në kohën tonë ka devijime të përhapura.

Droga, prostitucioni, homoseksualizmi, mosnjohja e kufijve në marrëdhëniet seksuale, aborti, vjedhja, korrupsioni, kolonizimi... padrejtësitë politike... shndërrimi i grave në mjete argëtimi... abuzimi dhe shtypja e fëmijëve...

Njeriu e kupton se po bën "mëkat" kundrejt vlerave të natyrshmërisë njerëzore në disa fusha dhe përpiqet për të formuar një kornizë "të të drejtave të njeriut". Kjo mund të komentohet si kërkim i kornizës së natyrshmërisë. Por ka edhe njerëz që në disa fusha e kanë shndërruar në një "të drejtë të njeriut" "mëkatin", i cili do të thotë shkelje e kornizës së natyrshmërisë njerëzore. Në këtë mënyrë, faraonizmi shndërrohet në një sistem sundues. Mënyra e Karunit shndërrohet në karakterin kryesor të sistemit ekonomik. Sistemi i Hamanit, i cili në Kuran cilësohet si "simboli i kalbjes së sistemit të shtetit", bëhet sistem sundues. Sistemi i Bel'amit, i cili përmendet si simboli i rënies së jetës fetare, shndërrohet në strukturë influencuese.

Dikur, në disa vende, socializmi tentonte t'ua impononte veten popujve si strukturë sunduese. Ndërsa tani

kapitalizmi, me një pohim të njëjtë, po shfaq vullnetin për ta formuar të gjithë botën sipas shablloneve të tij.

Kur kjo ndodh në këtë botë, edhe ne myslimanët fillojmë të mendojmë:

-Vallë, a thua edhe ne të veprojmë kështu? Vallë, nëse veprojmë kështu, a do të thotë se po ecim me hapin e kohës? Ose, nëse nuk bëjmë kështu, a ngelim prapa kohës? Nëse ngelim prapa kohës, a ka ndonjë çmim për t'u paguar?

Myslimani, duke filluar që nga fusha e ekonomisë, duhet t'i caktojë edhe një herë koordinatat mendore në të gjithë botën e tij sipas kapitalizmit?

Dispozitat fetare duhet t'i shohim sipas rezultateve që ka nxjerrë në pah modernizmi dhe duhet të shkojmë drejt reformës, ndryshimit dhe përtëritjes?

Pastaj dëgjoni se marrëdhënia jashtëmartesore është nxjerrë nga të qenët faj në një vend mysliman.

Arsyeja:

Në botë nuk ka ngelur vend që ta konsiderojë marrëdhënien jashtëmartesore si faj!

Kur mëkati përhapet, ndryshon edhe cilësimi i fajit!

Kur përhapet vjedhja, ajo nxirret nga të qenët faj. Kur përhapet kolonizimi, fillon dhe legalizohet...

Në disa vende të Evropës janë bërë legale martesat homoseksuale. Ka disa vende në të cilat janë bërë martesa homoseksuale edhe në shkallë ministrash.

Vallë, a të kujtojnë thirrjen e Lutit apo të tentojnë ta mbysin Lutin (a.s.), duke thënë: "Shporrini këta nga kjo botë, sepse pandehin se janë shumë të pastër"?

Të shfaqësh rezistencë ndaj pejgamberit...

Kurani na tregon një rrugë me historitë e pejgamberëve.

Sprovimi i njeriut vazhdon.

Udhëheqja e Muhamed Mustafasë, (a.s.), vazhdon.

I Dërguari i Allahut (a.s.), hoqi vuajtjen më të madhe, vendosi të braktiste vendin e vatrën e tij dhe refuzoi interesat më të mëdha të kësaj bote për të mbrojtur vlerat e natyrshmërisë së pastër njerëzore që u kishte sjellë njerëzve.

Ibrahimi, (a.s.), mori parasysh hedhjen në zjarr.

Por prapë se prapë, sprovimin në këtë botë e kaluan me fytyrë të bardhë.

Ibrahimi nuk u dogj në zjarr... Sepse atë e kishte rrethuar një mburojë hyjnore.

Historia e Ibrahimit tregon se ata të cilët kanë veshur mburojën hyjnore, do të fitojnë mirësinë për të mos u djegur në devijimet e kësaj bote, të cilat janë në cilësinë e një lloji të zjarrit të xhehenemit.

Ibrahimi nuk u dogj në zjarr... Sepse atë e kishte rrethuar një mburojë hyjnore.

Historia e Ibrahimit tregon se ata të cilët kanë veshur mburojën hyjnore, do të fitojnë mirësinë për të mos u djegur në devijimet e kësaj bote, të cilat janë në cilësinë e një lloji të zjarrit të xhehenemit.

Nëse merrni parasysh për të braktisur vendin dhe vatrën tuaj për hir të Allahut si Muhamed Mustafai, do të dëgjoni thirrjen: ***"Ma veddaake Rabbuke / Zoti nuk të ka braktisur ty."*** (Duha, 3)

Sikur e gjithë jeta e kësaj bote të ishte vuajtje, përsëri zgjidhni sihariqin: "Jeta e Ahiretit është më e mirë dhe e përhershme."

Siç e dini, "çdo njeri është në një lloj robërie për shkak të asaj që ka bërë". Njeriu do ta jetojë këtë botë, do të shpërngulet në botën e përhershme, do të hapet libri i jetës së tij dhe robëria do të zgjidhet... Sigurisht, nëse ka përgatitur një dosje jete që mund t'ia zgjidhë robërinë... Përndryshe, nga kjo robëri ndoshta do të fillojë një udhëtim drejt humbjes së përhershme...

Këtë botë duhet ta jetojmë duke mos e harruar botën tjetër...

Kjo është fshehtësia e mendimit sipas Islamit...

Ata që e formojnë jetën e kësaj bote sipas dëshirave të tyre, do të detyrohen të pranojnë një fat sipas ligjit të Sunduesit Absolut...

Prandaj duhet të bëhemi si Ibrahimi, edhe nëse bëhet fjalë për në shkallë universale, në mënyrë që të mos digjemi brenda në zjarrin që kanë ndezur Nemrudët...

Ne duhet të strehohemi te Zoti i Botëve për të marrë mbrojtjen hyjnore...

Tregëtarizmi

Nuredin Nazarko

Në kohën bashkëkohore shfaqjet negative duket sikur nuk kanë të sosur. Ato gjenerohen, transformohen, riemërohen, por asnjëherë nuk zhduken tërësisht. Ajo që shfaqet në një kohë dhe hapësirë të caktuar, mund të rishfaqet sërishmi me tone më të mprehta, pasiqë çdo ditë që vjen është më e keqe se ajo që kalon. Ndër shumë pasoja të shtrira thellë në zhvillimet bashkëkohore, kemi përzgjedhur të vëmë në dukje një pasojë tepër negative të botës bashkëkohore, tregëtarizimi.

Çfarë është tregëtarizimi dhe përse është një nga ngjarjet e rënda të botës bashkëkohore? Çfarë pasojash ka sjellë në jetën e njeriut bashkëkohor? Dhe, a mund të përballemi, a mund të sfidojmë këtë gërbulë të ditëve të sotme?

Veprimtaria ekonomike është prej natyrshmërisë njerëzore, pasiqë pa këtë veprimtari njeriu nuk do të kishte mundësi të mbante frymën gjallë, për aq sa do të jetë mbi sipërfaqen e tokës. Një nga veprimtaritë kryesore të kryera nga njeriu, që ka zënë një hapësirë të konsiderueshme në tërësinë e veprimtarisë ekonomike njerëzore, është padyshim tregëtia. Në veprimtarinë e tij ekonomike, njeriu primitiv kishte si qëllim të siguronte mbijetesën, për të patur vazhdimësi të jetës dhe racës së tij. Grumbullimin, rezervimin e produkteve nuk e konsideronte si qëllim, për një jetë më të mirë. Edhe në qoftë se ndodhte kjo, qëllimi ishte përgatitja për ditë të vështira. Por në botën e tanishme, të marrurit me tregëti, nuk ka më për qëllim të sigurojë thjesht jetesën, apo të sigurojë zahiretë për kohë të vështira. Në të tanishmen, po veprohet dhe po sakrifikohet në emër të një motivi, motivi i fitimit. Është e natyrshme që në qoftë se nuk fiton, të mos angazhohesh në veprimtari ekonomike. Por fitimi është kthyer në qëllim parësor dhe makutëria ka lëshuar rrënjë në shpirtrat e molepsur nga dashuria për paranë.

Motivi i fitimit është busulla që orienton dhe drejton, jo thjesht veprimtarinë ekonomike të njeriut bashkëkohor, por edhe raportet e tij me qeniet e tjera njerëzore. Kjo sjellje natyrshëm që ka dëmtuar cilësinë e jetës së njeriut bashkëkohor, pasiqë nuk sheh më tek tjetri një qenie njerëzore që duhet dashur dhe nderuar, por një burim të mundshëm parash. Po pse kjo dashuri kaq e madhe për paranë? Njeriu bashkëkohor dhe jo vetëm, ka dashuri për paranë jo thjesht si shkak i pangopshmërisë, por për shkak se paraja prodhon pushtet mbi qeniet e tjera njerëzore. Sa më i pasur të jesh, aq më shumë pushtet ke mbi të tjerët, sa më i pasur të jesh aq më shumë të servilosen dhe nënshtrohen të tjerët. Kjo masë të nënshtruarish dhe servilësh janë ata të cilët, paranë e kanë të shenjtë dhe për hir të fitimit të saj janë të gatshëm të kryejnë çdo gjë, pa u menduar dy herë.

Sigurimi i pushtetit mbi të tjerët, është arsyeja më

e vlefshme, për ta kthyer motivin e fitimit në qëllim të rëndësishëm të veprimtarisë së përditshme jetësore. Mes gjithë kësaj rropatje të vazhdueshme, të gjitha përllogaritjet e kryera të nxjerrin në të njëjtin shteg; përdorim efiçent të burimeve të disponueshme, për të patur sa më pak kosto dhe sa më shumë fitim. Për ta arritur këtë, njeriu i molepsur nga makutëria është i aftë të shkelë me të dyja këmbët parimin themelor të drejtësisë, mjaft që të sigurojë fitim të shpejtë dhe të madh. Ngrënia në peshë dhe në masë nuk janë më një çudi në botën e tanishme, por një realitet të cilin e ndesh çdokush, një realitet që e prek çdokush. Hilja dhe mashtrimi janë pjesë e pandarë e motivit të fitimit, sepse kështu fitohet më shpejt, pasurohesh më shpejt dhe rrjedhmisht pushtetëzohesh më shpejt.

Pushtetëzimi i individit nëpërmjet parasë, nuk është një problem thjesht i individit që i nënshtrohet këtij operacioni, por është problem që shtrihet në një shkallë të gjerë në shoqëri. Ky është problem shoqëror, për shkak të mesazhit që mbart. Duke u pushtetëzuar nëpërmjet parasë, të adresuarit marrin mesazhin se sistemi i parimeve etiko-morale është një pengesë që duhet flakur tej, pasiqë jo vetëm nuk të siguron atë që të siguron paraja, por të sjell dhe kokëçarje, duke të vendosur përballë dilemash, për respektimin e kufijve. Ky është mesazhi më i keq i mundshëm, pasiqë pushteti nuk është një lodër fëmijësh, por përgjegjësi dhe çështje kompetencash. Nëse pushtetëzohesh nëpërmjet parasë, atëherë bjerrja morale është e pashmangshme, sepse është paraja që kontrollon veprimtarinë e individit me pushtet dhe jo anasjelltas. Po kështu do të bjerren nën këtë peshë dhe ata të cilët suksesin më të madh të jetës konsiderojnë katandinë, famën, prestigjin, privilegjet, elitarizmin materialistik. Kështu, breznitë e reja mëkohen me modelin e arritjes së suksesit jo nëpërmjet moralit aristokratik, por nëpërmjet arratisjes nga ky moral.

Tregëtarizimi, është duke u manifestuar dukshëm, jo vetëm nëpërmjet kompromiseve antiaristokratike në çështjen e trajtimit të tjetrit dhe në çështjen e pushtetit, por edhe në raportin e individit me vetveten. Tregëtarizimi si instrument i fitimit, e ka çuar individin drejt shtruarjes për përgjigje, pyetjeve të tipit:

- Sa para vlen kjo? A mund të shitet kjo? Çfarë mund të përfitoj unë, nga kjo apo ajo gjë?

Duke mbajtur si shqetësim kryesor përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve, individit bashkëkohor nuk i intereson vlera morale e asaj çfarë zotëron, por thjesht vlera financiare. Kësisoj, asgjë që nuk i siguron përfitim material, del jashtë sferës së interesimit. Vlerat morale që e ngrejnë në lartësi të paimagjinueshme të qetësisë dhe kënaqësisë njeriun, për individin e tregëtarizuar duhet të harrohen dhe duhet të mos mendohet dhe veprojë në përputhje me to. Tregëtarizimi bashkëkohor e ka kthyer vetë individin në mall që blihet e shitet, pa respektuar aspak shenjtërinë e jetës së qenies njerëzore. A nuk shfrytëzohet sot njeriu, nga industria e reklamave dhe biznesit, veçanërisht femra? A nuk i çelet sot rruga e karrierës atyre që shesin dinjitetin dhe moralin si qenie njerëzore, për një grusht aspra? A nuk janë sot krijesat mediatike shembulli i suksesit që duhen ndjekur?

Asgjë nuk është e rastësishme, pasiqë asgjë nuk ndodh rastësisht. Ky model i njeriut të tregëtarizuar, po reklamohet fuqishëm si modeli që duhet ndjekur, dhe ata të cilët janë më të joshur nga shkelja në këtë lloj rruge, pa dyshim që janë breznitë e reja. Kësisoj po synohet ushqimi i këtyre breznive me këto ide suksesi, të cilat të çelin dyer që si ke menduar kurrë, por në këmbim të një çmimi të paçmim. E megjithatë breznitë e reja nuk vramenden aspak për çmimin që duhet të paguajnë, pasiqë me rëndësi është suksesi, fama, të konvertuara këto në para, favore, privilegje, pushtet. Tregëtarizimi e vlerëson njeriun për aq sa mund të prodhojë para. Në momentin që nuk kanë ç'të marrin më nga kjo krijesë – mall, e flakin tej pa as më të vogëlin hezitim, sepse në rradhë pret brezi i ri, që është më vital, ka më shumë energji dhe prodhon më shumë para. Në këtë mënyrë ka humbur shenjtëria e jetës njerëzore dhe prandaj nuk duhet të çuditemi aspak, kur shohim çmendurira në përpjekjet e njerëzve që vdesin për të siguruar pak famë, privilegj, para, pushtet. Nuk duhet të çuditemi as kur pjesmarrësve nëpër evente antiaristokratike iu hapen shumë dyer, të mbyllura për ata që sakrifikojnë për të qënë qenie njerëzore aristokratike. E pra, të fitosh padrejtësisht qoftë edhe mbi përdorimin e vetvetes nuk është aspak njerëzore, edhe pse njeriu bashkëkohor po kultivon pandalshëm idenë e të qënit pronar i vetvetes, me të cilën mund të veprojë sipas dëshirës, qejfit dhe tekave vetjake, pra edhe ta tregëtarizojë atë, kur e gjykon të arsyeshme për ta kryer këtë.

Pavarësisht, shpërhapjes së gjerë që ka ma marrë tregëtarizimi, por dhe e keqja në tërësi, gjithmonë do të ketë një dritare prej nga ku njeriu mund të këndvështrojë veten dhe botën, jo thjesht nën prizmin e tregëtarizimit. Gjithmonë do të ketë një oaz në shkretëtirë, ku udhëtari i etur do të shuajë etjen për të vazhduar të jetojë. Vetëm ai që zgjedh udhërrëfyesin e drejtë, të sinqertë dhe të urtë mund të pushojë në oaz, edhe pse i rrethuar përçdoanshëm nga shkretëtira përvëluese. Ky është suksesi real dhe i vërtetë, frytet e të cilit nuk shndërrohen në pluhur, por takohen me njeriun që ka punuar për t'i vjelë, në një kohë tjetër.

PËRGJEGJËSIA E ITHTARËVE TË LIBRIT PËR T'I BESUAR TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Prof. dr. Ismail Lufti Çakan

Në pjesën e besimit të librit "Ishkatu'l-Mesabih", si hadithi i dhjetë, i është dhënë vend një transmetimi që tregon ata të cilët janë të obliguar për t'i besuar të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ebu Hurejra, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë hadith fisnik e fillon fjalën duke u betuar dhe thotë:

"Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit se ai që vdes nga ky umet, qoftë çifut apo i krishterë, pa i besuar (fesë) *me të cilën jam dërguar* (si pejgamber) *pasi ka dëgjuar për mua, absolutisht do të jetë prej banorëve* (të përhershëm) *të xhehenemit."* (Muslim, Iman, 240)

Dihet se ka rreth tetëdhjetë çështje për të cilat i Dërguari i Allahut (a.s.), ka filluar të flasë duke u betuar. Sigurisht se betimet e tilla tërheqin vëmendjen për rëndësinë dhe seriozitetin e çështjes. Që kur ka dalë feja islame e deri më sot, gjendja e çifutëve dhe e të krishterëve ka qenë një çështje që gjithmonë është diskutuar shumë. Edhe në ditët e sotme debatohet vazhdimisht gjendja e tri feve të mëdha me burim hyjnor, për shkak të iniciativave "të dialogut ndërfetar", për të cilin mendoj se palët po e bëjnë me synime të ndryshme. Në esencën e këtyre debateve synohet që edhe myslimanët ta përvetësojnë Jeduizmin dhe Krishterimin sikur të ishin fe të vërteta. Përndryshe, Ithtarët e Librit në të vërtetë, e ka nxjerrë në pah në një formë shumë të shëmtuar dhe sharlatane se me "dialogun ndërfetar" nuk ka për qëllim të zhvillojë marrëdhëniet civile. Nga ana tjetër, po dalin edhe disa dijetarë myslimanë të cilët pranojnë se do të hyjnë në xhenet edhe çifutët dhe të krishterët që e pranojnë njësimin e Allahut (tevhidin). Nisur nga parimi "dinullahi vahid / feja e Allahut është një" dhe nga e vërteta se ajo që vjen pas e shfuqizon atë që ka qenë më parë, çdo gjë po anashkalohet dhe po bëhen përpjekje për ta bërë të pavlefshëm parimin e "shfuqizimit" ndërmjet feve. Ndërkohë, hadithi që thamë më lart i refuzon totalisht si parime iniciativat që i shërbejnë një qëllimi të tillë, përderisa nuk besohen ato që ka sjellë Muhamedi

(a.s.), si pejgamber. Si rezultat, krahas së gjithash, kuptohet qartë se iniciativat e dialogut mund të bëhen vetëm me qëllimin për të predikuar Islamin dhe për të ftuar në Islam. Po ashtu, hadithit në fjalë i jepet vend në sahihun e Imam Muslimit (v. 261) nën kreun me titull: **"Domosdoshmëria për të besuar se i Dërguari i Allahut, Muhamedi, (a.s.), është dërguar si pejgamber te të gjithë njerëzit dhe se të gjitha fetë janë shfuqizuar me fenë e tij"**. Përsëri hadithi në fjalë është përmendur në "Mesabihu's-Sunne" nga ana e el-Begaviut (v. 516), në "Mishkat" nga ana e et-Tibrizit (v. 737) dhe në kreun e parë të pjesës së besimit (kitabu'l-iman), i cili përbëhet nga hadithe të sakta pas haditheve që njoftojnë se Muhamedin, përveçse duhet ta besojmë si pejgamber, duhet edhe ta duam më shumë se jetën dhe duhet të jemi të kënaqur prej tij. Aty theksohen edhe ata që janë të obliguar për t'i besuar ose me një shprehje tjetër, theksohet universaliteti i profetësisë së të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Në hadithin fisnik thuhet me një gjuhë të prerë se do të jenë banorë të xhehenemit të gjithë, duke përfshirë edhe çifutët dhe të krishterët, që vdesin pa i besuar Pejgamberit dhe fesë (Islamit dhe dispozitave të tij) me të cilën është dërguar pasi e kanë dëgjuar se ai është i Dërguari i Allahut.

Edhe një herë le të themi: Në hadithin fisnik thuhet me një gjuhë të prerë se do të jenë banorë të xhehenemit të gjithë, duke përfshirë edhe çifutët dhe të krishterët, që vdesin pa i besuar Pejgamberit dhe fesë (Islamit dhe dispozitave të tij) me të cilën është dërguar pasi e kanë dëgjuar se ai është i Dërguari i Allahut. Është fare e qartë se nuk ka asnjë kuptim përpjekja për t'i shpëtuar Ithtarët e Librit nga kjo e ardhme e dhimbshme, edhe pse nuk e pranojnë profetësinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Përballë Ithtarëve të Librit, të cilët thonë, siç shprehet edhe në Kuran: ***"...Askush nuk do të hyjë në xhenet, përveç hebrenjve ose të krishterëve..."*** (Bekare, 111) ***"...Bëhuni hebrenj ose të krishterë, në mënyrë që të jeni në rrugë të drejtë!.."*** (Bekare, 135), në fillim të ajetit që vijon pas dy ajeteve të sures Bekare, 135-136, që i mëson myslimanët se si duhet t'u përgjigjen atyre dhe për t'ua shprehur Ithtarëve të Librit se si besojnë myslimanët, thuhet: ***"Nëse ata besojnë në atë që besoni edhe ju, atëherë janë në rrugën e drejtë..."*** (Bekare, 137) Në këtë mënyrë, çdo gjë shpjegohet qartë. Ajetet fisnike që do japim më poshtë, e sqarojnë në mënyrë të qartë të vërtetën absolute për të cilën po diskutojmë: ***"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami..."*** (Al 'Imran, 19) ***"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."*** (Al 'Imran, 85) Ndërmjet rezultatit dhe përgjegjësisë për t'i besuar Pejgamberit dhe fesë që ka sjellë për të gjithë njerëzimin, duke përfshirë edhe Ithtarët e Librit, gjë e cila shprehet duke u përforcuar me betim, dhe të vërtetës që shfaqin këto ajete, ka një përputhshmëri të plotë dhe unitet në kuptim.

"BËHUNI MYSLIMANË, NË MËNYRË QË TË SHPËTONI"

Përveç deklarimit në hadithin e mësipërm, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka sqaruar këtë të vërtetë edhe me sjelljet/veprat e tij kundrejt Ithtarëve të Librit. Nën titullin e temës së formuar me këtë ajet, ***"Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë..."*** (Ankebut, 46), në Sahihun e Imam Buhariut (v.256), gjejmë edhe këtë transmetim:

Ebu Hurejra, (r.a.), ka thënë: Kur po qëndronim në xhami, erdhi i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe na tha: *"Ejani të shkojmë te çifutët."* Edhe ne dolëm bashkë me të dhe shkuam në Bejtu'l-Midras. I Dërguari i Allahut,

(a.s.), ndaloi dhe u tha atyre:

"O populli çifut! Bëhuni myslimanë, në mënyrë që të shpëtoni!" Ata i thanë:

"Ti e bëre thirrjen tënde, o Ebu'l-Kasim!" I Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha:

"Kjo është ajo që dua edhe unë. Bëhuni myslimanë, në mënyrë që të shpëtoni!" Ata përsëri i thanë: "Me të vërtetë, ti e bëre thirrjen tënde, o Ebu'l-Kasim." I Dërguari i Allahut, (a.s.), ua përsëriti tri herë thirrjen e tij me të njëjtat fjalë. (Buhari, Xhizje 6, Ikrah 2; Muslim, Xhihad 61)

Nga ana tjetër, në dy transmetimet e hadithit që flet në lidhje me tri cilësitë për arritjen e ëmbëlsisë së besimit (shik. Ahmed ibn Hanbel, Musned, III, 230, 288.), që zënë vend me numrin tetë në "Mishkat", si cilësi e tretë përmendet: *"Ai, i cili preferon më shumë të hidhet në zjarr se sa të bëhet çifut apo i krishterë, ka arritur ëmbëlsinë e besimit."* Shprehja "kthimi në kufër", që përmendet në shumicën e transmetimeve të hadithit, në këto dy transmetime përmendet në formën "të kthehesh në Judaizëm apo Krishterim".

Nëse marrim parasysh faktin se transmetimet shpjegojnë njëri-tjetrin, kjo situatë tregon shumë natyrshëm se është e pamundur të bëhet fjalë për besimin jashtë Islamit dhe se nuk ka asnjë ndryshim ndërmjet "kthimit në kufër" dhe "kthimit në Judaizëm apo Krishterim".

MUNDËSIA PËR TË FITUAR DY SHPËRBLIME

Përsëri, në hadithin e njëmbëdhjetë që ndodhet në "Mishkat", thuhet se për ata që janë Ithtarë të Librit dhe i besojnë Pejgamberit (a.s.), kanë edhe një mundësi tjetër të ndryshme: *"Ka tre grupe njerëzish, të cilët do të përfitojnë dy shpërblime. I pari prej këtyre janë njerëzit e Ithtarëve të Librit që (së pari) i kanë besuar pejgamberit të tyre (dhe pastaj) i kanë besuar Muhamedit..."*[1]

Ehli kitabi është inkurajuar për të pranuar Islamin duke u përkujtuar mundësinë dhe begatinë e atyre që u kanë besuar dy pejgamberëve dhe që kanë jetuar me dy fetë. Siç e dimë të gjithë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u pati dërguar letra thirrjeje kryetarëve të fiseve dhe shteteve përreth me bazë: *"Bëhu mysliman, në mënyrë që të shpëtosh!"* Ftesa me shkrim: *"Bëhu mysliman, në mënyrë që të shpëtosh"*, që gjendej në këto letra dhe thirrja verbale: *"Bëhuni myslimanë, në mënyrë që të shpëtoni"*, që Pejgamberi ua bëri çifutëve duke shkuar në Bejtu'l-Midras, është një "sunet" i domosdoshëm që duhet të merret parasysh nga aspekti i marrëdhënieve që duhet të kemi me Ithtarët e Librit. Çdo mysliman duhet t'i themelojë mendimet dhe iniciativat e tij sipas këtij suneti.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), ia dërgoi njërën prej këtyre letrave të thirrjes perandorit Bizant, Herakliut, i cili ishte i krishterë, pati shkruar: *"Bëhu mysliman, në mënyrë që Allahu të të japë dy shpërblime!"*[2] Kjo thirrje e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është në përputhje të plotë me ajetin: ***"O ju*** (ithtarë të Librit) ***që besuat*** (në Musain dhe Isain)***, ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij*** (Muhamedin)***, se Ai do t'ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t'ju japë dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t'ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."***[3]

Premtimi në këtë ajet e në hadith dhe mundësia për marrjen e dy shpërblimeve, që thuhet në letrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe pse është çështje e debatueshme, është i vlefshëm edhe për çifutët dhe të krishterët që jetojnë edhe sot, ose të paktën për ata që sot akoma kanë të njëjtën gjendje me Ithtarët e Librit e asaj kohe, domethënë, për ata që sapo e njohën Pejgamberin dhe Islamin me anën e tyre të vërtetë. Ndërsa fundi që i pret ata të cilët vdesin pa u bërë myslimanë, edhe pse kanë dëgjuar për Pejgamberin, në hadithin fisnik mbi të cilin kemi shtjelluar shkrimin, shprehet qartë se është xhehenemi. Atëherë, për të arritur shpëtimin dhe për të hyrë në xhenet, çfarëdo që të thonë njerëzit, edhe Ithtarët e Librit, si gjithë të tjerët, janë të obliguar dhe përgjegjës për t'i besuar Muhamedit (a.s.) dhe për t'u bërë myslimanë.

1. Buhari, Ilim 31; Muslim, Iman, 241; Tirmizdhi, Nikah 25; Nesai, Nikah 65, Darimi, Nikah 48; Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 402, 405. Në disa transmetime të hadithit, përmendet shprehja "ai që i beson librit të mëparshëm dhe pastaj librit të mëvonshëm". (Shik. Tirmidhi, Nikah 24; Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 405.).

2.) Shik. Buhari, Bed'u'l-vahj 6; Xhihad 102; Tefsiru sure(3), 4; Muslim, Xhihad 74; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 268. Veçanërisht shik. M. Hamidullah, Pejgamberi i Islamit, I, 333; el-Vesaiku's-sijasijje, nr: 26.

3. Surja el-Hadid, 57/28; Surja Taha, 20/47.

NDIKIMI I KAMATËS TE NJERIU

Xhafer Durmush

Islami kërkon nga ithtarët e tij që t'i themelojnë mbi drejtësi marrëdhëniet e tyre njerëzore. Në fenë tonë është detyrë të mos e dëmtojmë veten dhe të mos i dëmtojmë të tjerët.

Ndërsa kamata është një procedurë e padrejtë në bazë. Për këtë arsye, Kurani Fisnik i urdhëron besimtarët me këmbëngulje që të largohen prej saj. I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka njoftuar se ky mjet kolonizimi "*gjithmonë do të jetë nën këmbë*"...

Që të gjithë ne po jetojmë në shoqërinë e sotme. Në të vërtetë, duke u nisur nga pika në të cilën ka ardhur jeta e shoqërisë, besojmë se duhet t'i lexojmë përsëri me nënshtrim ndaj Zotit (xh.xh.), ajetet që flasin rreth ndalimit të kamatës, të meditojmë rreth kuptimit të tyre dhe t'ia bëjmë disa pyetje vetes.

Në ajetet e sures Bakara, që flasin rreth kësaj çështjeje, Allahu i Madhëruar thotë:

"Ata që marrin fajde, do të ringjallen *(në Ditën e Gjykimit)* ***si ai që djalli e ka çmendur me prekjen e vet, sepse ata thonë se tregtia është njëlloj si kamata. Porse Allahu e ka lejuar tregtinë, kurse kamatën e ka ndaluar. Ai të cilit i vjen këshilla nga Zoti i tij dhe i shmanget kamatës, le ta mbajë atë që tashmë ka fituar dhe fati i tij është në duart e Allahut. Ndërsa ata që i kthehen kamatës sërish, do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu ia heq çdo përfitim kamatës*** *(ia heq bereqetin pasurisë në të cilën përzihet kamata)****, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë. Allahu nuk i do ata që janë mohues - gjynahqarë."*** (Bakara, 275-276)

Çfarë thoni? Ah sikur ta mendonim urdhrin e Allahut dhe me fjalën e mësipërme të Pejgamberit... Ndoshta atëherë do ta perceptonim përsëri se këto janë nga një ftesë e bekuar, që na hapin horizontin tonë. Pastaj do ta marrim veten në llogari sipas kuptimit të atyre. Ftesën e ajeteve që thërrasin për ta bërë çdo punë me drejtësi, do ta dëgjojmë me gjithë zemër.

Paramendoni, këto ajete na tërheqin vërejtjen që të mos mbytemi në telashet e ditës. Ata na tregojnë si qëllim të ardhmen dhe na thonë: "I rëndësishëm është qëndrimi yt në Ditën e Kiametit. Prandaj, ki kujdes ndaj veprave të tua!" Nisur nga kjo, zgjedhjet tona duhet të jenë ato që mund të na çojnë me fytyrë të bardhë në audiencën e Zotit Ditën e Gjykimit...

Si mund të guxojë një mysliman ta bëjë këtë, ndërkohë që hadithi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është i qartë:

"Allahu e mallkoftë atë që e ha kamatën, që i bën të tjerët ta hanë, që dëshmon dhe që e shkruan atë."

Kjo është tabloja që i kërkohet njeriut ta përfytyrojë: Ai që ha pasurinë e fituar me kamatë (ai që merr pasurinë e tjetrit pa të drejtë, në kuptimin e vërtetë të fjalës), Ditën e Kiametit do të ngrihet nga varri i tij si dikush i kapur nga krizat epileptike. Atëherë, sa gjë e keqe është ajo që ka marrë ai! Sa gjë e keqe është ajo, saqë tërheq ndëshkimin hyjnor dhe ndikimi i saj fillon nga kjo botë e deri në tubimin e Kiametit. Ajo është një erë aq e keqe, saqë nuk është parë asnjëherë. Asgjë nuk mund ta heqë nga vendi në të cilin gjendet. Atë nuk mund ta heqin as vitet dhe as shekujt...

Siç shprehet edhe në ajetin fisnik, marrësit e kamatës do të ndëshkohen, ngaqë thonë se edhe tregtia është si kamata. Ndërkohë, e vërteta nuk është ashtu siç pohojnë ata.

Sistemi i kamatës nuk është shkëmbim reciprok si tregtia. Ngaqë këto të dyja nuk i ngjajnë njëra-tjetrës, Allahu Teala njërën e ka bërë hallall dhe tjetrën e ka bërë haram.

Në literaturën fetare kamata përkufizohet si "teprica që ngelet pa paguar në çfarëdo lloj tregtie qoftë". Me një thënie tjetër, të lësh diçka jo si pagesë me qëllimin e pagesës. Nisur nga ky aspekt, kamata është një iluzion që nuk ka bazë. I ndjeri Elmallëllë e përkufizon kështu pohimin për shkëmbim që pandeh fajdexhiu: "Ky është një veprim më imagjinar se shitja e florinjve si kundërvlerë e kërcitjes së florinjve të tjerë."

Allahu i Lartësuar shprehet në ajetet fisnike se do ia pakësojë begatinë pasurisë në të cilën përzihet kamata, ndërsa do ta shtojë pasurinë që jepet lëmoshë. Domethënë se çdo gjë nuk është siç duket në pamjen e jashtme. Punët nuk ecin vetëm me shkaqet materiale. Ndoshta pjesa e dukshme e kësaj, është më e saktë të themi se ka lidhje të drejtpërdrejtë me shpirtëroren.

Nisur nga kjo që thamë më sipër, një pasuri që nuk ka begati nga ana e Allahut Teala, në të vërtetë tretet sado që duket sikur po shtohet. Me fjalë të tjera, diçka që fitohet me rrugë ilegale nuk do ta gëzojë njeriun as në këtë botë dhe as në botën tjetër...

Shtimi i vërtetë i pasurisë, edhe pse në pamje të jashtme duket sikur pakësohet, është në fjalën e Allahut, i cili thotë se "do ta bëj të bereqetshme", pra, në pasurinë prej së cilës jepet lëmoshë, do të ketë shumë bereqet.

"Sëmundja e kamatës nuk u intereson vetëm dy palëve që e praktikojnë, por i intereson të gjithë shoqërisë. Nisur nga kjo, nëse kamata përhapet në një shoqëri, ia prish asaj qetësinë shpirtërore. Ajo e ndalon zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme. Në një shoqëri që zbatohet kamata, virtytet njerëzore nuk përsosen në masat që parashikon feja. Ndjenjat e vëllazërimit dhe ndihmës reciproke nuk japin filiza në nivelin e kërkuar.

Sepse aty, qetësia dhe lumturia e shoqërisë është flijuar për hir të interesave të disa personave. Nëse besimtarët nuk e këshillojnë dhe nuk e paralajmërojnë njëri-tjetrin kundrejt një rreziku që sa vjen e rritet, ndjenja e dëshpërimit përhapet me kalimin e kohës në shoqëri. Tashmë njerëzit binden se jeta

sociale nuk mund të themelohet pa kamatë. Ata që fitojnë me mundin dhe djersën e ballit, mund të bien në pesimizëm...

Mendoni! Islami e ka zhdukur nga njerëzit hijen e errët të kësaj sëmundjeje që e shkatërron jetën individuale dhe shoqërore. Ndërkohë, niveli që kanë arritur shoqëritë e sotme, akoma është një utopi. Dhe siç shikohet, tendenca reale nuk është në aspektin e heqjes totale të kamatës, por në aspektin e uljes së përqindjeve."

Atëherë, besimtarët duhet ta lënë kamatën dhe atë gjë që dyshohet se është e përzier me kamatë... Në shkencën e fikut (jurisprudencës islame) thuhet: "Dyshimi në kamatë është përgjegjësi." Besimtari duhet të ruhet edhe nga gjërat që mbartin dyshimin për kamatë siç ruhet edhe nga kamata.

Për ta rinovuar vetëdijen që duhet të ketë myslimani në lidhje me këtë çështje, nevojitet t'i hidhet një sy shpjegimit të ajeteve në veprën me titull "Hak Dini Kur'an Dili". Ndërsa për informacione më të rëndësishme që duhet të dihen, duhet të lexohen nenet përkatëse nga vepra me titull "Ticaret ve İktisat İlmihali". Të paktën, mendimi ynë në çështje të rëndësishme si "ndryshimi ndërmjet fitimit dhe kamatës", duhet të jetë i qartë... Prof. Dëndyreni thotë në lidhje me çështjen e "pastrimit të haramit që përzihet në pasuri": "Nëse në një pasuri është përzier hallalli dhe harami dhe, nëse nuk dihet se cila pjesë është hallall dhe cila pjesë është haram, duhet të seleksionohet pjesa që konsiderohet haram aq sa ta hiqet dyshimi. Nëse kjo zgjidhje, e cila në shikim të parë duket si e vështirë për t'u zbatuar, kryhet me besim dhe vendosmëri, sjell begati dhe jo varfëri, sjell prehje dhe jo vështirësi."

Cilësia e fjalëve të zgjedhura për lavdërim apo për qortim në Kuranin Fisnik, është e rëndësishme. Por, nëse paralajmërimin hyjnor në ajetet që i kemi përkthyer e lexojmë duke menduar se bëhet fjalë vetëm për ata që e hanë kamatën, do të thotë se kemi rënë në një gabim të madh. Të pranuarit për t'u bërë pala që e jep kamatën, duke u përzier në procedurat e kamatës me pretekste të pavlefshme, e shkatërron personalitetin e myslimanit... Si mund të guxojë një mysliman ta bëjë këtë, ndërkohë që hadithi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është i qartë: "Allahu e mallkoftë atë që e ha kamatën, që i bën të tjerët ta hanë, që dëshmon dhe që e shkruan atë."

Le të besojmë se një ditë, të gjithë do ta matin përsëri largësinë që duhet të kenë nga kjo sëmundje, e cila e bren besimin aq sa përzihet në vepra, sepse të menduarit se sot punët nuk mund të ecin pa kamatë, e zvarrit njeriun në një dobësi të rrezikshme besimi...

Pyetja e ditës duhet të jetë kjo: A qëndroj larg nga kamata dhe nga procedurat që mbartin dyshimin e kamatës siç urdhërojnë urdhrat e qarta të fesë?

Sipas nesh, rreziku i vërtetë është që njerëzit të fillojnë të ushtrohen me veprimet që kanë kamatë dhe të fillojnë ta shikojnë atë si tregtinë. Pra, humbja e ndjeshmërisë për largimin nga kamata.

Dëshmorët nuk vdesin

Osman Ersan

Shehid / dëshmor quhet myslimani i cili vritet prej armikut gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala. Rënia dëshmor, edhe pse i vjen shumë rëndë nefsit, është kalim në një botë të përhershme dhe të lumtur. Dëshmorët shkojnë në jetën e përhershme duke flijuar për hir të Allahut gjënë më të vlefshme që kanë, pra jetën e tyre.

Rënia dëshmor është një gradë shumë sublime dhe e nderuar sipas fesë sonë. Në Kuranin Fisnik thuhet: ***"Mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni!"*** (Bakara, 154)

Dëshmorët jetojnë te Allahu Teala dhe furnizohen me mirësi shpirtërore në pozita të larta të specifikuara për ta. Në ajetin fisnik thuhet:

"Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre *(dhe ende nuk kanë rënë martirë)****, sepse nuk do të frikësohen*** *(për çfarë i pret)* ***dhe nuk do të pikëllohen*** *(për çfarë kanë lënë pas)****. Ata gëzohen me dhuntitë dhe mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve."*** (Al Imran, 169-171)

Edhe në hadithin fisnik thuhet:

"Shpirtrat e dëshmorëve janë brenda zogjve të gjelbër. Ata pinë nga lumenjtë dhe hanë nga frutat e xhenetit. Ata lëvizin lirisht në xhenet. Strehohen te kandilat prej floriri që ndodhen nën Arsh. Kur të shohin se sa të bukura janë ushqimet, vendbanimet dhe pijet e tyre, thonë kështu, në mënyrë që edhe vëllezërit e tyre ta admirojnë xhihadin:

"Ah sikur populli ynë ta dinte se çfarë mirësish na ka dhënë Allahu!"

Allahu Teala u thotë dëshmorëve: "Unë do t'i njoftoj ata në vendin tuaj për gjendjen në të cilën ndodheni. Në këtë mënyrë, ata do të gëzohen për këtë përgëzim dhe

do të jenë të lumtur." Pastaj zbret këtë ajet fisnik." (Ajetin e mësipërm. Shënim i përkth.) (Muslim, Imare, 121.)

Ata që luftojnë në rrugë të Allahut Teala, do të kenë gradën më të lartë në xhenet. Në hadithin fisnik, thuhet:

"Allahu Teala ka përgatitur njëqind grada në xhenet për ata që luftojnë në rrugë të tij. Largësia e një grade nga grada tjetër është sa largësia e tokës me qiellin." (Buhari, Xhihad, 4.)

Grada e rënies dëshmor është njëra prej gradave më të larta në xhenet. Kur dëshmori ta shikojë këtë, do dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë, në mënyrë që të bjerë dëshmor sa më shumë herë që të jetë e mundur. Në hadithin fisnik thuhet:

"Çdo njeri që do hyjë në xhenet, nuk do dëshirojë të kthehet pas në këtë botë, edhe sikur çdo gjë e kësaj botë të ketë qenë e tij. Përveç dëshmorit, sepse kur të shikojë vlerësimin dhe nderimin e madh që do t'i bëhet, do të dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë dhe të bjerë dhjetë herë dëshmor." (Buhari, Xhihad, 21.)

Xhihadi në rrugë të Allahut Teala është prej ibadeteve më të virtytshme. Ebu Hurejra, (r.a.), transmeton:

"Të Dërguarin e Allahut, (a.s.), e pyetën:

"O i Dërguari i Allahut! Cila vepër është e barabartë me xhihadin në rrugë të Allahut?" Ai u përgjigj:

"Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë." Të njëjtën pyetje ia përsëritën dy ose tri herë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në çdo herë dha këtë përgjigje: *"Asnjë vepër nuk është e barabartë me atë."*

Xhenazet e atyre që bien dëshmorë gjatë luftës në rrugë të Allahut Teala, varrosen pa u larë dhe me rrobat e gjakosura që kanë. Kjo konsiderohet si një shenjë se ata janë të pastër.

Dëshmorët do të vijnë në vendin e mahsherit / tubimit në Ditën e Gjykimit duke u rrjedhur gjaku si në ditën kur kanë rënë dëshmor apo janë plagosur. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në një hadith fisnik:

"Ai që plagoset në rrugë të Allahut, Ditën e Gjykimit do të dalë në audiencën e Allahut Teala duke i rrjedhur gjak nga plaga e tij. Gjaku do të ketë ngjyrën e vet, ndërsa era do të jetë erë misku." (Buhari, Xhihad, 10.)

Allahu Teala ua lehtëson dëshmorëve dhimbjet dhe vuajtjet e vdekjes. Kjo e vërtetë shpjegohet kështu në hadithin fisnik:

"Aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur e pickon milingona, aq dhimbje ndjen nga vdekja edhe ai që bie dëshmor." (Muslim, Imare, 156.)

Dëshmorëve u falen të gjitha mëkatet, përveç borxheve që mund t'u kenë njerëzve. Edhe këto borxhe, Allahu Teala do t'ua falë në Ditën e Kiametit pasi të zotëve të borxheve t'u japë prej mirësive të xhenetit dhe ata t'ua bëjnë hallall (dëshmorëve).

Mirësitë që fitojnë dëshmorët janë të pafundme. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

"Kur dëshmori të vritet, ndjen dhimbje nga vdekja aq sa ndjen dhimbje ndonjëri prej jush kur pickohet. Dëshmori ka shtatë cilësi: Falet që në pikën e parë të gjakut që i rrjedh. E shikon vendin e tij në xhenet. Shpëton nga ndëshkimi i varrit. Është i sigurt prej frikës më të madhe (frika prej kiametit). Në kokë i vendoset një kurorë aq e mrekullueshme, saqë një rubin i vetëm i kësaj kurore është më i vlefshëm se dynjaja dhe nga çdo gjë e dynjasë. Ai martohet më shtatëdhjetë e tri gra prej hyrive. I jepet leje të ndërmjetësojë për shtatëdhjetë vetë prej të afërmve të tij." (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 26.)

Grada e dëshmorëve është grada e tretë, e cila vjen pas asaj të pejgamberëve dhe të sinqertëve. Në ajetin fisnik shprehet kështu:

"Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!" (Nisa, 69)

Në fenë tonë, qëllimi dhe sinqeriteti janë të vlefshëm po aq sa vetë veprat. Ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në luftë për hir të Allahut të Lartësuar, këtë qëllim duhet ta mbartin në zemrat e tyre, sepse në hadithin fisnik thuhet:

"Atë që dëshiron me gjithë zemër të bjerë dëshmor, Allahu do ta lartësojë në gradën e dëshmorëve edhe nëse vdes në shtratin e tij." (Muslim, Imare, 157.)

Edhe në një hadith tjetër fisnik thuhet:

"Kushdo që ndërron jete pa luftuar dhe pa mbartur në zemër dëshirën për të luftuar, ndërron jetë mbi një lloj hipokrizie." (Muslim, Imare, 158.)

Ata që vriten në rrugë të Allahut Teala, janë dy llojesh: Lloji i parë janë ata që vriten në luftën e vogël duke e flijuar jetën e tyre me qëllim që të arrijnë pëlqimin e Allahut. Ndërsa lloji i dytë janë ata që vriten në luftë të madhe duke e shkatërruar nefsin me shpatën e dashurisë ndaj Allahut. Ky lloj është më i lartë se lloji i parë. Të gjithë ata që vriten në këto dy luftëra jetojnë në një formë jete të vërtetë te Zoti i tyre. Ata furnizohen në xhenet me mirësi shpirtërore. (Mahmud Sami Ramazanogllu, Uhud Gazvesi, fq. 105.)

Dëshira e vetme që i ka bërë myslimanët shekull pas shekulli të vrapojnë nga një front në një front tjetër dhe nga një fitore në një fitore tjetër, gjithmonë ka qenë ky besim dhe entuziazëm.

TA BËSH PUNËN SIÇ DUHET

M. Sami Ramazanollu

I Dërguari i Allahut (a.s.), në një hadith fisnik thotë:

"Kur dikush të bëjë një punë, Allahu do që ta bëjë mirë dhe bukur." (Taberani)

Fjala "ihsan", e cila është infinitivi i fjalës "juhsinu", e cila përmendet në këtë hadith fisnik, ka këto kuptime:

1. Të bësh mirësi.

2. Ta bësh mirë dhe bukur diçka.

3. Ta pranosh diçka si të mirë dhe të bukur.

4. Siç transmetohet edhe në një hadith tjetër fisnik: *"Ta adhurosh Allahun sikur e shikon."*

Shpjegimet e hadithit fisnik sipas secilit prej kuptimeve të mësipërme:

1. Allahu i Madhëruar kërkon nga çdo rob të bëjë mirësi në çdo punë e vepër të tij dhe të jetë i dobishëm edhe për të tjerët.

2. Allahu Teala kërkon që robi i Tij ta bëjë bukur atë punë me të cilën merret (duke mos nxjerrë justifikime).

3. Allahu i Lartësuar do që robi i Tij ta njohë mirë punën që bën.

4. Allahu (xh.xh.), do që kur dikush të bëjë ndonjë punë, ta bëjë sikur e shikon Atë.

Kuptimi i parë: Ky është një rregull sublim që i dënon njerëzit materialistë, egoistë dhe lakmitarë dhe që gjithmonë e mbron shoqërinë dhe rendin social në çdo punë. Në Islam altruizmi është bazë. Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Më i mirë prej jush është ai që u bën më shumë dobi njerëzve."*

Kuptimi i dytë: Ky është një rregull rinovimi dhe përsosmërie që i kështillon njerëzit, të cilët i përkasin çfarëdo lloj profesioni apo zanati, të nxjerrin gjithmonë gjëra të reja në profesionet dhe zanatet e tyre, ta bëjnë punën bukur dhe në mënyrë të përsosur dhe të mos ndalojnë qoftë edhe një çast avancimin që sjellë përparimi.

Kuptimi i tretë: Ky është një rregull që na tregon se duhet t'i mësojmë kufijtë e punës apo profesionit që kemi, të bëhemi specialistë në atë punë apo profesion, të largohemi nga veprat dhe imitimet e verbra dhe t'i përvetësojmë si udhëzues rregullat e dijes së dobishme prej të cilave përfitojmë. Këtë duhet ta bëjmë me mendje të shëndoshë, duke i shqyer perdet e hekurta të injorancës dhe të traditave prapambetëse.

Kuptimi i katërt: Të gjitha këto kuptime janë një burim i lartë udhëzimi, që tregon drejtimin shpirtëror. Po ashtu, janë faktori më i madh që do na mundësojë të sillemi e të veprojmë "sikur e shohim Allahun Teala", të mendojmë se Ai shikon, dëgjon dhe di çdo gjë të fshehtë apo të hapur dhe na e mundëson që këtyre t'u besojmë me një sinqeritet të plotë. Nëse veprojmë kështu, atëherë kjo do na shpëtojë nga devijimi në rrugë të gabuara dhe gjithmonë do na japë fuqi e iniciativë të fortë në përpjekjen tonë përgjatë gjithë jetës.

Hadithet fisnike në lidhje me kërkimin e riskut dhe tregtinë:

"O njerëz! Betohem se nuk ju kam urdhëruar ndonjë gjë përveç asaj që ka urdhëruar Allahu. Po ashtu, nuk ju kam ndaluar përveç atyre gjërave që jua ka ndaluar. Kërkojeni riskun duke u sjellë mirë dhe mos devijoni në mashtrime, lakmi dhe gjëra të palejuara! Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin e Ebu'l-Kasimit, se risku ju kërkon siç ju kërkon edhe exheli. Atëherë, nëse përjetoni ndonjë vështirësi (në çështjen e riskut), kërkojeni atë në bindje ndaj Allahut të Madhëruar! (Kërkojeni duke vepruar brenda kornizës së urdhrave të Allahut!)" (Taberani)

"Mos u betoni shumë në shitblerje, sepse, edhe nëse sigurohen të ardhura nga kjo, më së fundi nuk do të ketë begati." (Ahmed b. Hanbel, Muslim.)

Betimi, i cili është ndaluar në këtë hadith fisnik është betimi i vërtetë. Ndërsa betimi i rremë është haram, edhe nëse është mashtrim i vogël.

"Kush ia lehtëson borxhliut dhe i lë kohë e mundësi për të paguar, apo ia fal të gjithë borxhin, Ditën e Kiametit do të jetë nën hijen e Arshit." (Muslim)

Në ajetin e 280-të të sures Bakara, thuhet: ***"Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin*** *(e shlyerjes së borxhit)* ***derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t'ia falni borxhin, veç sikur ta dinit."***

"Kurrë nuk ka ngrënë ndonjë njeri ndonjë ushqim më të mirë se ai që e ka fituar me punën e tij. Në të vërtetë, edhe pejgamberi i Allahut, Davudi (a.s.), ka ngrënë nga puna e tij." (Buhari)

Sipas ajetit të 80-të të sures Enbija dhe ajetit të 10-të të sures Sebe në Kuranin Fisnik, Davudi (a.s.), ka qenë hekurpunues. Ai bënte parzmore dhe në këtë mënyrë, jetonte me atë që fitonte nga dora e tij.

"Tregtari i sinqertë në fjalët e veprat e tij dhe i cili është njeri i besueshëm,do të tubohet bashkë me pejgamberët, të sinqertët dhe dëshmorët." (Nesai)

Është e pamundur të mos habitesh ndaj mendjes dhe shkujdesjes së atyre që nuk ia dinë vlerën apo që bëjnë sikur nuk ia dinë vlerën kësaj grade sublime që do t'i jepet tregtarit të ndershëm e të sinqertë dhe bëjnë tregti me spekulime, korrupsione, hile dhe mashtrime. Sidoqoftë, gropa në të cilën do të hyjë më në fund është një copë toke e zezë.

SËMUNDJA E VETËPËLQIMIT

Dr. Adem Ergyl

Përafërsisht, në treqind vende në Kuranin Fisnik përmendet fjala "nefs". Kuptimet leksikore dhe kuptimet në të cilat kjo fjalë përdoret në Kuran ndryshojnë sipas vendit në të cilin përdoret. Bazuar në këtë, kësaj fjale i janë dhënë afërisht njëzet kuptime si "vetvetja, esenca dhe e vërteta e një gjëje", "shpirt", "jetë", "zemër", "gjak", "trup", dhe "ego". Ndërsa kuptimi i përgjithshëm terminologjik i kësaj fjale në literaturën e mistikës islame është përkufizuar në këtë mënyrë: "E vërteta e njeriut" dhe "qendra shpirtërore në të cilën gjenden të mbledhura ndjenjat e këqija të njeriut ose qendra kryesore e fuqisë së zemërimit dhe epshit, që gjendet te njeriu". Nisur nga pikëpamja e këtij këndvështrimi, rregulli: "Ai që e njeh nefsin e tij, e njeh edhe Zotin", është përdorur gjithmonë si kaide-i kullijje / rregull i përgjithshëm.

Rezistimi kundrejt dëshirave të padobishme të nefsit dhe gjendja shpirtërore e zgjuar kundrejt mashtrimeve dhe dredhive të saj, është konsideruar si një përpjekje e domosdoshme për të arritur shpëtimin në procesin e pastrimit dhe arritjes së përsosmërisë nga ana e njeriut (tezkijes). Ja pra, në një urtësi të tij, në natyrën e justifikimit të kësaj përpjekjeje, Ibn Ataullah el-Iskenderi (k.d.), shprehet:

"Burimi i çdo mëkati, neglizhence ndaj Zotit dhe dëshirave të padobishme, është pëlqimi i nefsit / vetes dhe bindja ndaj saj. Ndërsa themeli i çdo lloj bindjeje ndaj Zotit, largpamësisë, mosshkujdesjes në fe dhe nderit është mospëlqimi i vetes. Qëndrimi me një injorant, që është i zgjuar kundrejt dredhive të nefsit dhe që nuk vuan nga sëmundja e vetëpëlqimit është më i mirë se qëndrimi me një dijetar që e pëlqen veten dhe që u bindet dëshirave të saj.
Cila dije mund ta bëjë një dijetar të jetë i kënaqur me nefsin / veten e tij? A mund të quhet dije një dije e tillë? Po ashtu, cila injorancë mund ta vërë në gatishmëri poseduesin e saj kundrejt nefsit të tij dhe ta bëjë që të mos e pëlqejë vetveten? A mund të quhet injorancë një injorancë e tillë?

Majasë së nefsit të njeriu i është dhënë animi dhe aftësia për të keqen (fuxhur), si domosdoshmëri e sprovimit hyjnor dhe fuqia për t'u mbrojtur dhe pastruar nga ajo (takva). Për këtë arsye, çdo nefs që nuk kalon nga procesi i pastrimit dhe edukimit, është një nefs i papjekur që vazhdimisht e urdhëron njeriun për të bërë keq. Edhe pse nganjëherë njeriu e "kritikon veten e tij" sipas fuqisë së devotshmërisë që ka brenda, kjo kritikë shpeshherë nuk mjafton për ta parandaluar nefsin. Korrja e fitores kundrejt nefsit arrihet vetëm me mbrojtjen dhe ndihmën hyjnore. Ndërsa arritja e kësaj ndihme dhe mëshire hyjnore realizohet vetëm duke e përkujtuar Allahun Teala vazhdimisht, duke kërkuar strehim tek Ai dhe duke e shtuar devotshmërinë tonë ndaj Tij. Në Kuranin Fisnik theksohen këto të vërteta në këtë ajet që thuhet nga goja e Jusufit, (a.s.):

"Unë nuk e shfajësoj veten, sepse nefsi *(i njeriut)* ***është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë."*** (Jusuf, 53)

Edhe pse nganjëherë njeriu e "kritikon veten e tij" sipas fuqisë së devotshmërisë që ka brenda, kjo kritikë shpeshherë nuk mjafton për ta parandaluar nefsin. Korrja e fitores kundrejt nefsit arrihet vetëm me mbrojtjen dhe ndihmën hyjnore.

Perceptimi i këtij aspekti të nefsit dhe ruajtja nga ajo është zgjuarsi, ndërsa të qenët i sigurt prej saj është gaflet /shkujdesje / neglizhencë. Themeli i përparimit është mospranimi i nefsit si i mjaftueshëm. Fillimi i mendimit "arrita përsosmërinë", te një njeri është shkak i ndalesës së tij në rrugën e përparimit, ndërsa vazhdimësia e këtij mendimi është shkak i rënies së tij. Edhe rritja dhe lartësimi që modestia i bën njeriut janë të ndërtuara mbi këtë fshehtësi.

Allahu i Lartësuar nuk i pranon shtirjet e robërve të Tij për ta shfaqur veten si të pastër dhe të dëlirë dhe pohimet e tyre për devotshmëri. Nisur nga kjo, thotë:

"Për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave imorale, përveç gjynaheve të vogla, me të vërtetë, Zoti yt është i Gjerë në falje. Ai ju njeh mjaft mirë, qysh se ju krijoi nga dheu dhe qysh se keni qenë embrion në barkun e nënave tuaja. Prandaj, mos u lavdëroni me pafajësinë tuaj! Ai i njeh më së miri ata që ruhen nga gjynahet." (Nexhm, 32)

Sëmundja e vetëpëlqimit, apo me një shprehje tjetër, të qenët i kënaqur me nefsin, është një ndjenjë helmuese që e ndalon kërkimin e mirësisë dhe përsosmërisë. Kjo ndjenjë e fton njeriun në shumë mëkate dhe moral të keq. Ata të cilët e kanë këtë cilësi, vazhdimisht i kërkojnë gabimet dhe mangësitë te të tjerët, ngaqë nuk shohin asnjë gabim apo mangësi te vetja e tyre. Ata janë mendjemëdhenj. I nënçmojnë të tjerët dhe nuk pëlqejnë asnjë. Nuk pendohen dhe nuk i kërkojnë falje Zotit (xh.xh.). Nuk i luten dhe nuk i përgjërohen të Plotfuqishmit. Ata zihen me të gjithë dhe i shohin si shumë të vogla mëkatet e tyre.

Kjo fjalë e Abdullah ibn Mes'udit, (r.a.), e tregon këtë të vërtetë:

"Besimtari e shikon mëkatin e tij kështu: Sikur vetja i duket i ulur nën një mal, që çdo çast mund t'i bjerë sipër. Ai vazhdimisht ka frikë në mos ky mal i bie mbi kokë. Ndërsa mëkatari e shikon mëkatin e tij si një mizë që i kalon nga hunda." Kur Ibn Mes'udi e tha këtë fjalë, bëri me dorë sikur po trembte mizën nga hunda e tij.

Kurani Fisnik ua tërheq vërejtjen besimtarëve që të mos anojnë nga dëshirat e nefsit, domethënë nga dëshirat e pasionet e nefsit që janë të ndaluara në Islam dhe u kërkon atyre të jenë të zgjuar ndaj kësaj gjendjeje. Madje, duke folur për ata që i kanë bërë zot dëshirat e tyre vetjake, thekson edhe pikat e rrezikshme në të cilat nefsi mund ta zvarrisë njeriun. Në lidhje me këtë çështje, na shtron para sysh si një tablo procesin e shkatërrimit të Bel'am b. Bauras:

"Tregoju atyre** (hebrenjve) **për njeriun** (Bel'am b. Bauran)**, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por ai u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë** (me shpalljet Tona)**, por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë." (A'raf, 175-176)

Ai që është i vetëdijshëm për dredhitë dhe mashtrimet e nefsit, vazhdimisht lufton për ta mposhtur armikun që ka brenda vetes, në vend që ta kërkojë atë jashtë. Ai bëhet gati për një xhihad të madh, duke i besuar nga zemra këtij deklarimi të të Dërguarit të Allahut, (a.s.): *"Luftëtari i vërtetë është ai që lufton me nefsin e tij."* (Tirmidhi)

Shpeshherë njeriu i sheh si të vogla mangësitë dhe mëkatet e tij. Sikundër kësaj, gabimet e të tjerëve i zmadhon dhe i ekzagjeron në syrin e tij. Sigurisht se si rezultat i kësaj, në vend që të rregullojë veten e tij, kaplohet nga halli për të rregulluar të tjerët. Kjo gjendje është argument i qartë se dëshirat vetjake e kanë verbuar syrin.

Mevlana, në veprën e tij me titull "Fihi Mafih", e shtjellon këtë çështje duke thënë: "Njeriu nuk neveritet nga lebra dhe çibani i tij. Dorën e plagosur e fut në gjellë dhe e lëpin gishtin. Nga kjo nuk ndjen aspak neveri dhe nuk i vjen për të vjellë. Por, nëse shikon një çiban apo ndonjë plagë të vogël te dikush tjetër, atëherë nuk e ha atë ushqim dhe ndjen neveri. Prandaj veset e këqija te njerëzit u ngjajnë lebrës dhe çibanit. Kur e keqja gjendet te vetja e tij, nuk neveritet dhe nuk lëndohet. Por, nëse diçka e vogël prej kësaj të keqeje gjendet te dikush tjetër, ndjen neveri dhe urrejtje. Atëherë, nëse ai tmerrohet dhe ndjen neveri nga ti siç tmerrohesh dhe ndjen neveri edhe ti prej atij, toleroje atë!"

Ai që e di natyrën e vërtetë të nefsit dhe që është i vetëdijshëm se çfarë duhet të bëjë kundër tij, është një rob i devotshëm që ka marrë pjesë nga devotshmëria, cilido që të jetë niveli i tij në dije. Sikundër kësaj, ai që e pëlqen veten dhe është i kënaqur prej saj, në të vërtetë është një i shkretë i privuar nga devotshmëria dhe dija e vërtetë, sado që të ketë dije të gjerë. Nisur nga kjo që thamë, miqësia dhe shoqëria me dikë që e njeh nefsin e tij është një mundësi e shkëlqyer për t'u lartësuar shpirtërisht. Ndërsa shoqërimi me dijetarë, që e shikojnë veten e tyre pa mangësi dhe gabime, nuk i jep ndonjë gjë të madhe njeriut. Këto rreshta të Junus Emresë janë një shprehje e qartë e kësaj të vërtete:

Me ditë, me ditë
Por çka me ditë?
Kur gjë nuk di për veten,
Ç'vlerë ka leximi, pa gjetur veten?

Në një urtësi tjetër të tij, Ibn Ataullahu (k.s.), thotë se zbulimi dhe mrekullia e vërtetë është perceptimi i mangësive të nefsit. Ai shprehet:

"Të zbulosh gabimet dhe mangësitë e nefsit, është më mirë se të njohësh të fshehtat e gajbit."

Mevlana Xhelaleddin Rumiu (k.s.), thotë:

"Të shohësh mangësitë e vetes dhe ta qortosh nefsin, është melhem dhe ilaç për gabimet. Nëse dikush ndihet i lënduar e i brengosur dhe e beson ndërgjegjshmërisht këtë për shkak të mëkateve që ka bërë, ai merr pjesë nga hadithi në të cilin thuhet: "Nëse i pari i një populli ndihet i brengosur, kini mëshirë për të!"

Kërkimi i më të mirës në çdo kohë e në çdo gjë dhe përpjekja për ta arritur atë me besimin "më e mira është armik i të mirës", duke mos qenë asnjëherë i kënaqur me nefsin, është shenja më e rëndësishme e lartësimit dhe dijes së vërtetë.

Ai që e di natyrën e vërtetë të nefsit dhe që është i vetëdijshëm se çfarë duhet të bëjë kundër saj, është një rob i devotshëm që ka marrë pjesë nga devotshmëria, cilido që të jetë niveli i tij në dije.

Sadik Dana

PËRGOJIMI

Korrigjimi apo prerja e fjalës së atyre që përgojojnë apo që kanë mendime të gabuara në çështjet e besimit, nuk është sjellje e ulët, por përkundrazi, detyrë fetare dhe drejtësi.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk ia ndërpriste fjalën askujt, përderisa nuk sulmonte të vërtetën. Ndërsa, kur dikush sulmonte të vërtetën, ia ndërpriste fjalën duke e ndalur ose ngrihej nga ai kuvend dhe largohej.

Në lidhje me mirësjelljen duhet të veprojmë me masë. Ne duhet t'i lëmë justifikimet boshe, si bashkëbiseduesi është më i madh se unë në moshë, si mund t'i dal kundër fjalës së tij apo, nëse nuk e dëgjoj, do të zemërohet me mua.

Ata të cilët tundin kokën e tyre vazhdimisht në kuptim të pranimit të diçkaje, duke e fshehur të vërtetën, sigurisht se janë të barabartë në përgojim. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kur natën e miraxhit u nxora në qiej, pashë një grup njerëzish. Prej kraharorëve të tyre u këputej mishi dhe u jepej në gojë si kafshata. Përgjatë kësaj, atyre u thuhej: 'Hani prej mishit të vëllezërve tuaj!..' Kur e pashë këtë, pyeta Xhebrailin: 'O Xhebrail! Kush janë këta?' Ai m'u përgjigj: 'Këta janë përgojuesit prej umetit tënd."

Transmetojnë Xhabiri dhe Ebu Saidi (r.a.), se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Mos përgojoni! Me të vërtetë përgojimi është më i keq se zinaja, sepse kur robi bën zina, më vonë pendohet dhe Allahu ia pranon pendimin. Ndërsa atë që përgojon, Allahu nuk do ta falë derisa ta falë ai që është përgojuar."

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kur të flasësh për vëllain mysliman në një formë që atij nuk i pëlqen, e ke përgojuar atë."

Miqtë e Allahut, dijetarët dhe të sinqertët i sundojnë zemrën, gjuhën dhe detyrat e adhurimit. Nisur nga e vërteta se është kollaj të flasësh, edhe të përgojosh nuk është aq e vështirë, sepse të ndihmon edhe nefsi. Ata të cilët janë të dhënë pas përgojimit, nuk mund ta lënë në asnjë lloj mënyre përgojimin. Përgojimi sot është bërë prej sëmundjeve më të këqija shpirtërore, e cila praktikohet më së shumti për shkak se është pakësuar fetaria, dija rreth Allahut dhe frika ndaj Tij. Për të shpëtuar nga kjo, duhet ta frenojmë vullnetin tonë dhe të frekuentojmë në ligjëratat / kuvendet e të devotshmëve dhe të sinqertëve. Njeriu që e di kuptimin e ajetit ***"ve huve meakum ejne ma kuntum / Ai është me ju kudo që të ndodheni"***, gjithmonë është i zgjuar. Sjelljet dhe veprat e atij njeriu, i cili e di së është nën vëzhgimin e Zotit, dhu'l-xhelali ve'l-ikram, janë në përputhje me pëlqimin e Allahut Teala. Ai largohet nga sjelljet e papërshtatshme. Nuk ulet këmbë mbi këmbë apo sikur të jetë i shtrirë pa pasur ndonjë arsye dhe largohet nga ata që e duan tepër këtë botë dhe ata që përgojojnë, sikur ikën nga luani.

SINDROMI X

Dr. Ali Akben

Shekulli në të cilin jetojmë, ka sjellë me vete edhe zhvillime shkencore e teknologjike të pabesueshme. Ndërsa të rejat që dëgjojmë në fushën e mjekësisë dhe biologjisë, për shumë prej nesh janë gjëra revolucionare. Aq sa shumë studime, që prej kopjimit të njeriut, qelizave embrionale, gjakut të kordonit e deri tek organet artificiale, nga një anë janë të reja të jashtëzakonshme, nga një anë janë zhvillime drithëruese.

Zgjatja e jetës po bëhet shkak që kohëve të fundit njeriu të përballet edhe me sëmundje të reja e të panjohura më parë. Në ditët tona, vendin e sëmundjeve vdekjeprurëse, si murtaja, kolera etj., e kanë zënë sëmundje të tjera.

Njeriu i ditëve tona, tashmë është në hall me stresin. Ai ka frikë nga sëmundjet e zemrës dhe të damarëve, nga kanceri dhe sindrome të reja, si sindromi-x. Me zhvillimin e shkencës ndryshojnë edhe sëmundjet. Ndërkohë që shkenca po vrapon pas zgjidhjeve, ne po njihemi edhe me shumë sëmundje të reja...

ÇFARË ËSHTË SINDROMI -X?

Siç kuptohet edhe nga emri, kjo sëmundje fsheh në vete shumë të panjohura. Ndryshimet në mënyrën tonë të jetesës, si stresi, vetmia, shqetësimi për të ardhmen, grindjet familjare, papunësia, substancat e dëmshme që thithim bashkë me ajrin, cilësia e keqe

e ujit që pimë, mungesa e aktivitetit fizik, gabimet e pafalshme në mënyrën e të ushqyerit dhe shumë gjëra të tjera, janë shkaqe që e lehtësojnë sëmundjen e sindromit-x.

Njerëzit e shëndoshë, ata që konsumojnë ushqime të fabrikuara dhe ata që nuk kujdesen për veten për shkak të punës apo ushqimit, e kanë më të lehtë të sëmuren me sindromin-x. Por, nëse ka edhe zakone të këqija, të papranueshme e të pafalshme si duhani, alkooli dhe droga, njeriu është kandidat i sigurt i kësaj sëmundjeje...

Simptomat kryesore të kësaj sëmundjeje janë:

-Të sëmurët janë të shëndoshë. Në mënyrë të veçantë dallohet pjesa e barkut, e cila është më e gjerë se 95 cm...

-Tensioni u luhatet në mënyrë të shpeshtë dhe është i lartë. Veçanërisht tensioni i ulët...

-Sheqeri në gjak është i prirur gjithmonë të jetë i lartë.

-Kolesterolin e keq e kanë të lartë, ndërsa kolesterolin e mirë të ulët.

-Përqindja e trigliceridës, pra yndyrës në gjak, është e lartë.

-Një substancë e quajtur acidi urik në gjak, ka gjithmonë e prirje të rritet.

-Mundësia e sëmurjes me diabet është e madhe.

-Lodhja, këputja dhe çrregullimi i gjumit janë të shpeshta.

-Kanë aktivitet fizik të pakët dhe duart e tyre janë të ndjeshme ndaj të ftohtit.

-Janë dembelë dhe rendimenti i punës së tyre është i ulët.

-Në jetën familjare mund të hasin shumë probleme.

-Kjo sëmundje është më e shpeshtë tek meshkujt.

-Janë të ekspozuar lehtë ndaj sëmundjeve të zemrës dhe damarëve.

-Rrjedhshmëria e gjakut është e ngadaltë dhe gjaku është i prirë për mpiksje.

Ka edhe shumë simptoma të tjera, por me kaq mund ta kuptojmë shumë mirë se shumica e njerëzve të ditëve tona janë kandidatë të fortë të kësaj sëmundjeje dhe të tjerave si kjo.

Edhe pse shumica jonë e dinë përgjigjen e pyetjes "cila është zgjidhja?", për shkak se nuk na shkon përshtat, në përgjithësi rrimë e presim të ndodhë ndonjë mrekulli. Aq sa duke shpresuar prej ilaçeve, ia vështirësojmë edhe më tepër punën vetes. Zgjidhja më e mirë është të rishikojmë mënyrën tonë të jetesës. Po si?

1-Duhet të bëjmë kujdes në ushqim. Çfarë të hamë, ajo bëhemi.

2-Duhen kryer aktivitete fizike për të ndihmuar tretjen e ushqimit.

3-Duhet t'i japim fund miqësisë me miellin e bardhë, sheqerin e bardhë dhe kripën.

4-Çfarëdo që të na ndodhë në jetë, jemi të detyruar të jemi pozitivë.

5-Tensioni dhe stresi duhet të dalë nga mënyra jonë e jetesës.

6-Duhet të qëndrojmë larg nga duhani dhe alkooli në mënyrë kategorike.

7-Kafet e tepërta dëmtojnë jo vetëm qelizat tona, por na konsumojnë shpejt edhe ne.

8-Në sajë të aktiviteteve të shpeshta fizike, duhet të shtojmë oksigjenin që hyn në qelizat tona.

9-T'i japim rëndësi ajrit dhe oksigjenit që thithim. Nuk duhet harruar se ajri i ndotur do të thotë oksigjen jocilësor. Dhe oksigjeni jocilësor është një nga substancat më të rëndësishme që ndryshk qelizat tona.

10-Për të eliminuar ndryshkjen e qelizave, duhet të konsumojmë ujë të bollshëm.

11-Vaji i ullirit, perimet, frutat e freskëta dhe buka e bërë nga mielli i papërpunuar, nuk duhet të mungojnë asnjëherë në sofrat tona.

12-Duhet të bëjmë kujdes me sa të mundemi që ushqimet që konsumojmë, të jenë natyrale dhe pa ingredientë shtesë.

13-Duhet të kujdesimi për dinamikën dhe vlerat tona shpirtërore. Për shkak se marrëdhënia me Krijuesin tonë zë vend të rëndësishëm në kurimin e kësaj sëmundjeje, nuk duhet t'i neglizhojmë kurrë lutjet, sepse lutja, nuk është vetëm një kërkesë, por edhe një strehim tek Krijuesi.

Të duash miqtë e Allahut dhe të qëndrosh bashkë me ta

Idris Arpat

Butësinë e zemrës kërkoje në ligjëratat e atyre që e përkujtojnë Allahun Teala.

Hajat bin Kajsi (r.a.)

Mjeshtri që e zbut një pemë duke e nxehur me zjarr për t'i dhënë formën që dëshiron, është i detyruar të mos e djegë pemën duke e mbajtur gjatë nën zjarr dhe të mos e thyejë kur t'i japë formën. Në të vërtetë kjo është aftësia.

Kjo është çështje e një mësimi, meditimi dhe urtësie të thellë. A nuk ushtrohen dhe zbuten duke dalë nga natyra e tyre e egër edhe kafshët më të egra dhe grabitqare prej edukimit me zjarr të një edukuesi të aftë? A mund ta bëjë të njëjtën punë dikush që nuk është i aftë në këtë profesion?

Ndërsa njeriu është plotësisht në këta shembuj, ngaqë ka prestigjin e mendjes dhe perceptimit. Pra, ngaqë është një krijesë që flet, mendon, shikon, ndjen, dallon dhe shquan... Por për fat të keq, e vërteta nuk është kështu. Edhe pse njeriu ka aftësi dhe është i lartë, ka shumë prej tyre që janë më këmbëngulës në inatin e tyre sesa ashpërsia e një materiali të pashpirt.

Siç i sjellin mjeshtrit dhe edukatorët e aftë mineralet e ndryshme dhe krijesat grabitqare në një gjendje të butë e të kërkuar, ka edhe prej njerëzve të dhikrit që i bëjnë zemrat e njerëzve të tjerë të udhëzohen në rrugën e drejtë në sajë të ndikimit shpirtëror që kanë mbi to. Frekuentimi i hallkave të ligjëratave të këtyre njerëzve, ka zbutur zemrat e shumë njerëzve që e kanë arritur këtë fatmirësi. Ata kanë gjetur jetë me dashurinë e Allahut të Madhëruar dhe janë bërë prej njerëzve që e përmendin Zotin (xh.xh.), pa pushim.

Këta miq të Zotit, që i zbusin zemrat, i shohin njerëzit me shikimin e të vërtetës dhe u thonë fjalë të vërteta. Shikimet dhe fjalët e tyre janë eliksiri i jetës. Në fytyrat e tyre ka dritë dhe në gjendjet e tyre ka lumturi.

Në kuvendet e miqve të Allahut Teala nuk ka mendjemadhësi, mburrje, hipokrizi dhe smirë. Për këtë arsye, ata që frekuentojnë në ato kuvende, i gjallërojnë zemrat e tyre aq sa nuk neglizhojnë qoftë edhe një frymëmarrje. Nisur nga kjo, secili prej nesh le ta zgjedhë mirë mikun e tij.

Jeta është e shkurtër. Madje, është aq e shkurtër saqë koha e hapjes dhe mbylljes së syve është më e gjatë. Kush mund të jetë i sigurt për atë që do të ndodhë pas një minute?..

Meqë çdo frymë e jona do të kalojë duke e përmendur Atë dhe, meqë nuk jemi të sigurt se çfarë do të ndodhë qoftë edhe pas një minute, atëherë ne nuk mund të marrim frymë pa Atë. Madje, nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë.

Në këtë jetë të shkurtër jemi nevojtarë dhe të detyruar të shoqërohemi me miqtë e vërtetë të Allahut, në mënyrë që ta shtojmë lumturinë tonë shpirtërore. Ai njeri që duhet të bëjmë mik, duhet të jetë një njeri që e do dhe e ka frikë Allahun e Lartësuar.

Ne jemi të detyruar ta kërkojmë Atë. Prehja, qetësia dhe dëshira jonë ia zgjat dorën një miku të tillë.

Ai që nuk e do "Atë", ai që nuk thotë "Allah" dhe ai që nuk është mik i "Zotit", në kuptimin e plotë të fjalës, nuk mund të jetë mik i vërtetë i askujt. Edhe nëse mbi sipërfaqen e tokës nuk ngel asnjë njeri që e do Atë, Allahu (xh.sh.), i mjafton atij.

Ne duhet ta kërkojmë atë që e do Zotin (xh.xh.). Allahu Teala nuk e ka mik atë që nxit epshet njerëzore, atë që i ka humbur jeta dhe atë që nuk ka asnjë shërbim të bërë për hir të Krijuesit të tij. Prandaj, si mund ta bëjmë ne mik një njeri të tillë? Ne na takon ta gjejmë atë që e do Allahu dhe që e ka bërë mik.

Nisur nga kjo, gjeje dikë prej këtyre të zgjedhurve të cilët janë trashëgimtarët e profetëve dhe evliave! Qëndro me të dhe dorëzoju atij! Shikoje fytyrën e tij të mbushur plot jetë dhe gjallëri! Sa më shumë të shikohet ajo fytyrë, aq më shumë e reflekton bukurinë e saj. Fjalën e tij dëgjoje me gjithë shpirt! Ushqeje zemrën tënde nevojtare dhe të shkretë me fjalët gjallëruese të këtyre miqve të Zotit.

Përderisa zemra të mos zbutet, njeriu nuk mund ta arrijë mirësinë, nuk mund të përparojë drejt përsosmërisë dhe nuk mund ta ndjejë dashurinë hyjnore. Nuk mund të arrijë te dashuria muhamedane. Sytë nuk mund t'i derdhin lot për këto të vërteta madhështore. O mik i nderuar! Mos ndalo!.. Bëje traditë frekuentimin e kuvendeve të miqve të Zotit (xh.sh.), në mënyrë që ta arrish këtë gjendje të lumtur, e cila do të të japë jetë ty. Bëhu njeri i besueshëm për ata!.. Merre nga ata ushqimin që do ta zbusë zemrën tënde dhe do ta bëjë atë vend në të cilin drejtohet shikimi hyjnor.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të gjithëve që ta arrijmë këtë lumturi!

O Zot! Na e mundëso të qëndrojmë me ata që i ke bërë miq! Na ngjall me kuvendet e tyre! Na e mundëso të të mendojmë dhe të të përmendim në çdo frymë që marrim në këtë botë, në të cilën na ke sjellë! Hape kraharorin tonë siç ia ke hapur të Dërguarit Tënd, për të cilin ke thënë: ***"Elem neshrah leke sadrak / Vallë, a nuk ta hapëm ty*** (Muhamed) ***kraharorin*** (për të pranuar besimin)***?"*** Na e lehtëso punën tonë siç ia pate lehtësuar atij! Na e lehtëso rrugën e bindjes, e cila na shpie tek Ti! Mos na ndëshko për shkak të shkujdesjes sonë! Na e mundëso që t'i kalojmë ditët me bindje që na afron te Ti dhe na jep sukses! Salatet dhe selamet qofshin për Muhamedin (a.s.) dhe familjen e tij! Amin!..

ADMINISTRIMI I PASURISË SË JETIMËV

Prof. dr. Hamdi Dëndyren

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik thotë:

"Mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Krye-jeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotë-sojani besën e dhënë Allahut! Këto ju porosit Ai që të mos harroni." (En'am, 152)

Në ajetin e mësipërm përmenden bazat e administrimit të pasurisë së jetimit, i cili është i paaftë për ta administruar vetë pasurinë e tij. Fëmija që humb të dy prindërit apo vetëm babain në moshë të vogël, quhet jetim. Pasuria që i ngel jetimit nga trashëgimia nuk i dorëzohet atij menjëherë kur arrin pubertetin, por pritet derisa të arrijë një aftësi për ta administruar vetë pasurinë, pa e mashtruar dhe duke i dhënë përvojë. Kjo kohë, e cila quhet mosha e pjekurisë ndryshon sipas shkallës së kulturës së vendeve. Praktikimi i kësaj çështjeje fillon ndërmjet moshave 18-21 vjeç.

Ja pra, sipas ajetit, pasuria e jetimit duhet të administrohet në mënyrën më të mirë, derisa të arrijë moshën e pjekurisë. Mënyra më e bukur dhe racionale e administrimit është metoda e administrimit të një tregtari largpamës që e shton atë pasuri dhe e mbron nga dëmtimi.

Nisur nga kjo që thamë më lart, kur kujdestari i jetimit ta administrojë pasurinë e atij jetimi që ka nën kujdestari është i obliguar t'i përmbahet parimit "administrimi ahsen /më i mirë". Kur kujdestari ta shesë apo ta japë me qira këtë pasuri të jetimit, duhet të marrë parasysh edhe çmimet reale të tregut. Në lidhje me këtë çështje janë vënë disa parime dhe baza mbrojtëse. Prandaj, nëse pasuria e jetimit shitet me një çmim të ulët apo jepet me një qira të ulët, marrëveshjet e bëra konsiderohen të pavlefshme. Edhe për vendin që do të blihet apo merret me qira në emër të jetimit, është i vlefshëm i njëjti parim. Nëse është e qartë se pasuria e jetimit nuk mund të administrohet duke korrur fitim dhe se vazhdimisht mund të dëmtohet, atëherë ndalohet administrimi i saj dhe merret nën mbrojtje duke e investuar në gjërat më të dobishme për jetimin siç është floriri apo pasuria e patundshme. Pastaj, kur jetimi të arrijë moshën e pjekurisë, i dorëzohet e gjithë pasuria e tij. (Shik. Ali Hajdar, Duraru'l-Hukkam, I, 588-589; Mexhelle, neni 165.) Pasuria që nuk mund ta administrojnë poseduesit e saj të vërtetë dhe pasuritë publike kanë të njëjtën dispozitë me "pasurinë e jetimit".

Masat e parapara për pasurinë e jetimit janë të vlefshme edhe për vakëfet që administrohen me anë të përfaqësimit dhe për pasuritë publike. Shkurtimisht,

VE, PASURIVE PUBLIKE DHE VAKËFEVE

këto tri lloje që u përmendën, pra, pasuria e jetimit, vakëfi dhe pasuria publike duhet të shiten apo të jepen me qira sipas çmimeve të tregut. Nëse çmimi i shitjes apo i dhënies me qira është më i ulët se çmimi i tregut, atëherë marrëveshja automatikisht është e pavlefshme. Në këtë situatë kërkohet plotësimi i çmimit nga blerësi apo qiramarrësi ose i kërkohet që të boshatisë vendin. Pasuritë e patundshme, si dyqanet, banesat apo të tjera të ngjashme me këto që u përkasin jetimëve, vakëfeve apo publikut, marrëveshjen e qirasë e kanë njëvjeçare, përderisa nuk ka ndonjë gjendje që e imponon ndryshimin e këtij rregulli. Ndërsa pasuritë e patundshme, si tokat mund të jepen me qira me një marrëveshje më së shumti trevjeçare. Këto kufizime janë të nevojshme, në mënyrë që të mbrohen vakëfet dhe pasuritë e ngjashme me to dhe të sigurohen të ardhura në përputhje me qëllimin e tyre. Te Hanefitë ky është mendimi bazë i fetvasë. Por, nëse ka nevojë urgjente për para në mënyrë që të riparohet vakëfi, kohëzgjatja e qirasë mund të zgjatet duke u marrë menjëherë pagesa.

Edhe shitja apo dhënia me qira e pasurive të patundshme të vakëfeve apo institucioneve dhe organizatave shtetërore, si të bashkive, fondeve të pensionistëve, institucioneve të sigurimeve sociale etj., nga aspekti islam kanë të njëjtat dispozita. Por vendet e punës, hotelet, centralet, barazhet, dhe të tjera të ngjashme me këto, që u përkasin këtyre institucioneve apo organizatave shtetërore, vihet re se u janë shitur apo dhënë me qira personave privatë si pasuri e tyre apo me një çmim shumë më të ulët se çmimi i tregut. Veçanërisht, kjo vihet re te pasuritë e patundshme të vakëfeve. Marrëveshje të tilla që bëhen pa marrë parasysh përfitimin e publikut, ngaqë janë pasuri që i përkasin publikut, është e qartë se nga aspekti i jetës së përtejme mbartin një rrezik shumë të madh. Nëse shteti i shet apo i jep me qira pasuritë e patundshme publike për të cilat ka marrë të drejtën e administrimit dhe, nëse e praktikon parimin e dhënies me qira apo shitjes me çmimin e tregut, pa dyshim se problemet sociale si arsimi, shëndetësia, varfëria, papunësia, pensionet etj, do të zgjidheshin shumë më lehtë dhe pa iu bërë barrë shtetit. (Veçanërisht shik. Irsa, 34; Nisa, 36.)

Ata që i kanë këto pasuri të patundshme në dorë apo nën administrim, duhet t'i pranojnë si amanet dhe duhet të jenë të përpiktë në dhënien e hakut atyre që e posedojnë atë të drejtë, sepse në takimin e madh dhe në llogarinë e përpiktë që do të bëhet në Ditën e Gjykimit, peshorja e veprave do t'i peshojë këto. Në këtë mënyrë, të drejtat që nuk u janë dhënë poseduesve të tyre në këtë botë, do t'u jepen atje.

Mrekullitë e Kuranit



SEKRETET E ZEMRËS

Zemra nuk është vetëm një copë mishi. Ky është zbulimi i fundit shkencor që kanë bërë shkencëtarët modernë. Ata pohojnë se janë më shumë se 40.000 mijë qeliza nervore komplekse në zemër, të cilat nuk i njohin. Kanë zbuluar po ashtu se zemra mendon, kupton dhe kujton. Një institut amerikan për ushtrimet e zemrës ka dalë në konkluzionin se ajo luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e ndjenjave, emocioneve, të kuptuarit dhe të mësuarit. Madje zemra ka një fushë elektrike shumë herë më të fortë sesa ajo e trurit. Zemra është përgjegjëse për drejtimin e mendjes dhe funksionimin e saj, madje është përgjegjëse edhe për drejtimin e organeve dhe sistemeve të të gjithë organizmit. Për këtë zbulim të ri ka shenjuar Kurani me një qartësi të plotë kur thotë: **"A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë? Sepse në të vërtetë sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat në kraharor."** (Haxh, 46)



UDHËTARËT QË FSHIHEN

Në këtë foto ilustrohet një vrimë e zezë në qendër të vorbullës, e cila po thith një re të trashë tymi kozmik. Shkencëtarët thonë se këto vrima të zeza nuk mund të shihen kurrë, sepse lëvizin me një shpjetësi të madhe, duke zhdukur dhe inkorporuar çdo gjë që u afrohet. Këto vrima të zeza hapësinore luajnë rolin e një fshese gjigante kozmike. Larg të metave është Allahu xh.sh. i Cili në Kuran ka rrëfyer për këto vrima të zeza katërmbëdhjetë shekuj përpara se shkencëtarët t'i zbulonin: **"Betohem fuqimisht në yjet që tërhiqen** (ditën, e ndriçojnë natën)**. Që udhëtojnë e fshihen."** (Tekvir, 15-16) Po të vërejmë ajetin 16, do të konstatojmë me lehtësi se "udhëtimi" dhe "fshehja" janë pikërisht cilësi të vrimave të zeza, këtyre udhëtarëve që fshihen dhe që janë zbuluar së fundmi. Prandaj natyrshëm lind pyetja: A nuk janë mrekulli kuranore këto ajete dhe a nuk është Kurani një libër i zbritur prej Allahut xh.sh.?

"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë."

(Insan, 8)

Një Ajet

Kujdesi ndaj jetimëve është virtyt i njerëzve të dashur të Allahut. Ata do të kenë shpërblime pafund në Xhenet sepse ata përballë e interesave vetjake preferuan jetimët dhe të varfrit. Ndërsa silleshin në këtë mënyrë nuk synonin asgjë tjetër përveç dashurisë së Allahut.

Për shkak të këtij sinqeriteti Allahu në ditën e Gjykimit do t'i ndriçojë fytyrën, qetësojë zemrat dhe do t'i mbrojë nga tmerri i asaj dite. Kurani e shpreh në këtë mënyrë: **"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: "Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura." Por Allahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim."** (Nisa, 8-11)

Në ditët e sotme privimi nga mjedisi i ngrohtë familjar nuk ndodh vetëm me humbjen e prindërve. Në shoqëritë modern familja po përballet me problem të ndryshme shoqërore në këtë mënyrë megjithëse prindërit jetojnë, fëmijët janë të privuar nga ambient i ngrohtë familjar sepse familja gjithnjë e më shumë po dobësohet dhe ky fenomen më së shumti dëmton fëmijët. Sot me miliona fëmijë po rriten të privuar nga dashuria dhe ngrohtësia familjare dhe për rrjedhojë larg shumë vlerave njerëzore.

Vetmia është një nga anët më dramatike të jetës sepse veçoria kryesore e njeriut është komunikimi dhe marrëdhënie me llojin e vet. Pamundësia për të krijuar komunikim dhe marrëdhënie i dërgon njerëzit në vetmi e cila është shumë e dhimbshme për njeriun. Vetmia rrënon dëshirën dhe entuziazmin për të jetuar, e nxit njeriun të bjerë në pesimizëm dhe humbje vetëbesimi.

Nëse tërheqja në vetmi ndodh në moshë të re atëherë dëmet janë akoma edhe më të rënda dhe të parikuperueshme. Vetmia në këtë moshë mund të lërë plagë të pashërueshme psikologjike sepse kjo është periudha e krijimit të personalitetit të personit.

Fëmijët e braktisur dhe të pambrojtur janë grup potencial për të krime, drogë, vjedhje etj. Prandaj është detyrë e rëndësishme e prindërve për t'i shpëtuar fëmijët nga rreziku i rrugës. Duhet t'i hapim zemrat dhe të kujdesemi për jetimët dhe fëmijët e braktisur. Kujdesi për ushqyerjen, shëndetin dhe edukimin e tyre është prej virtyteve të besimtarit.

Pejgamberi *-salall-llahu alejhi ve selem-*, ka thënë:

"Falënderimi i takon Allahut i cili na jep të hamë e të pimë, na jep veshmbathje dhe na strehon. Sa të atillë ka që nuk kanë as veshmbathje as strehim."

(Muslim, Dhikr, 64)

Një Hadith

Pejgamberi (a.s.) kur shtrihej në krevat falënderimin e asaj dite ndaj Allahut e shprehte me këtë lutje: **"Falënderimi i takon Allahut i cili na jep të hamë e të pimë, na jep veshmbathje dhe na strehon. Sa të atillë ka që nuk kanë as veshmbathje as strehim."** Sepse në syrin e Tij një ditë e kaluar në qetësi, me shëndet të plotë dhe me ushqim të mjaftueshëm ishte e barasvlershme me gjithë mirësitë e kësaj bote. Falënderimi për mirësitë e Allahut është një detyre hyjnore për çdo besimtar. Pejgamberi (a.s.) për të përmbushur këtë detyrë e kalonte natën duke falur namaz. Falënderimi për mirësitë e Allahut e shoqëronte në çdo moment dhe në çdo situatë. Sigurimi i nevojave themelore është një shkak i mjaftueshëm për të falënderuar Allahun. Mirëpo ndodh shpesh që njeriu nuk është i vetëdijshëm për të mirat që ka, madje që mendojnë se të gjithë të mirat që ka janë pasojë e punës dhe meritës së tij. Allahu çdo gjë e ka vendosur në shërbim të njeriut, dielli, hëna, yjet, ajri, ujë, kafshët, bimët dhe shumë mirësi të tjera. Mirësitë e Allahut ndaj njeriut janë të pafundme. Përballë gjithë mirësive të Allahut njeriu ka dy alternative ose alternativën e falënderimit dhe mirënjohjes ose alternativën e mosmirënjohjes dhe arrogancës. Por prej njeriut pritet dhe kërkohet mirënjohja dhe falënderimi për mirësitë e dhëna. Allahu premton shtimin e mirësive kundrejt falënderimit. Ai që falënderon, falënderon për veten e vet. Sepse Allahu nuk ka nevojë për asgjë. Njeriu ka nevojë për falënderim, jo Allahu. Njeriu përmes falënderimit ruan vetëdijsinë ndaj adhurimit.

Shumica e njerëzve e kuptojnë vlerën e mirësive kur i humbin ato. Kur i zotëron kërkon të shumëfishojë por egoja e njeriut nuk ngopet asnjëherë me mirësitë dhe kënaqësitë e kësaj bote. Pejgamberi (a.s.) këtë dobësi të njeriut e shpreh kështu: *"Si kur njeriut t'i jepej një luginë me ar, ai do të kërkonte një të dytë, njeriun e ngop vetëm dheu."*(Buhari, Rikak, 10) Pejgamberi (a.s.) i këshillon besimtarët të shikojnë, të hedhin shikimin jo tek ata që janë sipër tyre por tek ata që janë poshtë tyre sepse kjo është

mënyra më e mirë për të vlerësuar si duhet mirësitë e Allahut.

Nevojat që përmendi Pejgamberi (a.s.) në hadith sa do të vogla dhe të zakonshme të duken për njeriun në të vërtetë çdo njëra prej tyre kërkon falënderim. Sepse megjithëse duken nevoja krejt të thjeshta e vërteta është se përreth nesh gjenden shumë njerëz të privuar nga këto mirësi. Përreth nesh ka njerëz të cilët vuajnë për një kafshatë bukë apo nuk kanë një strehë ku të fusin kokën. Mosmirënjohja përballë gjithë këtyre mirësive është një e keqe e madhe për vetë ne. Rënja preh e mosmirënjohjes përbën një rrezik për gjithë besimtarët. Prandaj duhet të lusim Allahun për çdo mirësi dhe të kërkojmë ndihmë me lutjen " O Zoti im më ndihmo në përmendjen time në falënderimin tim dhe ibadetin tim ndaj Teje." (Ebu Davud, Vitr, 26) në mënyrë që Allahu ta mbajë të gjallë në zemrat tona ndjenjën e falënderimit.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Falënderimi i vazhdueshëm për mirësitë.
2. Mirësitë e Allahut ndaj njeriut janë të panumërta
3. Falënderimi i Allahut qoftë edhe për nevojat më të thjeshta.
4.Të jesh i kënaqur me plotësimin e nevojave themelore.

VETËDIJA NDAJ AMANETIT

Shprehja "mu'min", që është edhe emri i përgjithshëm për të gjithë ata që besojnë Allahun, në të njëjtën kohë është edhe një nga emrat e bukur të Allahut, që shpreh se Ai është burimi i sigurisë, pra u jep siguri robërve të Tij ose i bën ata të besueshëm. Ai është që i pajisi edhe pejgamberët e Vet me cilësinë e "amanetit" dhe i bëri ata njerëz të besueshëm. Nisur nga kjo, një "mu'min", është edhe besimtar, edhe i sigurt, edhe i besueshëm.

Ndjenja e respektimit të amanetit është një element që i jep jetë besimit të mu'minëve. Ky hadith shumë domethënës e shpreh shumë qartë këtë të vërtetë dhe në të njëjtën kohë është edhe një paralajmërim i fuqishëm pejgamberik:

"Padyshim se, kur Allahu (xh.sh.), dëshiron të shkatërrojë një rob, e heq turpin prej tij. Kur ia merr turpin, ai rob bëhet prej të dënuarve. Kur dënohet, ai zhvishet nga besueshmëria. Kur i merret besueshmëria, ai bëhet tradhtar. Kur bëhet tradhtar, nuk mëshirohet më. Kur e humbet mëshirën (e Allahut), atë e zë mallkimi, bëhet i mallkuar. Dhe, kur e zë mallkimi e bëhet i mallkuar, këputet lidhja e tij me Islamin!" (Ibn Maxhe, Fiten, 27)

Ashtu siç shprehet edhe në hadithin fisnik, ndjenja e amanetit është një nga kushtet e përsosmërisë së besimit. Prandaj, për ta ruajtur atë me kujdes, Zoti ynë na e tërheq vëmendjen në mënyrë të shpeshtë:

"...Nëse i besoni njëri-tjetrit *(dhe i lini ndonjë amanet)****, ai të cilit i është besuar*** *(amaneti)* ***le t'ia kthejë atë të zotit dhe t'i frikësohet Allahut në këtë çështje..."*** (Bekare, 283)

"...Kush e tradhton amanetin *(merr padrejtësisht)****, në Ditën e Kiametit do të vijë i ngarkuar me atë që ka tradhtuar*** *(ka marrë padrejtësisht)****..."*** (Al Imran, 161)

"O besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin, e mos i tradhtoni amanetet me vetëdije." (Enfal, 27)

"Allahu ju urdhëron që t'ua ktheni amanetet atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi..." (Nisa, 58)

"Amanet" është një nga pesë cilësitë e pejgamberëve. Pejgamberi (a.s.), kishte fituar aq respekt ndër arabët e kohës së injorancës, saqë ata e thërrisnin me emrat "el-Emin" dhe "es-Sadik". Madje, Ebu Xhehli, që ishte armiku më i egër i Rasulullahut (a.s.), një ditë i thotë:

"O Muhammed! Unë nuk po them se je gënjeshtar. Por nuk e pranoj këtë ftesë që më ke sjellë..." Me këto fjalë, ai e pranonte vërtetësinë e tij, por nuk mund ta pranonte ftesën e Islamit që i bënte Pejgamberi (a.s.).

Kjo gjë shprehet edhe në një ajet fisnik, ku urdhërohet:

"...Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut." (En'am, 33)

Për sa i përket "amanetit" dhe "besnikërisë", askush nuk mund të arrijë nivelin e Pejgamberit tonë (a.s.). Kjo ndodhi që ka transmetuar Abdullah bin Ebi'l-Hamsa (r.a.), është një shembull i bukur i gjendjes së Pejgamberit tonë (a.s.):

"Para se të bëhej Pejgamber, unë kisha bërë një tregti me të Dërguarin e Allahut. Unë hyra në borxh tek ai dhe u largova me premtimin se nëse priste pak, do t'ia sillja menjëherë. Mirëpo, unë e harrova premtimin që i dhashë. Kur u kujtova pas tre ditësh dhe shkova në vendin ku e kishim lënë për t'u takuar, e gjeta atë duke pritur në po të njëjtin vend. I Dërguari i Allahut, pa më qortuar për sjelljen time, më tha vetëm kaq: «O djalosh! Më mundove, kam tre ditë që po të pres këtu». (Ebu Daud, Edeb, 82/4996.)

Pejgamberi ynë (a.s.), njihej nga të gjithë për karakterin e tij që ngjallte ndershmëri, drejtësi dhe siguri. Madje, edhe zonja fisnike dhe e ndershme mekase, nëna jonë Hadixhe (r.anha), për shkak se i admironte këto cilësi të tij, i propozoi për martesë.

Përfshi edhe hebrenjtë që ishin armiqtë e Islamit, kur njerëzit binin në kundërshti mes njëri-tjetrit, shkonin tek ai për shkak se i besonin drejtësisë dhe ndershmërisë së tij. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ua zgjidhte mosmarrëveshjet që kishin midis tyre.

"Para se të bëhej Pejgamber, unë kisha bërë një tregti me të Dërguarin e Allahut. Unë hyra në borxh tek ai dhe u largova me premtimin se nëse priste pak, do t'ia sillja menjëherë. Mirëpo, unë e harrova premtimin që i dhashë. Kur u kujtova pas tre ditësh dhe shkova në vendin ku e kishim lënë për t'u takuar, e gjeta atë duke pritur në po të njëjtin vend. I Dërguari i Allahut, pa më qortuar për sjelljen time, më tha vetëm kaq: «O djalosh! Më mundove, kam tre ditë që po të pres këtu».

Kur mbretit të Bizantit, Herakliut, i arriti letra e ftesës islame, Ebu Sufjani i cili në atë kohë ishte armik i përbetuar i Islamit, gjendej në Sham (Damask). Herakliu i bëri shumë pyetje Ebu Sufjanit në lidhje me Pejgamberin tonë (a.s.). Por në mënyrë të veçantë e pyeti se a ishte akuzuar më parë si gënjeshtar dhe a kishte ndodhur ndonjëherë që të mos e mbante fjalën. Edhe pse në atë kohë ishte armik i Islamit, Ebu Sufjani u detyrua të thoshte të vërtetën se ai kurrë nuk kishte gënjyer dhe se gjithmonë e mbante fjalën e dhënë.

Kjo tregon se edhe ata që nuk e pranonin atë si pejgamber, nuk mund ta mohonin ndershmërinë dhe drejtësinë e tij. Kur Pejgamberi ynë (a.s.), emigroi (në Medinë), tek ai gjendeshin disa amanete që ia kishin lënë idhujtarët. Për këtë arsye, para se të largohej, Pejgamberi ynë (a.s.), i la Aliut (r.a.), detyrën që t'u kthente amanetet të zotëve të tyre. Shkurtimisht, myslimanë dhe jomyslimanë, të gjithë e respektonin atë. Ndjenja e drejtësisë e kishte brumosur zemrën e Rasulullahut (a.s.), në një mënyrë të tillë, saqë kur pa një grua që po thërriste fëmijën e saj duke i thënë: "Eja, shiko se çdo të jap!", e pyeti menjëherë, se çfarë do t'i jepte. Kur gruaja tha se do t'i jepte disa hurma, ai tha:

"Nëse nuk do t'i kishte dhënë gjë, do të quhej si gënjeshtër."

Këto ndjenja të Pejgamberit tonë (a.s.), nuk përfshinin vetëm njerëzit, por edhe kafshët. Njëherë,

kur pa se një prej shokëve të tij po e ndillte kalin e vet duke u shtirur se kishte në dorë ushqim për të, u mërzit aq shumë, saqë e thirri shokun e vet dhe e qortoi. (shih. Buhari, Iman, 24.)

Njëherë tjetër, kur ishin duke u kthyer nga një udhëtim, dy sahabë kishin marrë të vegjlit e një zogu nga foleja dhe po i ledhatonin. Kur zogu nënë nuk i gjeti të vegjlit e saj në fole, filloi të përpëlitej nga hidhërimi. Sapo e dëgjoi këtë ndodhi, Rasulullahu (a.s.), urdhëroi që të vegjlit të vendoseshin menjëherë në folenë e tyre dhe të mos e lëndonin zogun nënë. (shih. Ebu Daud, Xhihad, 112.)

Ndërsa Ibn-i Abbasi (r.a.), tregon:

"Një person, kishte shtrirë një kafshë për ta therur dhe po e mprihte thikën në sy të saj. Kur e pa, Rasulullahu (a.s.), i thotë: «*A mos dëshiron ta vdesësh disa herë? Ta kishe mprehur thikën para se ta shtrije!*» (shih. IV, 257.)

Për shkak se Pejgamberi ynë (a.s.), i shihte krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit, e kishte ndaluar edhe prerjen e një dege peme të njomë. Po ashtu, ai na ka njoftuar se një grua besimtare shkoi në xhehenem për shkak se e kishte lënë të ngordhë prej urisë macen e saj; ndërsa një grua gjynahqare fitoi mëshirën e Allahut, për shkak se i kishte dhënë ujë një qeni që po ngordhte nga etja. Kjo, sepse ai i shihte të gjitha krijesat si një amanet që i ka lënë Allahu i Madhëruar dhe dëshironte që besimtarët të jenë përfaqësuesit e sigurisë dhe paqes në tokë.

Nga kjo pikëpamje, çdo besimtar me vetëdijen se është umeti i një pejgamberi që gëzon virtytet "el-emin" dhe "es-sadik", duhet të jetë besnik në fjalë e në vepër dhe njerëzit, madje të gjitha krijesat, duhet të jenë të sigurt prej dorës dhe gjuhës së tij. Ai duhet të shfaqë përreth vetes një karakter të fortë islam, sepse njerëzit i admirojnë personat me karakter të fortë, të matur e shembullor dhe i ndjekin gjurmët e tyre.

Pejgamberi ynë (a.s.), i cili dëshironte që ndjenja e amanetit të bëhej identiteti i personalitetit të besimtarëve, në një hadith fisnik, thotë:

"Ktheja amanetin atij që ta ka besuar. Mos e tradhto (as) atë që të ka tradhtuar!" (Ebu Daud, Buju, 79/3534.)

Gjithashtu, Pejgamberi ynë (a.s.), tradhtinë ndaj amanetit e ka konsideruar si shkak shkatërrimi, i cili e kthen jetën e kësaj bote në një skenë kiameti. Një ditë, kur ishte duke biseduar me shokët e tij, dikush e pyeti:

"Kur do të bëhet Kiameti?"

"Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin!", u përgjigj ai.

"Si do të humbë amaneti?", pyeti ai përsëri.

"Kur punët t'u besohen njerëzve të paaftë, prite Kiametin!" (Buhari, Ilm, 2.)

Të gjitha mirësitë që i janë falur njeriut, janë nga një amanet më vete. Pejgamberi ynë (a.s.), në Hutben e Lamtumirës, ka thënë:

"...Po ju lë një amanet të tillë, që po të kapeni fort pas tij, nuk keni për ta humbur rrugën. Ky amanet është Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit të Tij..." (Hakim, I, 171/318.)

Nisur nga kjo, Kurani Fisnik dhe Suneti i Pejgamberit tonë (a.s.), janë amanetet më të mëdha që na ka lënë Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Po ashtu, Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë se besimtarët kanë përgjegjësi ndaj njeri-tjetrit; ata duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin si tullat e një muri; ashtu si organet e trupit, edhe ata duhet të ndjejnë të njëjtën dhimbje që ndjen njëri prej tyre; dhe se të flesh i ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur, nuk përputhet aspak me moralin islam. Shkurtimisht, ai ka theksuar se besimtarët janë amanet i njëri-tjetrit.

Fakti që të parët tanë të nderuar osman, shfrytë-

zuan të gjitha mundësitë e asaj kohe për t'u shkuar në ndihmë besimtarëve në anën tjetër të botës, në Açe, nuk mund të shpjegohet ndryshe përveçse me ndjenjën e amanetit, e cila është pjesë e moralit islam. Po ashtu, edhe themelimi nga ana e tyre, i 26 mijë e më tepër vakëfeve për t'u shërbyer sa më shumë njerëzve, kafshëve, madje edhe bimëve, ishte si rezultat i konsiderimit të të gjitha krijesave si amanete hyjnore.

Të gjithë vëllezërit tanë në vendet myslimane, si Ballkan, Lindje të Mesme, Kaukaz dhe kudo që ka myslimanë, janë amanete të Zotit dhe të të parëve tanë Osman, si Sulltan Muradi, i cili ra dëshmor në Kosovë, si Sulltan Mehmet Fatihu, i cili çliroi Bosnjën, etj... Në luftën e Çanakalesë (Dardaneleve), gjyshërit tanë të këtyre vendeve erdhën dhe luftuan sup më sup me gjyshërit tanë në Çanakale dhe dhanë jetën për të njëjtin qëllim.



Nga ana tjetër, edhe atdheu ynë me shumë bukuri e mirësi, është një amanet shumë i rëndësishëm për ne. Jetësimi i fesë, ruajtja e nderit, dinjitetit e pronës dhe valëvitja e dëlirë e flamurit kombëtar është e mundur vetëm me mbrojtjen e atdheut. Midis shumë urtësive të emigrimit të Pejgamberit tonë (a.s.), në Medine, është edhe sigurimi i një atdheu për të jetuar fenë të lirë.

Osmanët, të cilët njëherë e një kohë ishin vetëm një fis që përbëhej vetëm nga katërqind çadra, në sajë të respektit legjendar që treguan ndaj Kuranit Fisnik, u bën një shtet që u përhap në tre kontinente. Përveç kësaj, në kohën e Sulltan Javuz Selimit, "amanetet e shenjta[1]" u sollën në Stamboll, në Pallatin Topkapë, ku u vendosën nëpër dhoma të veçanta ku vazhdimisht lexohet Kurani Fisnik. Kjo traditë, është filluar prej vetë Sulltan Javuz Selimit, i cili qe i pari që lexoi Kuran në atë vend, ku do të vazhdojë të lexohet për shekuj të tërë. Të gjitha këto, tregojnë respektin e jashtëzakonshëm që kanë treguar të parët tanë. Ky është edhe një nga shkaqet që Osmanët arritën të gëzonin një mirësi të madhe hyjnore, duke sunduar me lavdi e madhështi për gjashtëqind e kusur vite.

Nuk duhet harruar se e fshehta që qëndron në themel të madhështisë në fushën materiale dhe të dukshme të kombeve, është respektimi i urtësive të botës shpirtërore. Madhështia gjashtëqindvjeçare e Osmanëve, të cilën nuk e ka gëzuar asnjë shtet tjetër islam, ka buruar nga rëndësia e jashtëzakonshme që i kanë dhënë ata botës shpirtërore.

Nisur nga kjo, detyra jonë, është të edukojmë dhe rritim një brez me besim, të lidhur me vlerat shpirtërore dhe atdhetare, sepse mbrojtja e besimit, nderit, dinjitetit, jetës dhe pronës është e mundur vetëm me mbrojtjen e atdheut. Ashtu siç na i kanë lënë trashëgim këto toka të parët tanë që kanë jetuar në to dhe i kanë mbrojtur me jetët dhe gjakun e tyre, ashtu edhe ne jemi të detyruar që këto toka t'ua përçojmë brezave të mëvonshëm, të lira, me thirrjen e Kuranit, ezanëve dhe flamurin që valëvitet i dëlirë. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë** (e kësaj bote)**!" (Tekathur, 8)

Mirësia më e madhe është feja jonë; është jetësimi i besimit tonë në një atdhe të lirë. Nëse nuk bëhet kujdes në vetëdijen e këtij amaneti, shembulli i gjendjes sonë do të jetë si gjendja e mjeruar dhe e hidhur e Palestinës dhe Mesxhdi Aksas, të cilat sot ndodhen në dhunën dhe pushtimin e armiqve. Sa bukur ia përkujtojnë këtë të vërtetë brezave dhe shekujve, këto vargje të të ndjerit M. Akif Ersoj:

Atdheu pa zot, kapitullimin meriton,

Por nëse ti i del zot, ky atdhe s'kapitullon!..

Nga ana tjetër, popujt mund ta ruajnë vitalitetin e tyre në skenën e historisë në sajë të "kulturës" që

1. **Amanetet e Shenjta:** Sende të Pejgamberit tonë (a.s.), të disa shokëve të tij, familjes dhe të disa pejgamberëve të shkuar.

u përshtatet strukturës së tyre. Në bazë të kësaj, edhe kultura është një amanet i rëndësishëm. Dhe, trekëmbëshi mbi të cilën qëndron ky amanet, është **feja**, **gjuha** dhe **historia**.

Feja është rregullatore e jetës midis djepit dhe varrit, pra përmbledhja e ligjeve hyjnore që e përgatit robin për lumturinë e botës tjetër. Gjuha është mjeti i shprehjes së të vërtetave që nxjerr në pah feja. Ndërsa historia është një pishtar që ndriçon rrugët e të ardhmes së popujve, duke analizuar shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve brenda kuadrit të fesë dhe gjuhës. Për rrjedhojë, këto tri elemente nuk mund të mendohen kurrë të ndara nga njëra-tjetra.

T'i dalësh zot amanetit të trashëgimisë së fesë, gjuhës dhe historisë që na kanë lënë të parët tanë, pra amanetit kulturor, nuk do të thotë të merremi vetëm me restaurimin e veprave materiale që janë kthyer në gërmadha. E rëndësishme është rigjallërimi i shpirtit, entuziazmit dhe civilizimit të tyre, duke i përçuar këto edhe në brezat pasardhës.

Historia është dëshmitare se popujt dhe individët e organizojnë jetën e tyre në bazë të eksperiencave që kanë kaluar. Historia është kujtesa e popujve. Për këtë shkak, popujt gjithmonë kanë nevojë për të marrë mësim dhe udhëzim prej ndodhive historike. Nëse një popull e njeh historinë e tij të vërtetë dhe udhëzuesit e saj materialë e shpirtërorë dhe i respekton ashtu siç duhet, do të thotë se ai është një popull i përparuar dhe i madh. Nëse brezat e rinj e dinë historinë e tyre më mirë se të huajt dhe marrin mësimet e duhura prej të shkuarës, nuk kemi pse të shqetësohemi për të ardhmen. Kurse ata që nuk mbështeten në të shkuarën e tyre, kurrë nuk mund të jenë të sigurt për të ardhmen e tyre. Prandaj, rrënjët tona duhet të shtrihen në të shkuarën, ndërsa degët në të ardhmen.

Gjithashtu, të pandehësh se shkenca e historisë është vetëm një mullar me ngjarje të pakuptimta, është një gabim shumë i madh. Shkenca e vërtetë e historisë është një shkencë plot me urtësi, e cila tregon bazat reale të së vërtetës dhe të së kotës, të së drejtës e të gabuarës në të shkuarën plot me ngjarje të popujve të botës. Për ta rregulluar në mënyrë të përsosur të ardhmen e popujve, është kusht që këto baza të njihen mirë dhe të nxirren mësimet e duhura prej tyre. Sa bukur shprehet i ndjeri M. Akif Ersoj:

"Përsëritje historike, thanë; Por a do të përsëritej nëse mësim do të ishte marrë!.."

E shkuara jonë na porosit se luani nuk mund të futet në kafaz. Ashtu siç nuk e nxë kafazi luanin, ashtu edhe populli nuk robërohet nëse i ruan cilësitë e veta. Të parët tanë ishin një shoqëri e ngritur mbi themelet e besimit. Ata i mbrojtën me jetë vlerat e tyre materiale e shpirtërore dhe kurrë nuk u poshtëruan.

Kur ne të bashkohemi me vlerat shpirtërore të të parëve tanë, atëherë do të mund t'i bartim me dinjitet amanetet e shenjta që ata na kanë lënë. Përndryshe, të rrimë e të shohim të heshtur shkatërrimin materialo-shpirtëror të vlerave tona, është një indiferencë e tmerrshme e cila do të përfundojë me humbjen e amanetit. Për mbrojtjen e amaneteve për të cilat janë sakrifikuar shumë jetë, duhet të përpiqemi sot me sa të kemi mundësi, me qëllim që nesër të mos jemi të detyruar të paguajmë përsëri çmime të shtrenjta. Është e vërtetë historike se amanetet që nuk janë ruajtur, kanë humbur dhe nuk janë rikthyer më derisa janë merituar përsëri.

Zoti ynë na ndihmoftë ne dhe brezat e mëvonshëm në ruajtjen e amaneteve tona të shenjta! Po ashtu, na ruajtë edhe nga rënia në batakun e pavetëdijes në lidhje me këtë çështje dhe na bëftë të gjithëve prej atyre që e kryejnë siç duhet detyrën e tyre në ruajtjen e amaneteve që kanë mbi supe, duke shkuar tek Zoti ynë me zemër të pastër!

Amin!

T'i dalësh zot amanetit të trashëgimisë së fesë, gjuhës dhe historisë që na kanë lënë të parët tanë, pra amanetit kulturor, nuk do të thotë të merremi vetëm me restaurimin e veprave materiale që janë kthyer në gërmadha. E rëndësishme është rigjallërimi i shpirtit, entuziazmit dhe civilizimit të tyre, duke i përçuar këto edhe në brezat pasardhës.

PARAMENDO SIKUR JETA JOTE TË JETË NJË DITË

A. Jasin Demirxhi

Pasi të zgjohesh në mëngjes, tashmë mos shiko natën që ka kaluar, sepse, me të mirën dhe të keqen e saj, nuk do jetosh ditën e djeshme, por të sotmen. Paramendo sikur jeta jote të ishte vetëm një ditë dhe ajo ditë të jetë dita e sotme... Sot ke lindur dhe sot do të takohesh me Zotin (xh.xh.). Prandaj mos lejo të të rrëshqasë këmba për shkak të fatkeqësive në të kaluarën dhe shqetësimit për të ardhmen. Të gjithë kujdesin, përkushtimin dhe përpjekjen fokusoje për ditën e sotme. Namazet e kësaj dite të fundit të jetës tënde fali me një frikërespekt absolut ndaj Allahut Teala. Lexoje Kuranin Fisnik duke e medituar. Bëje dhikrin sikur të jesh duke e bërë në audiencën e Zotit (xh.sh.). Ki kujdes ndaj moralit dhe veprave të tua. Kaloje ditën tënde me një vendosmëri dhe përpjekje të madhe duke bërë punë që janë të dobishme për të tjerët.

Përdori mirë këto orë të ditës tënde të fundit. Shndërroji minutat në vite dhe sekondat në muaj. Përkujtoje shumë Allahun e Lartësuar. Sot mbill vetëm mirësi në tokën tënde. Pendohu për mëkatet e tua. Qëndro larg urrejtjes dhe smirës. Ji i kënaqur me riskun tënd. Gëzoji bashkëshorten dhe fëmijët e tu.

Ji vetvetja – Mos ji "Immea"

Asnjëherë mos u përpiq për të qenë dikush tjetër, sepse kjo, me të vërtetë nxjerr probleme të pafundme. Që nga Ademi, (a.s.), e deri më sot, asnjë njeri nuk është krijuar i njëjtë me dikë tjetër. Ti je i veçantë. Asnjë nuk është krijuar i njëjtë me ty në të kaluarën. Edhe këtej e tutje nuk do të krijohet. Ti je i ndryshëm nga Ahmeti apo Mehmeti. Për këtë arsye, mos u përpiq ta ringjallësh veten te të tjerët. Hidhu në jetë duke qenë "vetvetja".

Jeto siç je krijuar. Mos e ndrysho zërin apo ecjen. Ti ke një shije dhe ngjyrë të veçantë. Ty të kemi njohur me këtë shije dhe me këtë ngjyrë. Prandaj, kështu duam të të shohim, sepse ti kështu je krijuar.

Një ditë Ibn Mes'udi (r.a.), u tha shokëve të tij:

"Kini kujdes! Asnjëri prej jush të mos jetë immea!" Ata e pyetën:

"O Eba Abdirrahman! Çfarë është immea?" Ibn Mes'udi u përgjigj:

"Immea është ai njeri që thonë: "Unë jam i lidhur me popullin. Nëse ata janë në rrugë të drejtë, edhe unë jam në rrugë të drejtë. Nëse ata janë në humbje, edhe unë jam në humbje." Betohem në Allahun se, edhe nëse i gjithë populli është qafir, ju jeni të detyruar të përpiqeni për të mos qenë të tillë."

Njeriu, për nga natyra e tij, është si një pemë me fruta. Dikush është i gjatë dhe dikush tjetër është i shkurtër. Dikush është i ëmbël dhe dikush tjetër është i athtë. Ngjyrat, gjuhët, fuqitë dhe të gjitha cilësitë tona janë të ndryshme. Ky është një ajet nga ajetet e Allahut Teala.

LA TAHZEN / MOS U MËRZIT

Sepse mërzitja e gëzon armikun, e brengos mikun dhe të lëshon në gjuhën e ziliqarit.

Sepse mërzitja i rraskapit nervat, e lodh zemrën dhe e shkatërron natën.

Nëse ke bërë ndonjë mëkat, pendohu dhe kërkoji falje Allahut. Nëse ke bërë ndonjë gabim, rregulloje. Mëshira e Allahut është e pafundme. Dera e Tij është gjithmonë e hapur.

Mos u mërzit për atë që ke humbur, sepse ke edhe shumë mirësi të tjera. Mendo mirësitë e tjera që të ka falur Allahu Teala dhe falënderoje për to. A nuk thotë Allahu: ***"Ai ju jep gjithçka që i kërkoni. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot..."*** (Ibrahim, 34)

Mos u mërzit nga fjalët e njerëzve të devijuar. Mos harro se do të shpërblehesh përderisa të durosh kundrejt kritikave të tyre.

Mos u mërzit përderisa iu bën mirë njerëzve, sepse mënyra për të qenë i lumtur është te të ndihmuarit e njerëzve.

Sepse shpërblimi i mirësisë është nga dhjetë fish deri në shtatëqind fish, ndërsa ndëshkimi i të keqes është aq sa e keqja.

Nëna e Osmanit (r.a.)

Erva binti Kurejdh (r.a.)

Mustafa Erish

Erva binti Kurejdh, (r.a.), është vajza e hallës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.)... Është nëna e Osmanit (r.a.)... Është prej zonjave të para sahabe, që shpëtuan nga errësira e xhahilijetit dhe vrapuan drejt dritës së Islamit...

Ajo lindi në Mekë. Babai i saj është Kurejdh ibn Rebia. Nëna e saj është halla e të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ummu Hakim Bejza binti Abdulmuttalibi.

Zonja Erva është prej grave të para sahabe, që pranuan dritën e Islamit sapo dëgjuan se ka ardhur feja e re dhe pejgamberi i fundit. Emri i saj përmendet ndërmjet myslimanëve të parë që u nderuan me Islamin duke pranuar ftesën e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Në kohën e xhahiljetit Erva binti Kurejdh (r.anha), pati qenë martuar me Affan ibn Ebi'l-Asin. Nga kjo martesë u lindi një djalë me emrin Osman dhe një vajzë me emrin Amine.

Pasi Affani ndërroi jetë, ajo u martua me Ukbe ibn Ebi Muajtin. Edhe nga kjo martesë solli në jetë gjashtë fëmijë: Velidin, Umaren, Halidin, Ummu Gulthumin, Ummu Hakimin dhe Hindin.

Erva binti Kurejdh (r.a.), kishte një karakter që nuk toleronte kurrë në besimin e saj. Ajo pothuajse përpëlitej për të mos rënë edhe një herë në shirk (politeizëm). I doli për zot familjes dhe fëmijëve të saj si nënë. U përpoq shumë për t'i edukuar ata të shëndoshë fizikisht dhe mendërisht. Ajo ua mësoi atyre mirësitë e fesë, u vendosi në zemër dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i largoi nga idhujt dhe i mbrojti që të mos i adhuronin ata. Pothuajse të gjithë fëmijët e saj e pranuan Islamin, duke i dhënë besën të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ata thanë shehadetin dhe u nderuan me Islamin.

Në vitet e para të Islamit Erva (r.a.), duroi ndaj torturave dhe vuajtjeve bashkë me motrat dhe vëllezërit e tjerë myslimanë. Ajo u përpoq shumë për ta mbrojtur besimin e saj pa u ndikuar nga torturat dhe shtypjet e politeistëve. Kur myslimanëve u doli leja për të bërë hixhret, edhe ajo u bashkua me ta.

Erva (r.a.), ishte një zonjë që e mbante fjalën. Asnjëherë nuk e harroi besën dhe fjalën që ia pati dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Jetën e saj e kaloi duke e vërtetuar në çdo vend dhe në çdo kohë profetësinë e Pejgamberit dhe duke e ndihmuar atë për këtë çështje. Për hir të besimit flijoi jetën dhe pasurinë e saj. Bëri hixhret. Për këtë arsye, u detyrua të largohej nga qyteti në të cilin pati lindur dhe qe rritur. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u largua nga Meka, edhe ajo shkoi në Medine bashkë me vajzën e saj, Ummu Gulthumin. Pjesën tjetër të jetës e kaloi në këtë qytet të bukur.

Erva binti Kurejdh (r.a.), shfaqi një përpjekje madhështore si një nënë për t'i edukuar fëmijët e saj. Ajo i dha shumë rëndësi edukimit dhe besimit të tyre. Gjithmonë i deshi ata si një nënë. Edukimi i një fëmije si halifi i tretë i myslimanëve, Osmanin (r.a.), i cili ishte shembull në edukatë dhe turp, është argument për këtë përpjekje të saj.

Zonja Erva u bë vjehrra e dy vajzave të dashura të të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ummu Gulthumit dhe Rukijes. Ato i deshi dhe i mbrojti si jetën e saj. U përpoq që ato të ishin sa më të lumtura dhe të gëzuara.

Ajo është një nënë me fat, që jetoi gjatë dhe arriti deri në kohën e udhëheqjes së birit të saj, Osmanit (r.a.). Në moshën nëntëdhjetë e sa vjeçare dhe në periudhën e kalifatit të Osmanit (r.a.), ndërroi jetë në Medine. Ajo u varros në Xhennetu'l-Baki.

Pasi Erva binti Kurejdh (r.a.), u vendos në varr, Osmani (r.a.), shfaqi një respekt dhe dashuri të madhe kundrejt nënës së tij. Për një kohë të gjatë nuk u largua nga varri i saj. Një kujtim në lidhje me këtë e transmeton sahabi i nderuar, Abdullah ibn Hanzala (r.a.):

"Pasi Osmani (r.a.), e varrosi nënën e tij, qëndroi në krye të varrit dhe u lut për një kohë të gjatë në këmbë. Pasi u kthye nga varri, shkoi te Mesxhidi Nebevi. Hyri brenda dhe fali namaz. Kur arriti në sexhde, me lot në sy u lut për një kohë të gjatë, duke thënë:

"O Zot! Mëshiroje nënën time!.. O Zot! Fale nënën time!.."

Allahu qoftë i kënaqur prej saj dhe e bëftë prej banorëve të xhenetit! Amin!



"Es-selamu alejke ja Ibrahim, jam Xhibrili..."

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Po lexoja mbi kuptimet e dashurisë dhe lidhjen që e mban besimtarin në një gjendje të vazhdueshme malli dhe kërkimi në hak të Krijuesit të tij. Në fakt, përkufizimet e saj janë të shumta. Mua më tërhoqën vëmendjen tri prej tyre, të regjistruara në një prej kryeveprave të dijetarit të madh Imam Ibn Kajjim El-Xheuzijje, "Reudatul-muhibbine", ndryshe: "Kopështi i të dashuruarve", ku dashuria përkufizohet si më poshtë:

1. "Tërheqja jote drejt të dashurit me krejt qënien tënde dhe vetëmohimi yt ndaj tij në shpirt dhe pasuri, miratimi yt ndaj tij haptas dhe fshehurazi, si dhe bindja jote se je i mangët në dashurinë tënde ndaj tij".

2. "Shpenzimi i mundit tënd për të arritur atë që pëlqen i dashuri".

3. "Qetësi pa lëkundje dhe lëkundje pa qetësi! Kur zemra lëkundet dhe nuk gjen qetësi vetëm se tek i dashuri dhe kur zemra dridhet nga malli i tij dhe nuk qetësohet vetëm se në pragun e tij"[1]

Historia e besimit dhe njerëzve të tij, është e mbushur me shembuj sesi udhëzimi i njeriut drejt dashurisë për Zotin, ka dështuar shembujt më të shkëlqyer të asaj që mund ta quajmë mrekulli në marrëdhëniet e njeriut me ambientin, natyrën e gjërave, si rezultat i sinqeritetit dhe rrugëtimit të vendosur drejt pëlqimit të Zotit në jetë.

Shembujt, që dua të trajtoj nw kwtw material, vijnë kryesisht nga historia e të dërguarve të All-llahut, si pika referimi dhe shembuj të mrekullueshëm, që na shërbejnë secilit në jetën e sotme dhe marrëdhëniet tona me besimin përballë realiteteve të jetuara.

Transmetohet se Musai (a.s.) iu lut All-llahut (xh.sh) duke thënë: "O Zot, kush janë të dashurit e Tu, të cilët do t'i strehosh nën hijen e Arshit Tënd? Tha: Janë ata që duart i kanë të pastra, zemrat të dlirta, ata që duhen për Madhninë Time, të cilët kur përmendem, përmenden nëpërmjet Meje! Ata, që kur përmenden, përmendem me përmendjen e tyre..."[2]

Nga këtu, më lejoni të pyes: A nuk është koha të reflektojmë rreth saktësisë së marrëdhënies tonë me Zotin dhe ngritjes drejt përmirësimit të kësaj lidhje, që në një farë mënyre është direku i jetës së secilit dhe barometri real i cilësisë së vetë fesë?

Fjala bie, a nuk është padrejtësia e të korruptuarit argument i largimit të tij nga udha e Zotit, përmendja dhe dashnia e Tij? A nuk është humbja e kohës së të riut të sotëm, tregues i një mungese ekuilibri në lidhjen e tij të sinqertë me Zotin e Madhëruar, që betohet për kohën? A nuk është vetëkënaqësia e cilitdo, shenjë e luhatjes së tij në marrëdhënie me Zotin, që urdhëron për modesti në jetë?

Dhe shembujt në këtë arsyetim janë të shumtë, për të ardhur te një dëshmi historike, që sjell rastin e Um Derdasë (r.a.), sahabijes, që përkthen më së miri në realitet modelin e dashnisë së Zotit në jetën e besimtarit.

Aun ibn Abdull-llah tregon: Uleshim tek Um Derdaja dhe i bënim dhikër All-llahut të Madhëruar. Një ditë i thamë: Mos po të mërzisim? Ajo tha: "Pretendoni se po më mërzitni, ndërkohë që adhurimi është kërkuar nga ne në çdo gjë? Dhe unë nuk gjej ndonjë gjë që ma shëron zemrën dhe më bën të arrij kulmin e fesë më shumë sesa mexhliset e dhikrit!"[3]

E nga këtu, them: A nuk është koha, që secili të angazhohet dhe të kërkojë për shërimin e nefsit të tij, duke kërkuar edukatorin shërues, udhëzuesin drejt dashnisë së munguar dhe përmendjes së vazhdueshme të Zotit në jetën e tij?

Transmetohet se një ditë, havarijunët (shokët e afërt dhe nxënësit e përkushtuar) e pyetën Isai (a.s.): Kush janë eulijatë e All-llahut, për të cilët nuk ka as frikë as dëshpërim? Ai tha: "Ata, që vështruan në brendësinë e tokës, kur njerëzit vështruan në sipërfaqen e saj!

1. Ibn Kajiim El-Xheuzijje, "Reudatul-muhibbine", botimi i parë, Damask, 1997, f. 49.

2. Ibn Kudame El-Makdisi, "Er-rikkatu vel-bukau", botimi i tretë, Damask, 2014, f. 46.

3. Nedhir Mektebi, "Safahatun nejjiratun min hajatis-sabikat", botimi i dytë, Bejrut, 1996, f. 29.

Ata, që vështruan me largpamësi tokën, kur njerëzit vrapuan pas momentit!..."[4]

A nuk është ky shembull dhe ky përkufizim, një ftesë, që të na shërbejë dashuria e All-llahut në jetë, si busull drejt suksesit, për arritjen e të cilit duhet mund, sakrificë, durim, tërheqje dhe vërshim, në momentin dhe kohën e duhur? A nuk është kjo urtësi e Isait (a.s.), ftesë për secilin prej nesh, për të ndryshuar mënyrën e të menduarit, atë të vepruarit, të sjellurit me jetën dhe momentin? A nuk është ky përkufizim një thirrje e qartë dhe e prerë, se muslimani duhet të jetë njeriu i kohës së tij, jo i humbur në mes të humburish, as individ-masë, që tërhiqet drejt planeve dhe projekteve, që luhen në kurriz të dinjitetit të tij njerëzor e fetar?

Një bashkëkohës i Aliut (r.a.), i quajtur Ebu Erakeh, tregon: "Fala një ditë sabahun (në Kufe) me Aliun, të birin e Ebu Talibit. Kur dha selam, fryu nga e djathta e tij, pastaj qëndroi, si të kishte një dëshpërim. E, kur dielli u lartësua sa një shtizë, mbi mur, ai e ktheu dorën përmbys dhe tha: "Pasha All-llahun, i kam parë sahabët e Muhammedit (a.s.), por sot nuk gjej më si sojin e tyre! Ata zgjoheshin të zbathur, të zverdhur e të pluhurosur, në mes balli kishin gjurmë, që dëshmonin se e kishin kaluar natën në sexhde dhe në këmbë, duke lexuar Librin e All-llahut të Madhëruar... E, në mëngjes i bënin dhikër All-llahut të Madhëruar, duke u anuar si pemët në një ditë me erë, lotët u rridhnin, sa lageshin rrobat e tyre. Pasha All-llahun, njerëzit sot më duken gafilë!". Pastaj u ngrit dhe u largua. Dhe, nga ajo ditë nuk u pa më të qeshte, derisa Ibn Mulxhimi, armiku i All-llahut, e goditi pas shpine (për vdekje)"[5]

Edhe ky është model dashurie dhe shembull udhëzimi për secilin që dëshiron të ketë një model të pastër dhe një udhëzim në jetë. Muslimani nuk duhet t'i lejojë vetes humbjen e kohës pas kësaj bote të përkohëshme, të cilën duhet të lodhet e të sakrifikojë me të tërë forcat e tij që ta posedojë në duart e tij, asesi në zemrën e tij. Atë, duhet ta ruajë të paprekur vetëm për All-llahun, prej të Cilit vjen mbarësia dhe suksesi.

Pyete veten: Sa orë në ditë bën dhikër, që të gjesh sekretet e mbarësisë a të dështimit tënd në jetë? Kushdo që përpiqet në jetë, arrin në një rezultat, ky është ligj natyre, që Zoti ka vendosë në këtë jetë. Por, ai që mbështetet në All-llahun dhe e ndërton jetën e tij me lutjet dhe kërkimin e suksesit nga Krijuesi, duke ndjekur rrugën e shkaqeve, natyrshëm që e arrin rezultatin, rrethuar me begati e prehje në shpirt!

Dua ta përfundoj me shembullin e Ibrahimit (a.s.), për të cilin transmetohet se kur e hodhën në zjarr, të gjitha krijesat iu lutën All-llahut të Madhëruar, duke i thënë: O Zot, mikun Tënd po e hedhin në zjarr, na lejo ta fikim atë! Zoti tha: "Ai është miku Im, nuk kam mik tjetër në tokë pos tij dhe Unë jam Zoti i tij, ai nuk ka zot tjetër pos Meje! Nëse ju kërkon ndihmë, ndihmojeni, përndryshe lëreni!" Pastaj, meleku i shiut tha: O Zot, mikun Tënd po e hedhin në zjarr, më lejo ta fik atë zjarr me anë të shiut! Zoti tha: "Ai është miku Im, nuk kam mik tjetër në tokë pos tij dhe Unë jam Zoti i tij, ai nuk ka zot tjetër pos Meje! Nëse të kërkon ndihmë, ndihmoje, përndryshe lëre!"

Kur e hodhën në zjarr, Ibrahimi (a.s.) iu lut All-llahut me këto fjalë: "All-llahumme inneke Vahidun fis-semai ve ene fil-erdi vahidun a'buduke" (që do të thotë: "O Zoti im, Ti je i Vetëm në qiell, ndërsa unë jam i vetmi në tokë që Ty të adhuroj")![6]

Atëherë All-llahu urdhëroi: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim (i paqtë) për Ibrahimin!"[7]

Në jetën tonë të përditshme, ne ballafaqohemi shpesh me vështirësi dhe pengesa, me pusi e pabesi, që në një mënyrë a një tjetër, ngjajnë me katapultat e sprovës. E, pikërisht në kulmin e tyre, duhet të na prijë dashuria për All-llahun dhe besimi plot bindje në faktin se Zoti nuk e lë kurrë jashtë mbrojtjes dhe përkrahjes së Tij, robin e Tij të dashur.

Në këto momente të vështira, duhet të na kujtohet Ibrahimi (a.s.), i cili teksa hidhej në zjarr me katapultë, iu shfaq Xhibrili (a.s.), që i tha: "Es-selamu alejke ja Ibrahim, jam Xhibrili. A ke gjë nevojë?" Ibrahimi (a.s.) ia ktheu: "Nuk kam nevojë për ty, kam nevojë për Zotin tim!"[8]

Dhe All-llahu nuk e la në baltë mikun dhe të dashurin e Tij, Ibrahimin (a.s.).

All-llahu nuk do të na lërë në baltën e sprovave të kësaj bote, sado që ne do ta kalojmë pragun e dëshpërimit të Aliut (r.a.)...

4. Ibn Kudame El-Makdisi, vep. e cit., f. 47.
5. Ibn Kudame El-Makdisi, vep. e cit., f. 51.
6. Ibn Kudame El-Makdisi, vep. e cit., f. 63.
7. Kur'ani, El-Enbija: 69.
8. Ibn Kudame El-Makdisi, vep. e cit., f. 64.

Psikologjia e mëkatit dhe pendimit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Psikologjia e mëkatit dhe fajit formon te njeriu reagime reflekse. Fajësia në ndërgjegje sjell ngushtim të zemrës. Ndjenja e keqardhjes vë në lëvizje te njeriu psikologjinë e pendimit dhe gjendjen shpirtërore për t'u pastruar nga mëkati. Me pendimin që bëhet në mënyrë të përshtatshme me kushtet e tij, e ndalon veten nga njollosja me mëkat, nuk e lejon të nxihet dhe së fundi e mbron zemrën nga ngurtësimi.

Të mëkatosh dhe pastaj të pendohesh, është një veti e njeriut. Ëngjëlli nuk ka nevojë të pendohet, për shkak se nuk bën mëkat. Kafsha është larg vetëdijes së mëkatit dhe pendimit, për shkak se është e privuar nga mendja. Ndërsa shejtani për shkak se nuk u pendua për mëkatin që bëri, edhe ai është i privuar nga nderimi për t'u penduar.

Allahu e ka krijuar njeriun me një status të ndryshëm nga ëngjëlli dhe djalli. Kështu që ai është i aftë të bëjë mirë dhe keq, sevap dhe mëkat, mirësi dhe ligësi. I Dërguari i Allahut s.a.v. e shpjegon kështu këtë të vërtetë: "Sikur ju të mos bënit asnjë mëkat, Allahu në vendin tuaj do të krijonte një popull mëkatar e pendues dhe pastaj do t'i falte ata."[1] Sikur aftësia e mëkatimit është një pjesë e personalitetit të njeriut. Faktikisht njeriu erdhi në këtë botë për shkak se mëkatoi. Cilësia e njerëzisë vazhdon me këtë.

Njeriut të cilin e krijoi të nderuar në ahsen-i takvim (mënyrën më të përsosur) me cilësinë e mëkëmbësit në tokë, Allahu i tërheq vëmendjen nga mëkati i hapur e i fshehtë, ashtu që ai të mos bierë në gropën e mëkatit dhe i fton në pendim ata që kanë rënë në mëkate, duke i lajmëruar se do t'ua mbulojë mëkatet e vogla atyre që largohen nga mëkatet e mëdha. Allahu i madhëruar thotë: *"Mos bëni mëkate as haptas dhe as fshehtas, sepse ata që bëjnë mëkat do të ndëshkohen për mëkatin e bërë."*[2] *"Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha të cilat ua kemi ndaluar, Ne ua mbulojmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm."*[3]

Shpirti i njeriut i cili është i fryrë nga shpirti hyjnor,

1. Muslim, Teube, 10.
2. el-En'am, 6/120.
3. en-Nisa, 4/31.

ashtu siç e shpreh Kur'ani, pasi të vijë në këtë botë duke hyrë në kafazin e trupit, siç e shpreh Mevlana, sëmuret me mosbindje ndaj Allahut dhe fillon të bierë në mëkate duke e harruar kështu fjalën që ia ka dhënë Atij. Sipas Mevlanës, mënyra për t'u mbrojtur dhe për t'u pastruar nga mëkati është kujtimi i premtimit dhe i betimit kur Allahu na ka pyetur elestu bi rabbikum. Mevlana thotë:

Vendos në vetvete një kusht dhe përpiqu që ta mbash premtimin!

Nëse nuk e mban premtimin, dije se nuk mund të përparosh me sëmundje shpirtërore

Kur gjendja jote t'i përshtatet premtimit për të qëndruar i pastër, të cilin e ke dhënë në ezel

Atë çast lindin me mijëra kënaqësi që ka fituar shpirti yt

Në këtë mënyrë zemra jote bëhet si hekur

Dhe ty në çdo çast të shfaqet një pjekuri

Për shkak se ke marrë përsipër amanetin, ty shpirti në botën e dëshirave

Të bëhet edhe muzikant edhe shfaqës i gotës dehëse të dashurisë

Pastaj të dhimbsen punët boshe të njerëzve të udhëzuar

Thesarin e fshehtë e gjen te vetvetja dhe e njeh atë.[4]

Takimi me Allahun, shpëtimi nga adhurimi i robit, nga adhurimi i vetes, i shejtanit, i epshit dhe nga adhurimi i mëkatit, mënyra e arritjes së kënaqësisë së Allahut duke pirë sherbetin e dashurisë në zemër, është mos'harrimi i premtimit dhe i betimit.

Psikologjia e mëkatit dhe fajit formon te njeriu reagime reflekse. Fajësia në ndërgjegje sjell ngushtim të zemrës. Ndjenja e keqardhjes vë në lëvizje te njeriu psikologjinë e pendimit dhe gjendjen shpirtërore për t'u pastruar nga mëkati. Me pendimin që bëhet në mënyrë të përshtatshme me kushtet e tij, e ndalon veten nga njollosja me mëkat, nuk e lejon të nxihet dhe së fundi e mbron zemrën nga ngurtësimi. Ndërsa mëkati pa pendim e bën zemrën të papastër. Kështu që Allahu i madhëruar thotë: *"Jo! Përkundrazi (mëkatet) që bënin ata ua mbuluan zemrat e tyre."*[5] Pastrimi i njeriut nga papastërtitë e mëkatit ia ndriçon atij të dy botërat. Mevlana në *Divan* thotë:

Nëse e pakëson tymin në shtëpinë e zemrës dhe e pastron atë nga papastërtitë e mëkatit, drita jotë ndriçon në të dy botët, në këtë botë dhe në botën tjetër.

Nëse shikon ujin e turbullt, aty nuk mund të shikosh as hënën dhe as qiellin! Kur bie mbrëmja fshihet dielli dhe hëna![6]

Për t'u pastruar nga papastërtitë shpirtërore, për t'u pastruar nga mëkatet dhe për t'i sfiduar ato duke ecur hap pas hapi, duhet të takohemi me Allahun duke përparuar ashtu siç u ka hije të dashuruarve me Allahun. Në fakt, Allahu dëshiron që njerëzit t'i pastrojnë zemrat e tyre me lot e pendim, ashtu që të pastrohen nga mëkatet, të forcojnë vullnetin e tyre me adhurim e sexhde dhe njofton se *"Namazi e largon njeriun nga çdo ligësi dhe nga gjërat e shëmtuara."*[7] Sepse është e pamundur që njeriu të bjerë në mëkat duke thënë Allah me gjithë zemër. Ai i cili i nënshtrohet epshit, mbytet në mëkate dhe papastërti shpirtërore.

> *O njeri i padrejtë! Dora dhe këmba jote dëshmon edhe në këtë botë për atë gjë që ke të fshehtë në zemrën tënde dhe thotë: "Këtu ka një njeri të fshehtë. Mos e pandeh veten të vetmuar!".*

Të gjitha vetitë e mira vijnë nga zemra, ndërsa burimi i të gjithë ligësive është trupi i cili është krijuar nga balta. Atij që ndjek veten dhe i nënshtrohet epshit, i trashet më shumë balta e trupit, i shtohet dhe ai mbytet më shumë në mëkate dhe papastërti shpirtërore. Ndërsa dembelizmi në çështjen e lënies së dëshirave vetjake e dobëson njeriun. Ndërkohë, ai i cili i mposht dëshirat dhe pasionet vetiake arrin qetësinë duke i kapërcyer të gjitha vështirësitë.

Njeriu, qoftë qafir, qoftë i prishur apo qoftë imoral, të gjithë i shqyejnë me duart e veta perdet e mëkateve të mbuluara ndërmjet të fshehtave shpirtërore dhe i shtrojnë ata përpara syve të njerëzve. Ai njeri i cili i ekspozon këto duke i shqyer perdet e mëkatit, sipas Mevlanës pothuajse thotë kështu: "Më shikoni mua! Unë kam brirë. Shikojeni haptaz mëzatin e xhehennemit, domethënë banorin e xhehennemit! O njeri i

4. Shefik Xhan, Pjesë të Zgjedhura nga Divani Kebir, vëll. 1, fq. 251.

5. el-Mutaffifin, 83/14.

6. Pjesë të Zgjedhura nga Divani Kebir, vëll. 1, fq. 102.

7. el-Ankebut, 29/45.

padrejtë! Dora dhe këmba jote dëshmon edhe në këtë botë për atë gjë që ke të fshehtë në zemrën tënde dhe thotë: "Këtu ka një njeri të fshehtë. Mos e pandeh veten të vetmuar!". Veçanërisht kur je i i zemëruar dhe kur përgojon, e fshehta dhe bota shpirtërore e nxjerrin këtë në shesh me të gjitha detajet. Padrejtësitë që ke bërë e vuajtjet që u ke shkaktuar të tjerëve të vijnë te koka si një polic dhe të thonë: "O dorë e këmbë, nxirrini në pah ato që keni bërë e mos i fshihni!"[8] dhe pastaj e brejnë zemrën e njeriut.

Edhe puna e ëngjëjve 'Kiramen Katibin' është që të shkruajnë veprat tona të mira dhe jo që të shkruajnë veprat e këqija, apo jo? Në të vërtetë, edhe zemra jonë, shpirti ynë dhe ndërgjegja jonë, ashtu si dhe ëngjëjt kanë për detyrë të regjistrojnë ato gjëra që kemi bërë. Këto regjistrime qëndrojnë në zemrën tonë si qetësi e rehati, ose si diçka që na përvëlon nga brenda. Nëse këto ndjenja kontrollohen mirë, mund ta mbrojnë njeriun që të mos bierë në mëkat.

Njeriun që ka rënë në mëkat, Mevlana e përngjason me gomarin që ka rënë në baltë dhe thotë: Edhe një gomar, nëse ka rënë në baltë duke menduar që të ecë shpejt, mundohet të ngrihet për të shpëtuar. Ai nuk mundohet të qëndrojë aty dhe ta rregullojë vendin ku ka rënë, ashtu që të vendoset. Sepse e di që në atë vend nuk jetohet. A është ndjenja jote më poshtë se ndjenja e gomarit që nuk ngrihet nga balta e vetive të këqija, e mëkateve dhe pasioneve të kësaj bote? Kur bën mëkat, bën edhe komente, përpiqesh ta nxjerrësh veten në të drejtë dhe nuk dëshiron ta nxjerrësh zemrën nga ndjenjat që të ulin ty. "Çfarë të bëj, nuk kam mundësi të bëj asgjë. Allahu është bujar. Nuk e shikon fajin e robit të paaftë".[9]

Njeriu, ashtu sikundër ka thënë poeti, ka të drejtë të thotë:

Sado që të jemë fajtor, nuk e pres shpresën

Nga bujaria e Tij e cila është sa deti dhe oqeani

Ai që bën mëkate duke i neglizhuar, nuk duhet ta harrojë të vërtetën se do të hyjë në xhehennem duke u nënçmuar. Ndjenja e shpresës nuk duhet ta shpjerë njeriun që të bëjë mëkat pa kufi dhe pa përgjegjësi.

Amr bin Osmani, i cili ishte prej miqve të Allahut, ishte shumë i ndjeshëm në çështjen e pendimit. Çdokënd që bënte mëkat, e inkurajonte që të pendohej dhe thoshte: "Pendimi është farz (obligim) për këdo që bën mëkat të madh apo të vogël. Pasi të bësh një herë mëkat, askush nuk mund të justifikohet në çështjen e lënies së pendimit. Sepse Allahu i ka kërcënuar mëkatarët. Ky kërcënim hyjnor mund të shuhet vetëm me pendim."

Muhammed b. Vasi, i cili ishte prej sulltanëve shpirtërorë, thotë: "Sikur çdo mëkat të kishte erë, ju nuk do të më afroheshit dot mua për shkak të erës së keqe. Ashtu sikundër është e habitshme të shikosh në xhennet një njeri që qan, po aq e habitshme është të shikosh edhe në këtë botë një njeri që qesh dhe që nuk qan."

Kur e pyesnin "Si je?" përgjigjej:

-"Siç mund të jetë ai njeri që i pakësohet jeta, i shtohen mëkatet dhe që çdo ditë i afrohet një shkallë vdekjes, ashtu jam edhe unë". Dhe i këshillonte që të mos e harronin vdekjen dhe botën botën tjetër.

Pikëllimi për mëkatin dhe shpresa e pendimit formon te njeriu përpjekjen për t'i bërë veprat me ndjenjën e mirësisë dhe njëkohësisht psikologjinë e mëkatit dhe pendimit.

8. Shefik Xhan, Përkthimi i Mesnevisë, III-IV, fq. 130, rreshti nr: 2455.
9. Shefik Xhan, I-II, fq. 512, rreshti nr: 3355.

7 njerëz të mirë

Murat Kaja

1. Kryetari i shtetit i cili punon me drejtësi.
2. I riu që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit të Allahut.
3. Njeriu, zemra e të cilit është e lidhur mbas xhamisë.
4. Ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut.
5. Ai që ruan nderin dhe namusin.
6. Mirëbërësi, i cili atë që jep me dorën e djathtë nuk ia di e majta.
7. Ai që e përmend Allahun kur është i vetmuar.

Profeti (a.s.), ka ndjekur metoda të shumta për t'ia mësuar njerëzve këtë fe. Përveç urdhërave dhe ndalesave, ndonjëherë ka rregulluar gabimin ose ka miratuar edhe punën e mirë të ndokujt. Ndonjëherë u ka drejtuar pyetje shokëve të tij dhe përgjigjen përsëri e ka dhënë vetë. Pyetjeve që i bëheshin, ndonjëherë u përgjigjej ashtu sikur ishte, por ndonjëherë duke dhënë edhe më tepër detaje nga ç'kërkohej.

Ka qëlluar t'i mësonte edhe duke e vepruar, ose duke u larguar vetë nga një vepër. Ndonjëherë ka folur pak dhe saktë, arsye për të cilën e kanë quajtur edhe **"xhevamiu'l-kelim",** që do të thotë, "tregon shumë, me pak fjalë". Këto fjalë ai i ka gëdhendur në mendjen e njerëzve, duke i përmendur nga tri herë. Ndonjëherë, çështjen e ka shpjeguar gjërë e gjatë, ka treguar ndodhi dhe ka portretizuar çështje të ndryshme. Dhe ndonjëherë, i shpjegonte të ndara në kategori...

Është e mundur që këto t'i japim një nga një, me shembuj, sepse librat e haditheve janë të mbushur me mijëra nga këto shembuj. Mirëpo, këtu duam të marrim në dorë një hadith që na tregon se si i Dërguari i Allahut u ka mësuar njerëzve fenë, moralin e lartë, urtësinë dhe vlerat, duke ua dhënë diturinë të ndarë në kategori dhe grupe.

I Dërguari i Allahut na e përkujton shpesh botën tjetër dhe i portretizon në një mënyrë të gjallë ato që do të ndodhin atje, gjëndjen dhe veprimet e njerëzve. Ja pra, hadithi ynë fillon duke treguar gjëndjen e njerëzve në botën tjetër: **"Atë ditë Allahu do të marrë nën hijen e (arshit të) vet shtatë persona. Atë ditë nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së (arshit të) Tij."** (Buhari, Xhemaat dhe Imamet, 8; Muslim, Zekat, 91) Me këtë, Profeti (a.s.) na sjell para syve edhe gjëndjen e asaj dite në botën tjetër, por na bën edhe kureshtar për të ditur se cilët janë këta persona. Cilët janë këta shtatë persona fatlumë? Ç'është ajo që i bën ata të përgëzohen me këtë mirësi?

Në fillim Resulullahu (a.s.) tregon për kryetarin e shtetit që punon me drejtësi. Pra këtu na jepet një stimulim drejt fushës materiale të kësaj bote. Që në fillim, ai sikur na jep mesazhin se në këtë fe materialja dhe shpirtërorja janë të lidhura si mishi me thoin. Resulullahu (a.s.) i jep shumë rëndësi sigurisë dhe mirëqënies ekonomike të njerëzve dhe dëshiron që populli të jetojë i qetë dhe i sigurtë. Për këtë arsye, nuk e lë bosh këtë fushë. Ai vë në dukje një vlerë universale: Drejtësinë. Ky është edhe një princip i cili theksohet shumë në Kur'anin Famëlartë. (Nisa 4/58; Maide 5/8; Nahl 16/90) Madje Kur'ani na tregon për Davudin (a.s.), i cili gjendet në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe materiale. Allahu e urdhëron edhe atë, që të prijë me drejtësi dhe me barazi. (Sad 38/26). Në një farë mënyre, edhe Omeri (r.a.) halifja i dytë i Profetit (a.s.) e përforcon këtë princip. Me veprimtaritë që zhvilloi, me institucionet që formoi dhe me vendimet që mori, ai u bë njeriu i parë që përfitoi nga ky përgëzim që solli Profeti (a.s.). Ai përbën shembullin konkret të këtij principi që stabilizoi Islami. Për këtë arsye, ai është quajtur "Umeru adlun", që do të thotë, "Omeri (r.a.) është vetë drejtësia".

Së dyti, Profeti (a.s.) bën fjalë për të riun që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit. Këta janë kategoria e dytë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e arshit të Allahut. Të rinjtë që edukohen prej vegjëlisë me vetëdijen e besimit, të cilët ecin me kokën lart dhe pa u ndarë nga rruga e drejtë, në kohën kur iu zjen gjaku dhe kur mjedisi përreth tyre është mbushur përplot me qendra joshëse. Të rinjtë që përkushtohen me kujdes, me dashuri, me energji dhe dinamizmin në këtë rrugë...

Në Kur'anin Famëlartë kemi shembullin e "Shokëve të shpellës". Allahu shprehet me lëvdata për këta të rinj sakrifikues! Që në fillim, përreth Resulullahut ka patur gjithmonë të rinj. Çështja e shenjtë e Islamit është lartësuar mbi supet e këtyre të rinjve të devotshëm. Janë ata që mundohen dhe punojnë për t'ia mësuar vets dhe të tjerëve Kur'anin në Mekke. Janë përsëri ata që qëndrojnë në krye të luftës në Medine dhe në përhapjen e Islamit në vënde të ndryshme. Aliu (r.a.) është shembulli më i mirë i atyre që e kanë kushtuar jetën e tyre në rrugën e Allahut. I pari që besoi, i pari që rrezikoi jetën në kohën e hixhretit, Luani i Allahut në Bedir dhe Uhud, Aliu (r.a.).

Së treti, vjen ai zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Pra, besimtari në zemrën e të cilit ndodhet një dashuri e pashoqe për xhaminë. Një vakt namaz e ka falur dhe pret me padurim të vijë vakti tjetër. Një njeri shumë i përkushtuar në faljen e namazit në xhami dhe në ripërtëritjen e sunnetit. Xhamia ujë dhe besimtarët peshq! Si mos ta dojë xhaminë besimtari? Në kohën kur Resulullahu (a.s.) emigroi për në Medine, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie dhe dhe ai vetë mbajti gurë në supet e tij. Zemra e muslimanëve dhe pulsi i bashkësisë Islame rreh gjithmonë nëpër xhamia. Bashkimi, vëllazëria është aty. Ndihma dhe solidariteti janë aty. Libri i Allahut lexohet aty, emri i Tij përmendet aty dhe njerëzit po prej aty thirren për në shpëtim. Xhamitë janë projektimi i mëshirës që zbret nga Qabja. Mëshira gurgullon në xhami, qetësia zbret në xhami. Ja pra, për këtë arsye besimtarët që kanë dashuri për xhaminë dhe xhematin dhe që ndjejnë dëshirën për shërbim ndaj xhamisë, do të jenë nën hijen e arshit në ditën e kiametit.

Së katërti, Profeti (a.s.) na tregon për **ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut**. Midis tyre nuk ka ndonjë interes të kësaj bote por ka vetëm një miqësi të pastër dhe pa pretendime. Kur bashkohen, bashkohen për hir të Allahut duke shpresuar kënaqësinë e Tij. Madje,

edhe kur ndahen, ndahen për hir të Tij dhe shpresojnë kënaqësinë e Tij. Dhe kjo dashuri midis tyre vazhdon deri në fund të jetës. Çfarë ka më me vlerë në jetë se sa një mik i sinqertë? Të dimë që kemi një mik të sinqert dhe besnik, që e duam dhe e duan, na jep një qetësi të madhe shpirtërore. Një pjesë e bukurisë së jetës përbëhet nga miqësia e ngrohtë, nga ajo miqësi që nuk bazohet në interesa...

Në Kur'anin Famëlartë flitet për miq që do të jenë armiq në ditën e kiametit. Mirëpo, miqtë e vërtetë do të jenë larg kësaj. (Zuhruf 43/67) Në një vend tjetër tregohet për dikë që meriton dënimin dhe ky me një pendim të thellë thotë: **"Ah sikur të mos isha mik i filanit!"** (Furkan 25/28) Sa miqësi e bukur është ajo e të Dërguarit të Allahut (a.s.) me sahabët e Tij si Ebu Bekri dhe Omeri (r.a.)! Përfytyroni për pak çaste tabllon e sinqertë që ekspozojnë këta miq të ngrohtë, të cilët bisedojnë të ulur pranë një pusi!

I pesti është ai që i jep një rëndësi të veçantë, nderit dhe namusit. **Një grua me pushtet i propozon këtij marrëdhënie të pamoralshme dhe ky e refuzon atë duke thënë, "unë i friksohem Allahut"**. Sa virtyt i madh është nderi! Për çfarë virtytesh mund të bëhet fjalë, nëse në një popull ka humbur ndjenjat e nderit dhe namusit? Ja pra, ajo që na e siguron këtë ndjenjë është devotshmëria. Pra të jesh i vetëdijshëm kundrejt përgjegjsive që ke ndaj Allahut.

Ato që ka jetuar Jusufi (a.s.) janë të njëjta me ato që na ka treguar Resulullahu (a.s.). Të gjithë e dimë ndodhinë. Në suren Jusuf ajo jepet me detaje. Mirëpo, përgjigja e atij njeriu të lartë ndaj një propozimi të pamoralshëm është shumë ndikuese: **"Allahu më ruajtë nga kjo gjë. Si mund të bëj këtë pasi që Allahu më ka dhuruar këto mirësi."** (Jusuf 12/23) Në rrethin që jetonte Jusufi (a.s.), edhe burrat edhe gratë ishin zhytur nga koka tek këmbët në imoralitet. Jusufi (a.s.) e pa më të arsyeshme të qëndronte në burg, se sa të jetonte pa ndjenja në një rreth të tillë: **"Ai (Jusufi) tha: "O Zoti im, burgu është më i dashur për mua, se sa ajo që ma ofrojnë ato mua..."** (Jusuf 12/33) Lutja e Profetit tonë (a.s.) do të na ndihmojë në këto raste : " Allahu im, dëshiroj prej teje që të jem në rrugë të drejtë, të përqafohem me devotshmërinë dhe të jetoj me nder." Gjithashtu, edhe zotëruesi i dy dritave në kohën e Profetit, Osmani (r.a.), na ndriçon rrugën me ndjesinë e tij të veçantë ndaj nderit dhe turpit!

Për sa i përket të gjashtit, Profeti (a.s.), me këtë nënvizon një pikë të rëndësishme. Pra, **dora e majtë e atij që bën mirë nuk duhet të dijë se ç'bën dora e djathtë**. Kështu që, ai njeri mirësinë e bën në mënyrë të fshehtë. Sepse qëllimi i tij është vetëm kënaqësia e Allahut. Ai nuk e bën këtë për sy e faqe. Në ajetin e ndershëm shprehet se të japësh haptas është mirë, por të japësh fshehtas është edhe më mirë, (Bakara 2/271). Profeti i dashur, çështjen e fshehtësisë e ka shprehur në një mënyrë shumë interesante, për arsye që ai i cili merr lëmoshë të mos turpërohet midis të tjerëve. Atë që jep dora e djathë të mos e dijë e majta! Sigurisht, edhe njerëzit që marrin lëmoshë kanë një ndjenjë nderi dhe krenarie. Prandaj, kur të jepet, duhet të jepet pa i cënuar ndjenjat e tyre. Ja pra, edhe ata që e kanë këtë ndjesi, do të jenë nën hijen e arshit.

I shtati dhe i fundit është **ai që e përmend Allahun dhe të Dërguarin e Tij kur gjëndet i vetmuar**. Ky njeri është aq i mbushur me dashuri ndaj Allahut, sa që nga sytë e tij rrjedhin lot. Dashuria hyjnore ia djeg zemrën. Zemra e shuan zjarrin dhe shpirti e ujit tokën me lotët e tij. Kur e përmend Allahun dhe e lexon librin e Tij, zemra i rrënqethet dhe i mbushet me devotshmëri dhe mëshirë. Shpirti i tij fiton butësi dhe pastërti! Edhe Profeti (a.s.) i ka kaluar disa nga netët e Tij i mbytur në lot. Kryen adhurim, lexon Kur'an dhe derdh lot i Dërguari i Allahut (a.s.). Edhe shoku i Tij më i ngushtë Ebu Bekri (r.a.) kishte një zemër të tillë. Në mesxhidin që ndërtoi përpara shtëpisë së tij në Mekke, lexonte Kur'an duke qarë. Vajza e tij Aishe (r.a.) na e tregon atë si "një njeri me zemër të butë dhe sylagur". Mirëpo këtë nuk mund ta shpjegosh dot me fjalë, nëse nuk e jeton, nuk e kupton.

Hadithi ynë fillon me materialen dhe mbaron me shpirtëroren. Në këtë fe, rëndësia që i jepet rregullimit të jetës së kësaj bote është po aq e madhe sa edhe rëndësia që i jepet forcimit dhe pasurimit të botës shpirtërore të njeriut. Me këtë hadith, i Dërguari i Allahut (a.s.) na ka paraqitur një manifestim të principeve universale të Islamit. Ky hadith është si një ylber që pasqyron shtatë ngjyrat themelore të diellit Islam. Ai nxjerr në pah ngjyrat që i jep Islami këtyre vlerave, që nga principi i lidhur me shtetin, marrëdhëniet shoqërore, kujdesi që duhet treguar në punë të mira dhe deri tek rëndësia që kanë marrëdhëniet e njeriut me Allahun. Nëse e marrim numrin shtatë si një kuptim figurativ të shumicës, pra simbolin që tregon një sasi të madhe, do të shikojmë se këto pika janë dimensione që zgjaten për tek principet e tjera.

Pendimi

Jashar Kandemir

D jalli e mashtron njeriun dhe e orienton për të bërë mëkat.

Sepse djalli është armiku i njeriut.

Edhe njerëzit me besim të fortë gabojnë nga shkaku i joshjeve të shejtanit.

Shkurtimisht, të gjithë mund të mëkatojnë përveç atyre që i mbron Allahu.

Çdo mëkat që bëhet, lë gjurmë në zemër, si një pikë e zezë. Nëse robi i largohet mëkatit që ka bërë, i drejtohet Allahut dhe kërkon falje nga Ai, zemra e tij e arrin përsëri pastërtinë e mëparshme. Por nëse nuk vepron kështu dhe vazhdon të bëjë mëkate, pikat e zeza në zemër i shtohen. Ajeti "Jo, mëkatet që bënë ata ua kanë nxirë zemrat", flet për këto pika të zeza.

LARGIMI NGA MËKATET E VOGLA

Njerëzit në përgjithësi nuk u japin rëndësi mëkateve të vogla dhe nuk e shikojnë si problematike kryerjen e tyre. Ky konceptim bëhet shkak që të shtohen mëkatet.

Shërbëtori i Pejgamberit, Enes bin Malik shpreh me keqardhje se në vitet pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut s.a.v., njerëzit filluan të neglizhonin në këtë çështje dhe i shikonin si të thjeshta e të parëndësishme veprat që në kohën e të Nderuarit tonë llogariteshin si mëkate të mëdha.

Por i Dërguari i Allahut s.a.v. e këshilloi bashkëshorten e tij të dashur, Aishe që të largohej nga mëkatet që njerëzit i nënçmonin dhe i kujtoi asaj se ka ëngjëj të cilët i shikojnë dhe i rregjistrojnë mëkatet e vogla.

Ai lajmëroi se mëkatet që duken të vogla, e gëzojnë shumë shejtanin e mallkuar.

DUHET TË PENDOHEMI SA KEMI NË KOHË

Ja, për këtë arsye Allahu Teala i urren mëkatet dhe dëshiron që ne t'ua kthejmë shpinën atyre,

Dëshiron që t'i kthehemi Atij duke u penduar me gjithë zemër dhe duke ndjerë keqardhje,

Ai pret që t'i përgjërohemi, ashtu që të na falë,

Dhe thotë se vetëm atëherë mund të na i falë veprat tona të këqija.

Sepse vetëm Allahu është ai që i pranon pendimet e robërve, që ua fal të këqijat dhe i cili e di çdo gjë që veprojnë.

Meqë e vërteta është kjo, atëherë nuk duhet të vonohemi për t'u penduar, ashtu që t'i kthehemi e t'i dorëzohemi Allahut para se të vijë vdekja.

Kur të mos veprojmë kështu, duhet të dimë se askush nuk ka fuqi ta mbrojë njeriun nga problemet që mund t'i ndodhin në të ardhmen.

Por sa keq që shumë njerëz janë tolerantë në këtë çështje, vazhdojnë të bëjnë vepra të këqija deri në çastin e vdekjes, dhe kur u vjen vdekja kërkojnë të falen, duke thënë "Tani po pendohem".

Por Allahu Teala kurrë nuk i pranon pendimet e atyre që veprojnë kështu.

SHEMBËLLTYRA PROFETIKE

Pejgamberi ynë i Nderuar ka qënë shembull për ne edhe në këtë çështje. Edhe pse ishte përgëzuar me faljen e mëkateve, ai pendohej duke kërkuar falje nga Allahu nganjëherë **shtatëdhjetë herë në ditë** dhe nganjëherë **njëqind herë në ditë**.

Madje nganjëherë edhe në vendin ku ishte ulur i përgjërohej Allahut duke thënë njëqind herë:

"O Zoti im! Më fal mua dhe ma prano pendimin tim! Me të vërtetë Ti je mëshiruesi që i pranon pendimet".

Njeriu duhet të turpërohet nga Allahu për të keqen që bën, duhet ta vrasë ndërgjegja dhe të pendohet për gabimin që ka bërë.

Mënyra më e mirë për t'u bërë pishman është pendimi.

Kur robi të bëjë ndonjë mëkat, duhet të lutet 'O Zot, të lutem më fal!'

Kjo quhet **istigfar**.

Të pendohesh do të thotë të ndjesh keqardhje për mëkatet që ke bërë.

ALLAHU E DO ATË QË PENDOHET

Allahu gëzohet shumë kur robi pendohet. I Nderuari ynë këtë fakt e përngjason kështu: Kur robi pendohet, Allahu gëzohet më shumë se sa njeriu i cili e humb devenë e tij në shkretëtirë bashkë me ujin e ushqimin dhe e gjen atë ndërkohë që po ballafaqohet me vdekjen.

Përse pendimi i një njeriu e gëzon kaq shumë Allahun Teala?

Për shkak të mëshirës së madhe që ka për robin e Tij.

I Dërguari i Allahu thotë se për shkak të kësaj dashurie dhe mëshire, Allahu i Lartësuar pret tërë natën që t'ia pranojë pendimin atij që ka bëërë mëkat ditën, dhe pret tërë ditën që t'ia pranojë pendimin atij që ka bërë mëkat natën.

DERA E PENDIMIT ËSHTË GJITHMONË E HAPUR

Nuk ka ndonjë kohë të caktuar për t'u pastruar duke u penduar.

Një njeri mund të pastrohet nga mëkatet duke u penduar, përderisa nuk ka filluar të japë shpirtin. Një pendim i bërë me sinqeritet i fshin dhe i shkatërron të gjitha mëkatet përveç hakut të robit.

Ndërsa haku i robit mund të falet vetëm duke u paguar apo duke u bërë hallall.

Në kohën e Pejgamberit tonë të Nderuar, një grua kishte bërë zina. Ajo u pendua shumë për atë që kishte bërë. Peshën e mëkatit që kishte bërë e ndjeu në zemër, shkoi disa herë te i Dërguari i Nderuar dhe duke këmbëngulur i tha se dëshironte ta merrte ndëshkimin në këtë botë dhe se nuk dëshironte ta linte për në botën tjetër. Ajo u ndëshkua.

Njëri prej sahabëve të rëndësishëm e nënvlerësoi gjendjen e gruas. Pejgamber nuk e pa të drejtë këtë sjellje të tij. Ai tha se ajo grua është penduar me gjithë zemër dhe nëse pendimi i saj do t'u shpërndahej shtatëdhjetë banorëve të Medinës, do të mjaftonte për t'u falur të gjithë ata.

Ajo që e bën të vlefshën pendimin është:

Të të shqetësohet zemra dhe të pendohesh për shkak të mëkatit që ke bërë,

Mëkatari duhet ta lërë plotësisht atë sjellje të keqe,

Dhe të japë fjalën se nuk do ta bëjë më atë asnjëherë.

Nëqoftëse çështja ka lidhje me hakun e robit, atëherë ai duhet t'i kërkojë atij të cilit i ka hyrë në hak që ai ta falë.

TË DIMË SE KA NJË ZOT

Nëse myslimani largohet nga mëkatet e mëdha, Allahu mund t'ia falë mëkatet e vogla që ka bërë, sepse Ai është bujar në çështjen e faljes.

Të dish se ka një Zot që t'i fal mëkatet dhe të kërkosh falje sinqerisht duke iu drejtuar Allahut, kjo mjafton për t'i fshirë mëkatet.

Sipas asaj që na ka njoftuar i Nderuari ynë, kur një rob i përgjërohet Zotit 'O Zot! Unë bëra një mëkat, të lutem më fal!' pasi ka bërë një mëkat me dashje, Allahu Teala thotë:

"Domethënë robi im e di se ka një Zot që mund t'ia falë mëkatin apo ta ndëshkojë. Atëherë edhe unë e fal robin tim".

Nëse ai rob jeton për një kohë pa bërë mëkate, pastaj bën mëkat përsëri dhe vepron në të njëjtën mënyrë duke iu drejtuar Zotit dhe duke i kërkuar falje, Allahu Teala kënaqet nga robi për shkak se iu drejtua Atij dhe e fal atë.

Nëse robi e kupton gabimin pasi të bëjë një mëkat, e kujton Zotin, i drejtohet Atij dhe pendohet, kjo e kënaq shumë Allahun dhe Ai thotë "Tashmë robi im le të bëjë ç'të dojë".

Ky përgëzim hyjnor u sjell fllade mëshire zemrave besimtare dhe i ndalon mëkatarët që të bien në batakun e pesimizmit.

PO NËSE NUK MË MJAFTOJNË MIRËSITË E MIA!

Allahu i Lartësuar ka premtuar se mirësive do t'u japë sevape të shumfishuara.

Ka thënë se nganjëherë një mirësi do ta shpërblejë me **dhjetëfishin** e saj.

Po ashtu ka thënë se nganjëherë do t'i japë sevap nga **dhjetëfish** e deri në **shtatëqind fish**, madje edhe më shumë.

Kjo masë mëshire tregon se një pendim i sinqertë mund ta fshijë dhe ta zhdukë një mëkat edhe nëse është sa malet.

Parimet e jetës nga Aliu

Ali Byjykçapar

Transmetohet se Aliu (r.a.), e ka këshilluar djalin e tij Hasanin (r.a.): "Biri im, para së gjithash ki frikë Allahun, ashtu siç i takon. Zbatoji të gjitha urdhrat e Tij. Gjallëroje zemrën duke e përmendur shpesh Atë. Kapu fort prej litarit të Tij. Nëse arrin të mbahesh, nuk do të gjesh lidhje më të fortë se sa lidhja me Zotin tënd. Forcoje zemrën me këshilla. Me anë të devotshmërisë, braktise dhe vrite dashurinë që ka zemra për pasurinë e kësaj bote dhe ndriçoje atë me drejtësi, dituri, butësi, fjalë të bukura dhe të vërtetën."

Kujtoje vdekjen dhe me anë të saj gjallëroje zemrën. Dije se çdo gjë do të shkatërrohet. Prandaj binde zemrën se edhe ajo do të kthehet në hiç. Tregoji asaj një nga një të gjitha fatkeqësitë dhe belatë e kësaj bote. Mendo, kujtoja vetes dhe të tjerëve se koha me rreptësinë dhe ulërimën e saj i kthen ditët dhe netët kundra teje.

Tregoji zemrës dhe egos historitë e popujve të mëparshëm. Mendo për fatkeqësitë që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën. Kujdesu që mos të të ndodhë e njëjta gjë. Shëtit në tokën që kanë jetuar të parët e tu dhe analizoji me vëmendje gjurmët e tyre. Çfarë kanë bërë, prej nga dhe përse kanë emigruar? Kur t'i analizosh të gjitha këto, do të shohësh se ata u ndanë nga shokët dhe të afërmit duke emigruar në vende të huaja. Njësoj si ata, shumë shpejt edhe ti do të emigrosh në vende të panjohura që nuk i ke parë. Prandaj përgatite dhe pastroje që tani vendin e të ardhmes tënde. Mos e shit botën tjetër për këtë botë.

Mos fol për atë që nuk ke dituri dhe mos u ngatërro në punët që nuk të takojnë. Çdo punë lërja të zotit të vet. Braktise rrugën prej së cilës ke frikë se do të vijë ndonjë fatkeqësi, sepse, është më mirë të braktisësh një punë prej së cilës ndjen rrezik, se sa të përparosh në të me frikë.

Puno siç duhet në rrugë të Allahut dhe mos ngurro të sakrifikosh dhe të luftosh për hir të

Tij. Fjalët e rënda të kujtdo qofshin, mos të të largojnë nga rruga e Allahut. Kudo që të jesh, mundohu të kapërcesh çdo pengesë për të arritur tek Ai.

Kupto dhe mëso çdo gjë që ka në Islam. Mësoje veten të jesh i durueshëm përballë vështirësive. Në çdo punë strehohu tek Allahu, sepse Ai është mbrojtësi më i mirë, streha më e mirë dhe shpëtuesi më i afërt. Dorëzoju Allahut në çdo punë, sepse është Ai që i ka falur çdo gjë njeriut dhe gjithashtu është Ai që e lë të mjerë.

Mendohu mirë para se të kryesh një punë. Këshillohu me njerëzit më të besueshëm që të marrësh vendimin më të mirë. Mundohu ta kuptosh drejt këtë këshillë dhe mos hiq dorë prej saj. Dije mirë se fjala më e vlefshme është ajo më e dobishmja. Nuk ka mirësi në dijen e padobishme. Prandaj dhe nuk pritet ndonjë dobi nga dituria që nuk është e nevojshme të mësohet.

Biri im! Sapo ndjeva se po jetoj momentet e fundit të jetës sime dhe se vazhdimisht po dobësohem. E pashë të arsyeshme të t'i bëja të ditura këshillat e mia, sepse nuk munda të gjeja kohë për të të thënë gjithçka që mendoj. Me ardhjen e exhelit, ashtu si trupi, po më dobësohet edhe kujtesa. Në zemrën tënde duhet të zënë vend këshillat e mia, para dëshirave, epsheve dhe ngatërresave të kësaj bote, që do të të bënin si një kalë kokëfortë. Prandaj një pjesë prej tyre po t'i lë me shkrim.

Biri im! Gjërat më të mira që do të përfitosh prej këshillave të mia, janë frika ndaj Allahut dhe strehimi tek Ai; zbatimi i punëve që t'i ka bërë farz dhe analizimi i gjurmëve të stërgjyshërve dhe të popujve të shkuar. Ashtu si ti tani që beson plotësisht tek vetvetja edhe stërgjyshërit e tu i besonin plotësisht vetes së tyre. Siç mendon ti tani, ashtu mendonin edhe ata në atë kohë. Por si përfundim, atë që e panë të mirë dhe të dobishme e mbajtën dhe u munduan që t'i kryenin me përpikmëri detyrat e tyre. Mirëpo këto të mos jenë shkak për shtimin e dyshimeve dhe armiqësive, por për të kuptuar dhe mësuar të vërtetën.

Para se të fillosh të analizosh, strehohu tek Allahu dhe kërko sukses prej Tij. Braktis çdo gjë që të ndjell dyshim dhe që të shpie në rrugë të gabuar. Kur të shohësh se zemra jote është qetësuar nga çdo e keqe, mendimet të janë qartësuar dhe dëshira jote e vetme të jetë gjetja e së vërtetës, fillo të mendosh për çështjet që të kam këshilluar. Por nëse mendon se nuk i zotëron ende këto, mos hyr në çështje të komplikuara, sepse do të bëhesh si ai që nuk sheh se ç'ka përpara vetes dhe çdo çast mund të biesh nëpër humnera, prej të cilave do të jetë e vështirë të dalësh. Kështu që do mbytesh dhe shkatërrohesh midis errësirave dhe padrejtësive. Ecja pa shikuar se ç'ka përpara dhe përballja me rrezikun e rrokullisjes në humnerë, nuk i shkon dikujt që mëson Islamin.

Biri im! Dëgjoji dhe kuptoji mirë këshillat e mia. Dije se Ai që mban në dorë vdekjen e çdo gjallese, mban në dorë edhe jetën e saj. Në fund të fundit, Ai që jep jetë, jep edhe vdekje. Është Ai që i bën të pasurit të varfër dhe të varfrit të pasur. Është Ai që jep çdo fatkeqësi dhe sëmundje. Është Ai që jep edhe zgjidhjen edhe ilaçin e sëmundjeve. E gjithë bota, me gurët, tokën, ngjyrat, formën, pemët dhe frutat e saj i përket Atij dhe ato lëvizin vetëm me dëshirën e Tij. Edhe bota tjetër, me llogarinë, dënimin, xhenetin, xhehenemin dhe me gjithçka të saj, që ne ende nuk e dimë, i përket Atij.

Nëse has në diçka për të cilën nuk ke njohuri, lërja paditurisë sate, sepse ti je krijesa e parë që je krijuar e paditur dhe që më vonë je mësuar. Sado të përparosh në dituri, padyshim që përsëri do të hasësh në diçka që nuk e di, sepse në fushën e mendimit ka shumë gjëra që ndodhen jashtë fuqisë së shikimit. Nëse di diçka prej këtyre çështjeve dhe, nëse Allahu t'i mëson disa gjëra, mos kujto se i ke arritur dhe i ke fituar me forcën tënde. Por strehohu tek ajo Qenie Madhështore që të ka krijuar pikërisht për këtë gjë, të ka furnizuar dhe të ka krijuar në formën më të bukur. Adhurimi dhe dashuria jote le të jenë vetëm për Atë dhe frika jote le të jetë vetëm prej Tij!..

Biri im! Dije se askush nuk ka njoftuar dhe nuk njofton në lidhje me Allahun ashtu siç ka njoftuar Profeti ynë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Pranoje atë si një prijës dhe komandantin e një ushtrie shpëtimtare.

Biri im! Dije se nëse Zoti yt që të ka krijuar do të kishte ndonjë ortak, do të vinin profetët e tij. Kështu që do të mësoje cilësitë dhe veprat e tij. Mirëpo, ai është deklarimi i vetëm që ka bërë për Veten. Askush nuk mund të ushqejë armiqësi kundër Tij në pronën e Vet. Ai nuk ka lindur askënd dhe nuk është i lindur. Nuk do të vdesë. Është i pafund. Ekziston para çdo gjëje, por ekzistenca e Tij nuk ka fillim. Do të ekzistojë pas çdo gjëje, por ekzistenca e Tij nuk do të ketë mbarim.

Fuqia dhe madhështia e Tij janë jashtë kufirit të zemrës dhe syrit tënd. Nëse i pranon dhe i beson këto, vepro siç të ka hije, duke menduar se sa i vogël je. Mendo për pafuqinë dhe dobësinë që ke kundrejt Tij. Ti ke nevojë për Të në çdo çështje. Drejtohu Atij, kërko pëlqimin e Tij dhe ki frikë nga dënimi i Tij. Mundohu t'ia zbatosh urdhrat, sepse Ai nuk të urdhëron gjë tjetër, përveç së mirës. Ruhu nga ato që të ka ndaluar, sepse Ai nuk të ndalon gjë tjetër përveç së keqes.

Biri im! Të lajmërova në lidhje me këtë botë dhe llojet e situatave të saj. Të thashë se çdo gjë që ndodhet në të do të emigrojë në një vend tjetër. Të tregova për botën tjetër, veprat që duhen kryer në këtë botë dhe përfundimin e tyre. Në lidhje me to të dhashë disa shembuj që të marrësh mësim prej tyre dhe me këta shembuj shpresova shpëtimin tënd."

FJALË TË ÇMUARA NGA ALIU (R.A.):

- Njeriu është i fshehur në gjuhën e tij. Bëjeni të flasë dhe do të kuptoni çfarë do të humbë prej vlerës së tij.

- Dynjaja është një kërmë. Ai që kërkon diçka prej saj duhet t'u rezistojë qenëve.

- Robi duhet të shpresojë vetëm tek Allahu dhe të frikësohet vetëm prej gjynaheve të veta.

- Ai që e njeh më së miri Allahun, është ai që e do dhe e respekton më shumë Atë.

- Në adhurimin pa dituri, në diturinë pa kuptim dhe në leximin e Kuranit pa meditim, nuk ka mirësi.

- Bëji mirë dikujt edhe nëse nuk ta njeh, sepse ajo do të peshojë më shumë se sa e mira që falënderohet.

- Edukata është fytyra e mendjes.

- I dituri edhe nëse vdes, është i gjallë, i padituri edhe nëse jeton, është i vdekur.

- Bëhem skllav i atij që më mëson qoftë edhe një shkronjë.

- Vlera e njeriut matet me të mirat që bën.

- Leximi i Kurani Kerimit është shërim për zemrën.

- Njerëzve, më parë mësojuni të vërtetën. Ai që e mëson atë, e njeh të pavërtetën.

- Ta vendosësh njeriun në vendin që nuk i takon është padrejtësi.

- Ai që njeh të Vërtetin, i kupton lehtësisht njerëzit që kanë arritur tek Ai. Ai, që më parë mëson të pavërtetën, e ka të vështirë ta njohë të vërtetën.

- Nëse e respekton të drejtën e babait edhe fëmija yt do ta respektojë të drejtën tënde.

- Njeriu koprrac, në këtë botë jeton si i varfër, por në botën tjetër do të gjykohet si i pasur.

- Duke u thyer zemrën miqve, plotëson dëshirat e armiqve.

- Nëse dëshiron t'u bësh mirë atyre që ke nën kujdestari, mësoju edukatën.

- Dy gjëra e prishin mendjen dhe kujdesin. Njëra është nxitimi dhe tjetra të dëshirosh të pamundurën.

- Përkushtimi i gruas në shërbimin ndaj burrit, është njësoj si lufta në rrugë të Allahut.

- Ai që mjaftohet me çfarë ka, shenjtërohet, ndërsa ai që tregohet i babëzitur poshtërohet.

- Ai që refuzon këshillën, gjen poshtërimin.

- Kur dikush falënderon dhënësin, bëhet shkak i shtimit të mirësisë.

- Harrimi i vdekjes është si pasojë e ndryshkjes së zemrës.

- Grykësia dhe shëndeti nuk gjenden kurrë në të njëjtin vend.

- Njeri i lumtur është ai që merr mësim nga të tjerët.

- Pëlqimi i vetvetes, është tregues i mendjelehtësisë së njeriut.

- Mik i vërtetë është ai që të rri pranë në kohë të vështirë.

- Ai që vrapon pas gjërave të panevojshme, humbet ato të nevojshmet.

- Dembelizmi ndaj namazit, është dobësi ndaj besimit.

- Durimi është perde ndaj hidhërimeve dhe ndihmës ndaj rreziqeve.

- Nëse doni të jetoni edhe pas vdekjes, lini një vepër të pavdekshme.

- Mënyra për të qendruar larg çdo problemi, është mbajtja e gjuhës.

- Kursimi e shton të paktën, ndërsa shpërdorimi e pakëson të shumtën.

- Nuk ka pasuri më të mirë se mendja, mik më të ngushtë se karakteri i mirë, trashëgimi më të mirë se edukata dhe nder më të madh se dituria.

Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë), i mësonin nga Aliu (r.a.), çështjet për të cilat nuk kishin dituri.

KËSHILLA ME VLERË NGA ALIU (R.A.).

Falënderimi i takon vetëm Allahut që krijoi çdo gjë nga asgjëja, që nxjerr dritën nga errësira dhe ringjall të vdekurit.

Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

Ruajuni nga kundërshtimi i Allahut. Veprat më të dobishme që do ta shpëtojnë robin, janë besimi, lufta në rrugë të Allahut, sinqeriteti i natyrshëm, namazi që është një nga shtyllat e fesë, dhënia e zekatit, të cilin Allahu e ka bërë farz, agjërimi i ramazanit, i cili është mburojë ndaj dënimit të Allahut, kryerja e haxhit, i cili largon varfërinë dhe lan gjynahet, vizita e të afërmve, e cila shton pasurinë, jetën dhe dashurinë e miqve, sadakaja e fshehtë, e cila fshin gjynahet, largon hidhërimin e Allahut dhe mirësia, e cila bëhet pengesë e një vdekjeje të tmerrshme dhe që të mbron nga frika.

Përmendeni vazhdimisht Allahun, sepse dhikri më i mirë është përkujtimi i Allahut. Kërkoni prej Allahut ato që Ai u ka premtuar të devotshmëve, sepse premtimi i Allahut është premtimi më i vërtetë. Ecni në rrugën e Profetit, sepse rruga e tij është rruga më e drejtë. Përmbajuni suneteve të tij, sepse ato janë praktikat më të zgjedhura. Mësoni librin e Allahut, sepse libri i Allahut përmban fjalët më të çmueshme. Kuptojeni drejt fenë, sepse kuptimi i drejtë i fesë ndriçon zemrat. Kërkoni shërim prej dritës së Kuranit, sepse ai është shërim për sëmundjet e zemrave. Lexojeni Kuranin ashtu siç i ka hije, sepse ai përmban mesazhet më të bukura. Kur lexohet Kuran, dëgjoni dhe mos flisni! Mbase Allahu ju mëshiron. Kur të gjeni rrugën e vërtetë me anë të Kuranit, qofshi të udhëzuar gjithmonë me ato që keni mësuar. Dijetari që nuk vepron me diturinë e tij, është si i padituri gjynahqar, i cili nuk mund ta gjejë rrugën e drejtë për shkak të padituri së. Sipas meje, gjynahu i dijetarit që nuk vepron me diturinë e tij, është më i madh në krahasim me gjynahun e të paditurit që dergjet në injorancën e vet. Por që të dy janë të humbur e të gjorë.



Mos u zhytni në fantazi, sepse bini në dyshime. Mos bini në dyshime, sepse dyshimi të çon në mohim. Mos shkoni drejt punës më të lehtë, sepse bëheni të pakujdesshëm. Mos u bëni të pakujdesshëm ndaj Allahut, sepse dilni të humbur. Nëse jeni të kujdesshëm, ju forcohet besimi në vetvete. Nëse keni besim në vetvete, nuk ju kaplon mendjemadhësia. Ata që janë të sinqertë ndaj vetes së tyre, janë më të bindur ndaj Allahut. Ndërsa ata që, më së shumti e mashtrojnë veten, janë më kryeneçët ndaj Allahut.

Ata që i binden Allahut janë më të sigurt ndaj fatkeqësive dhe më të qetë me ato që veprojnë. Ndërsa ata që e kundërshtojnë më së shumti Allahun, frikësohen nga çdo gjë dhe bëhen pishman për ato që veprojnë. Prej Allahut kërkoni qartësi në çdo çështje dhe shëndet të mirë. Gjëja më e mirë që ndodhet në zemrat tuaja është besimi absolut. Ndërsa në punët tuaja duhet të zgjidhni devotshmërinë.

Ata që veprojnë në fe me gjëra të shpikura më vonë, janë më të humburit, sepse çdo gjë e shpikur më vonë, është bidat. Çdokush që shpik diçka të re në fe është bidatçi. Ai që shpik bidate është gjithmonë i humbur dhe çdo bidat braktis një sunet. Mashtrimi i vërtetë është mashtrimi i dikujt në fenë e vet. Ai që mashtrohet e ka lënë veten në humbje. Hipokrizia është një lloj shirku ndaj Allahut. Ndërsa sinqeriteti është fakt për pranimin e veprave dhe një domosdoshmëri e besimit. Frekuentimi i vazhdueshëm i vendeve të argëtimit, të bën të harrosh urdhrat e Kuranit. Në ato vende vjen shejtani që e nxit njeriun në çdo ekstrem. Shoqërimi me femrat të prish zemrën. Ruajini sytë tuaj nga shikimi i femrave të cilat janë kurth i shejtanit! Qendroni të vendosur në premtimin që i keni dhënë Allahut, sepse Ai është bashkë me ata që mbajnë premtimet e dhëna. Ruajuni prej gënjeshtrës, sepse besimi nuk gjendet në një vend me gënjeshtrën. Ndershmëria të çon në shpëtim dhe të fisnikëron. Ndërsa gënjeshtra, e hedh njeriun nga një rrezik në tjetrin. Thoni të vërtetën që të njiheni i tillë. Veproni me ndershmëri që të jeni prej grupit të atyre që thonë të vërtetën.

Amanetet ua jepni atyre që janë të sigurt. Vizitoni miqtë që ju kanë harruar dhe ata të cilët janë të hidhëruar me ju. Mbani premtimet e dhëna. Nëse ndodheni në pozitën e vendimmarrësit, bëhuni të drejtë. Mos u mburrni me stërgjyshërit tuaj. Mos vini nofka dhe mos u tallni me njëri-tjetrin. Mos e urreni njëri-tjetrin. Ndihmoni të dobëtit, atyre që u është bërë padrejtësi, të vetmuarit, ata që janë në rrugë të Allahut, udhëtarët dhe robërit. Jini të dhimbsur me gratë e veja dhe jetimët. Përshëndeteni njëri-tjetrin me selam. Selamin e dhënë kthejeni në të njëjtën mënyrë ose edhe më bukur. Allahu i Madhëruar urdhëron:

"....Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe për t'u ruajtur nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër." (Maide, 2)

Tablotë Profetike

Xhemal Nar

Kurani është një libër që vërteton ekzistencën e profetëve. Islami është një fe që ka pranuar fetë hyjnore që janë shpallur para saj dhe i ka përsosur ato. Prandaj, edhe *tasavvufi*, që do të thotë "**jeta shpirtërore Islame**", është komentuar si përmbledhës i disa veçorive të caktuara të disa profetëve, emrat apo cilësitë e të cilëve janë rrëfyer në Kuran. **Huxhviri**, autori i librit "**Keshfu'l-mahxhub**", vepër e cila zë një vend të rëndësishëm në klasikët e tasavvufit, transmeton një koment të tillë të **Xhunejdit**: "Tasavvufi është ndërtuar mbi këto tetë tablo të tetë profetëve: bujaria e Ibrahimit (a.s.), pëlqimi dhe dorëzimi i Ismailit (a.s.), durimi i Ejjubit (a.s.), komunikimi me shenja i Zekerijasë (a.s.), vetmia e Jahjasë (a.s.), veshja e leshtë e Musasë (a.s.), udhëtimi i Isasë (a.s.) dhe varfëria e Muhamedit (a.s.). *(Shih. S. Uludag, Keşfu'l-Mahcub Tercemesi, f. 120)*. Tani, lë t'i analizojmë këto veçori të profetëve.

1. BUJARIA E IBRAHIMIT

Në Kuranin Famëlartë lajmërohet se Zoti i Madhëruar i ka dhënë statusin "Halil" Ibrahimit. *(Shih. Nisa, 4/125)* Sipas shpjegimeve të *tefsir*ëve (librat komentues të Kuranit), Ibrahimi (a.s.), ishte një profet që kishte shumë pasuri. Njëkohësisht, për arsye të kënaqësisë që ndjente duke u shërbyer mysafirëve, nuk ulej kurrë në sofër pa pasur ndonjë mysafir. Therte delet e veta dhe u shërbente mysafirëve që i vinin. *(Shih. Ruhu'l-bejan, II, f. 293)* Bujaria e Ibrahimit kishte arritur deri në ato përmasa, sa për hir të Zotit, nuk hezitonte të flijonte as të birin e tij, krijesën më të shtrenjtë për të. Në fakt, kjo gatishmëri për flijim mund të jetë edhe një simbol. Ndoshta simbolizon idenë e dhurimit edhe të gjërave më të shtrenjta të njeriut. Shprehja e Ibrahimit (a.s.), **"Iu dorëzova Zotit të gjithësisë"** *(el-Bekare, 2/131)* ka domethënien e mosnjohjes së një tjetri përveç Tij, shprehje me të cilën edhe tasavvufi fton *salik*ët (udhëtarët e tasavvufit) në një dorëzim dhe bujari të tillë. Pasi bujaria e vërtetë është të japësh edhe pasurinë edhe shpirtin në rrugën e Zotit.

2. PËLQIMI DHE DORËZIMI I ISMAILIT

Përgjigjja që i jep Ismaili të atit, Ibrahimit, është zeniti i dorëzimit tek Zoti i Madhëruar. Pasi Ibrahimi e njofton për urdhrin që kishte marrë nga Allahu, Ismaili (a.s.) i përgjigjet: **"O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm."** Kështu të dy iu bindën gjykimit hyjnor me pëlqim dhe dorëzim të plotë. *(Shih. es-Saffat, 37/102-103)* Të heqësh dorë nga jeta është e vështirë. Në veçanti në pranverën e jetës, të pranosh t'i japësh fund asaj për hir të Zotit, vetëm një dorëzim i vërtetë tek Ai mund ta realizojë këtë gjë. Gjithashtu edhe në tasavvuf, sufiu i vërtetë është ai që zotëron një dorëzim të kësaj natyre duke e flijuar veten për Zotëruesin e tij të vërtetë. Prandaj dhe Junus Emre thotë:

Në rrugën e Zotit, Ismail unë jam

Shpirtin jam gati ta bëj kurban.

Edhe në tasavvuf, kënaqësia nga gjykimi hyjnor dhe dorëzimi tek Krijuesi është vlerësuar si pozita më e lartë shpirtërore. Kënaqësia e vërtetë është të arrish të thuash:

E këndshme është për mua çdo gjë që prej Teje më vjen,

Qoftë ajo gonxhe trëndafili, por dhe qoftë gjemb,

Dhe në qoftë kaftan, dhe në qoftë qefin,

I këndshëm në qoftë çmim, dhe në qoftë ndëshkim!

3. DURIMI I EJUBIT

Koncepti durim thuajse është njësuar me Ejjubin (a.s.). Ai është simboli i durimit në Kuran. Këtë profet të lartë e zuri një sëmundje e pashërueshme. Ai e dinte se kjo ishte nga Krijuesi i tij, prandaj kurrë nuk u ankua, përkundrazi këtë gjendje e vlerësoi si një mundësi për të qenë më pranë Zotit. Kurani e shpjegon këtë situatë kështu: ***(Kujtoje) Ejjubin, kur iu lut Zotit të vet: "Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!"*** *(el-Enbija, 83-84)* Ejjubi ishte pjesëtar i një familjeje të pasur dhe të madhe. Me shkatërrimin e shtëpisë, atij i vdiq shumica e pjesëtarëve të familjes. I iku e gjithë pasuria. Ai kaloi një sëmundje prej më se dhjetë vjeçare. Pas gjithë këtyre fatkeqësive dhe shqetësimeve, asnjëherë nuk u ankua për gjendjen e tij. Iu dorëzua vullnetit të Zotit. As shëndet e mbarësi nuk i kërkoi. Me këmbënguljen e gruas, iu drejtua Atij në lutje. Lutja dhe shpjegimi i gjendjes, pa u ankuar është e lejueshme. Një gjë që i pëlqen Zotit të Madhëruar. Pas kësaj, Allahu ia largoi shqetësimin dhe e shëroi Ejjubin. Madje, atij i dha sërish mundësinë e krijimit të një familjeje të madhe. Allahu i Madhëruar e cilësoi Ejjubin (a.s.) si një rob me durim. *(Sad,43-44)* Durimi i Ejjubit është mbështetja dhe bazamenti më i madh i udhëtarit në rrugën e Zotit.

4. KOMUNIKIMI I ZEKERIJASË (A.S.), ME SHENJA

Në tasavvuf, shenjat *(ishare)* janë metoda të hulumtimit të thellësive të fjalëve. Në tefsirin e Kuranit dhe në

komentimet e haditheve ekziston një metodë që njihet si "**Ishari**". Komentimi i Kuranit me Kuran apo me hadith quhet "**Tefsiri rivaje**", ndërsa komentimi i Kuranit përmes arsyetimit, letërsisë dhe aspektit gjuhësor quhet **"Tefsiri diraje"**. Kurse komentimi i Kuranit duke u thelluar në kuptimin e brendshëm të fjalëve me bazë syrin e zemrës (*keshf*) dhe inspirimin *(ilham)* quhet **"Tefsiri ishari"**. Koncepti "ishari" që kalon këtu, tregon se çështjet trajtohen në planin simbolik dhe alegorik, gjë të cilën mund të arrijnë ta kuptojnë vetëm disa njerëz të veçantë. Sufitë krijojnë një lidhje mes kësaj metode dhe një gjendjeje të Zekerijasë (a.s.). Siç dihet, Zekerijai nuk kishte djalë. Në moshë të thyer i lutet Zotit për një trashëgimtar të mbarë. Allahu i Madhëruar, e pranoi lutjen e tij dhe i dha lajmin e mirë që do t'i dhuronte një djalë. Më pas, Zekerijai, duke menduar se ishte i moshuar dhe se e shoqja ishte shterpë, filloi të bëhej kureshtar për çështjen e realizimit dhe kërkoi nga Zoti që t'i jepte një shenjë rreth lajmit të mirë të djalit. Zoti më pas, i tha: ***"Shenjë për ty është se tri ditë nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, veçse me gjeste."*** *(Al-i Imran, 3/38-41; Merjem, 19/7-11)*

Në tasavvuf më shumë se shpjegimi i hollësishëm me fjalë të hapura, ekziston shpjegimi thelbësor dhe me simbole. Me shprehjet ***"Arifit* (njohës i së vërtetës) i mjaftojnë shenjat"; "Ai që është *arif* e kupton"; "Le të vijë ai që kupton pa lëvizur buza a gjuha"** kërkohet të tregohet se rruga nga zemra për tek zemra kalon nëpërmjet syrit e zemrës dhe se shumë fjalë janë të paafta për ta shprehur këtë gjë.

5. TËHUAJTJA E JAHJASË

Rruga e tasavvufit zakonisht është rruga e vetmisë, e të qenit i huaj në vendin tënd *(garib)*, sepse të ndihesh i tëhuajtur nga njerëzit dhe vetmia ndaj tyre është emigrim dhe afrim drejt Zotit. Jahjai, pra i biri i Zekerijasë dhe kushëriri i Isait është konsideruar i tëhuajtur *(garib)*, për arsye të numrit të pakët të besimtarëve që kishte dhe ngaqë ishte bërë dëshmor prej popullit të tij. Jahjai, në vendin e vet dhe me popullin e vet, pati jetuar si një i huaj. Ai ishte një profet që Allahu i kishte çuar *selam* në çastet e vetmisë së njeriut: në lindje, në vdekje dhe në ringjallje. *(Merjem, 15)*

Kjo vetmi dhe të qenët i huaj edhe në hadithe pasqyrohet në një përmasë interesante. Disa hadithe të kësaj çështjeje janë kështu: *"Ndieje veten si një udhëtar, i huaj në këtë botë."* (Buhari, Rikak, 3, Tirmidhi, Zuhd, 25, Ibn Maxhe, Zuhd, 3); *"Islami ka filluar si një tëhuajtje (garib) dhe sërish do t'i rikthehet asaj gjendjeje. Lum për ata të tëhuajtur, pra lum për ata që zgjedhin besimin në ato gjendje të huaja dhe të vetmuara."* (Muslimi, Iman, 232); *"Të tëhuajturit janë ata që do të përpiqen të rregullojnë traditën time (sunetin), pas prishjes së saj."* (Tirmidhi, Iman, 13)

6. UDHËTIMI I ISAIT (A.S.)

Isai ishte një profet që udhëtonte shumë dhe lëvizte shpesh. Ai ftonte bijtë e Izraelit për në monoteizëm, për të bërë të mundur që ata të takoheshin me fenë e Allahut. Metoda e edukimit në lëvizje e *salik*ëve në tasavvuf në një farë mënyre është një traditë *(sunet)* e Isasë. Në *sejru suluk* (procesi shpirtëror i një sufiut), krahas udhëtimit, është edhe metoda e *halvetit* (një mënyrë asketizmi) dhe *sohbetit* (prania në bisedën e udhërrëfyesit shpirtëror).

Në librat e tasavvufit, rrëfehet në forma të ndryshme mbështetja *(tevekkul)* e Isait tek Zoti, gjatë udhëtimeve të tij. Prandaj edhe **Huxhviri** thotë: *"Isai zhvishej nga gjithçka materiale dhe pastaj niste të udhëtonte, aq sa nuk kishte me vete asgjë tjetër përveç një ene të vogël dhe një krehëri. Enën e mori, ngaqë pa disa duke pirë ujë me grushta, ndërsa krehërin e mori ngaqë pa njërin duke krehur flokët me gishta." (Shih. Keşfu'l-Mahcub Tercemesi, f. 120)* Kjo gjendje e tij është bërë udhërrëfyes për sufitë, duke treguar se garanci duhet pasur ndaj Zotit e jo ndaj njerëzve.

7. VESHJA E LESHTË E MUSAIT (A.S.)

Dikur veshja e leshtë ishte tregues i modestisë. Ndryshe nga sot, atëherë nuk ishte e mundur që veshjet e leshta të përpunoheshin e të zbuteshin. Këto veshje dëmtonin trupin, nuk të linin të qetë si veshjet prej pambuku apo mëndafshi. Sufitë, duke u bazuar në transmetimet në lidhje me Musain (a.s.), kanë veshur veshje të leshta dhe e bënë traditë këtë praktikë. Edhe sipas **Ibn Mes'udit**, Profeti ynë ka thënë: *"Kur bisedoi Musai me Zotin, veshja e tij, xhybeja, pantollonat dhe mbulesa e kokës, të gjitha ishin të leshta."* (Tirmidhi, Libas, 10) Tradita e veshjes së këtij profeti të madh, vazhdoi edhe me profetin tonë të dashur, Muhamedin (a.s.) dhe me sahabët e tij. Kështu edhe për *abidët* (adhuruesit e sinqertë të Zotit) dhe *zahidët* (asketët) u bë veshje e tyre tradicionale. Madje, për këtë arsye, që prej shekullit të dytë hixhri, *abidët* janë quajtur "**sufi**" që kishte kuptimin "*njerëz që vishen me të leshta*" dhe diturisë së tyre u është thënë "*tasavvuf*".

8. VARFËRIA E PROFETIT TONË TË DASHUR

Varfëria është një veçori e Muhamedit (a.s.). Kur thoshte: **"Varfëria është krenaria ime"**, ai donte të thoshte se kishte zgjedhur varfërinë, e cila kishte kuptimin e të jetuarit për Allahun dhe jo për veten e vet, me vetëdijen e nevojës për Allahun. Madje, kur qe lënë i lirë për të zgjedhur mes "*profetit mbret*" dhe "*profetit rob*", ai pati zgjedhur këtë të fundit. Ndërkohë që Allahu i Madhëruar, që të mos shqetësohej Profeti ynë i dashur, i dha mundësinë e shfrytëzimit të thesareve të rruzullit tokësor, duke i dhënë çelësat e tyre, ai gjithnjë pati thënë: *"Zoti im, mua një ditë me ngop dhe një ditë më lër të uritur."* (Hajthemiu, Mexhmu'a'z-zevaid, IX, 192)

Jeta shpirtërore dhe askete e Profetit tonë të dashur, duke u mpleksur me profetët e tjerë, nxori në pah tasavvufin. Faktikisht, të gjitha veçoritë që u përmenden këtu gjenden tek Profeti ynë i dashur, Muhamedi (a.s.), profetët e tjerë, veçse i kanë përforcuar këto. Kështu shfaqet përsosmëria e Islamit dhe e mistikës Islame.

Naim Drijaj

RESPEKTIMI I PRINDËRVE *është porosi hyjnore*

Imam Buhariu ka vënë si kapitullin e parë në librin e tij "Edebul Mufred" (Etika, Edukata e veçantë) kapitullin e titulluar "Edukata ndaj prindërve" duke përmendur në të ajetin: **"Ne e kemi urdhëruar njeriun të sillet mirë me prindërit e tij..."** (Ankebut, 8) dhe hadithin e transmetuar nga Abdullah ibn Mesudi r.a. se: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, se cila është vepra më e dashur tek Zoti? Ai më tha: *"Namazi në kohën e vet"*. I thashë: Po pastaj? Më tha: *"Respektimi i prindërve"*. I thashë: Po pastaj. Më tha: *"Xhihadi në rrugë të Allahut"*. (Buhariu në "Edebul Mufred")

Si rezultat i largimit nga mësimet hyjnore, njeriu dhe shoqëria po kalojnë një jetë të trazuar, ku nëpërkëmben vlerat dhe gjithnjë e më shumë bihet në shfrenim moral. Në këto ditë të materializmit të egër, në zemrat e njerëzve mungon drita e imanit dhe dominon errësira që shkakton një gjendje të rëndë mendore, boshllëk shpirtëror dhe me mungesë humanizmi.

Sot ka raste kur fëmijët nuk përkujdesen për prindërit e tyre, por i lënë ata nën përkujdesjen e institucioneve sociale, sikurse është azili i pleqve duke i privuar ata nga kujdesi dhe ngrohtësia që duhet të tregohet ndaj prindërve . Madje nuk janë të rralla rastet kur fëmijët ushtrojnë dhunë psikike e fizike ndaj prindërve.

Nuk duhet të harrojmë faktin se të gjithë jemi fëmijët e dikujt, prandaj le të kemi kujdes me prindërit tanë e të mos sillemi me ta ashtu siç nuk duam që fëmijët tanë të sillen me ne.

Përditë shohim e dëgjojmë raste të frikshme, por na është bërë zemra gur, na janë bllokuar veshët, na janë zënë sytë dhe asgjë nuk na bën përshtypje.

Tregohet për një çift të ri, i cili kishte një fëmijë. Fëmijën e mbante nëna e burrit. Njëherë burri deshi t`i bënte një dhuratë gruas së tij dhe i blen një unazë shumë të shtrenjtë. Nëna ishte në krahun tjetër me fëmijën e tyre. Nënës i pëlqeu një unazë e thjeshtë. Kishte kohë që nuk kishte vënë unazë në gishtin e saj, prandaj e mori atë unazë dhe e vuri në gisht. Kur burri nxjerr paratë për të paguar, shitësi i thotë që duhet të paguajë edhe një shumë tjetër për unazën që kishte marrë nëna e burrit. Atëherë ky burrë kthehet dhe i thotë nënës, se plakat nuk mbajnë flori. Nëna hidhërohet, e heq unazën dhe del nga dyqani duke qarë, por gruaja i tha burrit të saj: "Nuk bëre mirë që i fole kështu. Kush do e mbajë fëmijën tonë tani e mbrapa"? Katastrofë si burri, si gruaja. Kur ky njeri shkon t`i kërkojë falje nënës së tij, ajo i thotë vetëm një fjalë: "Nuk dua asgjë prej teje. Ta bëftë fëmija po të njëjten gjë".

Sjellja e mirë me prindërit vjen menjëherë pas besimit në Allahun e madhëruar:

"Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj as "uh", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti." (Isra, 23)

1. RESPEKTIMI I PRINDËRVE BËHET SHKAK QË TË MOS NA BIEN MBI KRYE FATKEQËSI TË NDRYSHME

Argument për këtë është ngjarja e tre personave që kishin hyrë në shpellë dhe një gurë i madh kishte rënë

duke e mbyllur hyrjen e shpellës. Në këtë gjendje, secili prej tyre iu lut Allahut me nga një punë të mirë që kishin bërë për hirë të Tij. Njëri prej tyre iu lut Zotit duke përkujtuar respektimin e prindërve: "O Zot, Ti e di që unë kam pasur prindërit e moshuar dhe fëmijët e vegjël. Sa herë që milja bagëtinë, nuk u jepja fëmijëve qumësht para se të pinin prindërit. Një natë u vonova me bagëtinë në kullotë dhe kur shkova t'u çoj qumështin prindërve, i gjeta duke fjetur. Megjithëse fëmijët qanin nga uria, unë nuk u dhashë pasi e kisha bërë zakon që të pinin prindërit të parët. Qëndrova me enën me qumësht te koka e tyre derisa u zgjuan në mëngjes. Pasi pinë prindërit, ushqeva fëmijët e mi. "O Zot, nëse këtë vepër e kam bërë për hatrin Tënd dhe për të arritur shpërblimin Tënd, na e largo këtë shkëmb nga hyrja e shpellës". Në atë çast shkëmbi lëvizi dhe të tre arritën të dalin jashtë nga shpella. (Buhari, Muslim)

2. RESPEKTIMI I PRINDËRVE KONSIDEROHET XHIHAD

Transmeton Abdullah ibn Amri r.a që ka thënë: "Erdhi një person tek i Dërguari i Allahut dhe i kërkoi leje Pejgamberit a.s që të merrte pjesë në Xhihad. Pejgamberi e pyeti: A i ke të gjallë prindërit? Ai iu përgjigj: Po. Pejgamberi a.s i tha: *Xhihadi yt është kujdesi për prindërit*. (Buhari, Muslim)

3. RESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË SHKAK PËR HYRJEN NË XHENNET

Transmeton Ebu Darda r.a. se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *"Prindërit janë dera e mesme e Xhennetit, pra nëse dëshiron fitoje atë derë ose humbe atë."* (Tirmidhiu) Kushejri ka thënë: "..dera e mesme e Xhennetit, do të thotë, dera më e mirë e Xhennetit."

4. KËNAQËSIA E ALLAHUT ËSHTË NË KËNAQËSINË E PRINDËRVE

Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, kurse zemërim i Allahut është në zemërimin e prindërve!"* (Tirmidhiu)

Imam Shafiu (r.a.) tregon se kur ulej të hajë bukë, nuk hante derisa të përfundonte nëna e tij. Kur e pyetën rreth shkakut, u përgjigj: "Kam frikë se mos zgjas dorën të marr diçka që do të donte ta hante nëna ime".

Nga historitë e dhimbshme, që tregohen rreth fëmijëve që i harrojnë prindërit në pleqëri, është edhe kjo: Një i moshuar, të cilin fëmijët e kishin cuar në shtëpinë e pleqve, pas disa kohësh vdes. Drejtuesit e azilit u telefonojnë fëmijëve dhe u tregojnë që babai i tyre kishte vdekur.

Përgjigja e fëmijëve nga telefoni ishte më e rëndë se vdekja e babait të tyre. Ata të habitur pyetën: "Po pse deri tani paska jetuar?".

5. MOSRESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË NGA GJYNAHET E MËDHA

Pejgamberi a.s ka thënë: *"A dëshironi t'ju tregoj për gjynahet më të mëdha?"* Këtë e përsëriti tri herë. Ne i thamë: "Po, o i Dërguar i Allahut." Pejgamberi a.s. tha: *"T'i bëni shirk Allahut dhe të mos respektoni prindërit..."* (Buhari, Muslim)

Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Çdo gjynah Zoti mund ta shtyjë për jetën tjetër, ndërsa keqtrajtimin e prindërve Zoti e dënon që në këtë jetë".*

MOLUSQET, QENIET ME DHËMBË TË FORTA

Dhëmbët e molusqeve janë tepër të forta. Ato përbëhen nga fibra mikroskopike, 100 herë më të holla se flokët e njeriut dhe më të forta se fibra sintetike.

Në se do të kishim një fije spageti të prodhuar nga ky material me të mund të ngrihej një hipopotam.

Substanca bazë e këtyre dhëmbëve është një lloj minerali nga i cili përbëhet ndryshku. Kjo i lejon molusqet të ngjiten pas gurëve ndërsa ushqehen me leshterikë.

Në të ardhmen ato mund të gjejnë vend përdorimi në makina, anije dhe aeroplanë për t'i bërë këto mjete më të sigurta. Fija e merimangave ka qenë materiali më i fortë natyror biologjik. Por jo më, tani dhëmbët e molusqeve zënë vendin e parë.

USHQIMI NDIKON NË TRURIN E NJERIUT

Shkencëtarët nga Universiteti i Kalifornisë në Los Anxhelos për herë të parë arritën të marrin deshmi në lidhje me faktin se probiotikët, të cilët depërtojne në zorrët e njeriut së bashku me ushqimin, ndikojnë në funksionimin e trurit të njeriut.

Më parë shkencëtarët ishin në dijeni se truri dërgon rregullisht sinjale në zorrë, por fakti që zorra i "pergjigjet" ketyre sinjaleve u bë nje lajm sensacional.

Mekanizmi i saktë i ndikimit është ende i panjohur, por, sipas mendimit të shkencëtarëve, bakteriet e zorrëve dërgojne sinjale në tru, të cilat me kalimin e kohës kanë aftësi për të ndryshuar në varësi të dietës.

Ndoshta terapia me medikamentë probiotike mund të perdoret për trajtimin e sëmundjeve të caktuara të trurit.

KONFIRMOHET ELEMENTI I 115-TË NË TABELËN PERIODIKE

Shkencëtarët thonë se kanë krijuar një pjesë të vogël të atomeve të elementit 115, e cila zë një qoshe misterioze të tabelës periodike.

Elementi shumë i rëndë ka ende për t'u emëruar zyrtarisht, por ai është quajtur përkohësisht Ununpentium, bazuar përafërsisht në fjalët latine dhe greke për shifrat në numrin e tij atomik 115.

Numri atomik është numri i protoneve që një element përmban. Elementi më i rëndë që gjendet në natyrë është uraniumi, i cili ka 92 protone, por shkencëtarët mund të ngarkojnë edhe më shumë protone në një bërthamë atomike dhe kjo i bën elementet më të rënda përmes reaksioneve të fuzionit bërthamor.

Shkencëtarët shpresojnë se duke krijuar elemente sa më të rënda, ata do të gjejnë teorikisht "ishullin e stabilitetit", një rajon i pazbuluar në tabelën periodike, ku mund të ekzistojnë elemente me përdorime të paimagjinueshme.

Në eksperimentet në Dubna, Rusi, rreth 10 vjet më parë, hulumtuesit kanë raportuar se ata kishin krijuar atomet me 115 protone. Matjet e tyre tani janë konfirmuar në eksperimentet në Qendrën GSI Helmholcitz për Hulumtimet e Joneve të Rënda në Gjermani.

Për ta ekzaminuar ununpentiumin në studimin e ri, një grup studiuesish ka përdorur një rreze shumë të shpejtë kalciumi (që ka 20 protone), në një cipë të hollë americiumi, elementi me 95 protone. Kur bërthamat atomike u përplasën, disa prej tyre u bashkuan së bashku për të krijuar atomet me 115 protone.

Një komision nga Bashkimi Ndërkombëtar i Kimisë së Pastër dhe të Aplikuar (IUPAC), e cila drejton nomenklaturën kimike, do të shqyrtojë gjetjet e reja për të vendosur nëse elementi i 115-të do të marrë një emër zyrtar.

Disa nga fqinjët e elementit të 115-të tashmë janë pagëzuar. Vitin e kaluar, elementet e prodhuara nga njeriu 114 dhe 116 u emërtuan flerovium (FL) dhe livermorium (LV).



HITHRA DHE DOBITË E SAJ

Në mjekësinë popullore hithra njihet si mbretëresha e bimëve mjekësore, për shkak të efekteve të saj pozitive në shërimin e disa sëmundjeve. Përdorimi i kësaj bime gjatë periudhës së pranverës ndihmon në pastrimin e gjakut dhe shërimin nga anemia. Këshillohet që gjatë kësaj kohe të konsumohet sa më shpesh bima e hithrës në formë sallate ose dhe e gatuar në supë ose byrek. Gjithashtu, mund të pihen 3 gota çaj në ditë nga kjo bimë. Për shkak të sasisë së madhe të kaliumit, hithrat kane efekt diuretik dhe çaji i saj përdoret në mjekimin e inflamacionit të rrugëve urinare, si dhe për parandalimin e krijimit të gurëve në veshka. Për shkak të përmbajtjes së lartë të hekurit, hithra ndihmon në rritjen e numrit të qelizave të kuqe në gjak. Çaji i thithrës ka veti të jashtë zakonshme në pastrimin e trupit nga toksinat.

Hithra përmban klorofil, vitamina A,C dhe E, acidi salicilik, beta karoten, hekur ,kalcium, kalium, fosfate dhe minerale të tjera. Gjithashtu përmban serotonin, histamin, acid formic dhe acid acetik.

Mënyra e përdorimit: Në formë infuzi marrim 25 gr gjethe të freskëta ose 5 gr të thata dhe i ziejmë me një filxhan çaji rreth 200 ml e leme sa të marrë valë, e heqim pastaj nga zjarri dhe lemë 10 minuta të ftohet, e kullojmë dhe e kemi gati për përdorim. Në të njëjtën mënyrë mund të përdoren edhe rrënjët.

Dobitë e hithrës:

Mund të ndihmojë trupin në detoksifikimin e kimikateve dhe metaleve të rënda. Ndihmon për të reduktuar mbajtjen e ujit, dhe është veçanërisht e dobishme kur ka rrjedhje të rëndë menstruale tek gratë.

Stimulimi i hithrës i ndihmon nënat për qumësht dhe rritje të energjisë pas lindjes.

Diuretik, rritës i sekretimit të acidit të urinës ndërsa në të njëjtën kohë forcon rezistencën e shkuarjes në banjo gjatë natës, pra ndihmon për problemet e rrugëve urinare.

Steroli, një përbërës që zvogëlon aktivitetin e DHT i cili eshte një lloj testosteroni që shkakton zgjerimin e prostatës.

Ka kapacitet anti-inflamator që vepron për të ndihmuar shumë nga simptomat që lidhen me artritin.

Pasuria me mineralet bor dhe silic ndihmojnë për të zvogëluar dhimbjet e osteoartritit, tendinat, bursit, artritit dhe përdhesit. Gjethet mund të bëhen një forme paste dhe te vihen direkt në zonat e dhimbshme të lëkurës për kushte të tilla si artrit.

Në të gjenden cilësi si Anti-hemorragjik për gjakderdhje të brendshme, si dhe gërvishtjet dhe plagët.

Anti-astmatik për të dy vështirësitë bronkiale dhe astmatike, ndihmon për të pastruar bronket dhe hundën.

Përmban antihistamine natyrore. E mirë për temperaturën dhe alergjitë.

Agjent depurativ dhe tonik për gjendrën veshkore.

TËNDAFILI I EGËR

Tëndafili i egër është një bimë, që rritet në shkurre dhe vlerat e saj kurative janë të pallogaritshme. Në mjekësinë popullore pjesët që ndihmojnë në lehtësimin e sëmundjeve janë frutet, që përftohen pas tharjes së luleve. Frutet e trëndafilit të egër ndihmojnë mjaft në kurimin e disa prej sëmundjeve më të përhapura.

Një ndihmesë të madhe u kanë dhënë të sëmurëve me anemi. Për rritjen e numrit të rruazave të kuqe në gjak dhe të hemoglobinës, mjekët këshillojnë që të sëmurët të pinë 2 herë në ditë nga një gotë me çajin e përftuar nga frutet e copëtuara të bimës. Për përgatitjen çajit nevojiten 7 kokrra të copëtuara mirë të frutit, të cilat hidhen në një enë me ujë dhe lihet të zihen për 10 minuta. Më pas ëmbëlsohet dhe pihet çdo ditë para buke.

Rezultate të mira kjo bimë jep edhe në parandalimin e sëmundjeve të mushkërisë të shkaktuara nga ftohja ose pirja e tepërt e cigares. Shpesh dëmtimet në mushkëri shoqërohen me shfaqjen e kollës. Mënyra më e mirë për largimin e saj është çaji i trëndafilit. Çaji duhet të pihet disa herë në ditë deri në shërim të plotë, kur kolla të mos ketë lënë gjurmë. Ashtu si dhe shumë bimë të tjera, trëndafili i egër është një qetësues i shkëlqyer i dhimbjeve të stomakut dhe fryrjes së barkut gjatë ftohjes. Mjekët popullorë këshillojnë 2 gota çaj në ditë para buke dhe shqetësimet do të largohen shumë shpejt. Edhe për qetësimin e dhimbjeve të kokës me prejardhje nervore, ky çaj jep efekte të menjëhershme. Te njerëzit që vuajnë nga depresioni, këshillohet të pihet çaji i përftuar nga trëndafili. Pirja e çajit çdo ditë ndihmon në lehtësimin e situatës. Jo vetëm frutet e bimës, por edhe vaji që nxirret prej gjetheve të saj ndihmon në kurimin e sëmundjeve. Rezultate të shkëlqyera jep në shqetësimet e tëmthit dhe rrit sasinë e lëngut në të. Gjashtë deri në 7 pika të vajit hidhen në gjysmë gote me ujë dhe pihet çdo mëngjes.

Vaji këshillohet të përdoret edhe në qetësimin e dhimbjeve te femrat. Shumë i rëndësishëm është vaji i bimës në shërimin e plagëve kur shoqërohen me hemorragji. Në përbërje të vajit ekziston një substancë që mundëson mpiksjen e gjakut dhe ndalon hemorragjinë. Në këto raste lyerja e plagës 3 herë në ditë është shumë e rëndësishme. Trëndafili i egër ose Rosa canina, siç quhet në latinisht, është një bimë që mund të gjendet kudo ku ka shkurre dhe ka një përhapje të gjerë në të gjithë vendin. Kjo bimë mund të lulëzojë vetëm një herë në vit në muajin qershor. Frutet e saj janë të vetmet pjesë të bimës, që shërbejnë për kurimin e sëmundjeve.